



KËSHILLI I
QARKUT ELBASAN

PLANI SOCIAL RAJONAL - QARKU ELBASAN

KËSHILLI I QARKUT ELBASAN

2026-2030

(DRAFT)

Fjala e Kryetares së Këshillit të Qarkut Elbasan

Plani Social Rajonal për Qarkun Elbasan përfaqëson një instrument të rëndësishëm strategjik për forcimin e mirëqenies sociale, kohezionit social dhe zhvillimit të qëndrueshëm në territorin e qarkut tonë. Ky plan reflekton angazhimin e Këshillit të Qarkut Elbasan për të ndërtuar politika sociale më të koordinuara, më gjithëpërfshirëse dhe më pranë nevojave reale të qytetarëve, duke vendosur në qendër dinjitetin njerëzor, barazinë në akses dhe mbështetjen për grupet në nevojë dhe vulnerabël.

Ai përfaqëson një vizion të përbashkët për një zhvillim rajonal më të harmonizuar dhe më gjithëpërfshirës, ku çdo qytetar, pavarësisht vendbanimit, gjendjes ekonomike apo kushteve sociale, të ketë mundësi të barabarta për mbështetje, përfshirje dhe pjesëmarrje aktive në jetën sociale dhe ekonomike të komunitetit.

Qarku Elbasan përfaqëson një territor me diversitet të madh njerëzor, social dhe territorial. Shtrirja e gjerë gjeografike, diferencat ndërmjet zonave urbane dhe rurale, ndryshimet demografike, plakja e popullsisë dhe emigracioni, si dhe nevojat në rritje për shërbime sociale më të specializuara, kërkojnë politika të mirëkoordinuara dhe ndërhyrje afatgjata, të bazuara në evidencë, solidaritet social dhe bashkëpunim ndërinstytucional.

Sot, sfida jonë nuk lidhet vetëm me ekzistencën e shërbimeve sociale, por me aksesin e barabartë në to, me cilësinë, qëndrueshmërinë dhe shpërndarjen territoriale të tyre. Në shumë zona të qarkut, veçanërisht në njësitë rurale dhe malore, familjet, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe grupet në nevojë vazhdojnë të përballen me vështirësi reale për të marrë mbështetjen e nevojshme.

Në këtë kontekst, Plani Social Rajonal synon të forcojë koordinimin ndërmjet bashkive, institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve zhvillimorë, me qëllim ndërtimin e një rrjeti shërbimesh më të integruara, më të aksesueshme dhe më pranë qytetarëve.

Një rëndësi të veçantë në këtë plan zë zhvillimi i shërbimeve të specializuara, forcimi i bashkëpunimit ndërvendor dhe rajonal, si dhe promovimi i një qasjeje që fuqizon individin dhe familjen drejt përfshirjes sociale, pavarësisht socio-ekonomike dhe një jete me më shumë dinjitet.

Ky dokument është rezultat i një procesi të gjerë bashkëpunimi me bashkitë e qarkut, institucionet përgjegjëse, organizatat e shoqërisë civile, partnerët ndërkombëtarë dhe ekspertët e fushës. Për këtë arsye, ai përfaqëson jo vetëm vizionin e Këshillit të Qarkut Elbasan, por edhe një përgjegjësi të përbashkët për të ndërtuar politika sociale më efektive dhe më afër nevojave reale të komuniteteve tona.

Jam e bindur se vetëm përmes bashkëpunimit, solidaritetit institucional dhe një angazhimi të qëndrueshëm mund të ndërtojmë një qark më gjithëpërfshirës dhe me më shumë mirëqenie për çdo qytetar.

Në emër të Këshillit të Qarkut Elbasan, shpreh mirënjohjen për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e këtij plani dhe ftoj çdo institucion dhe partner të bëhet pjesë aktive e zbatimit të tij.

Së bashku, mund të ndërtojmë një sistem social më të fortë, më njerëzor dhe më të drejtë për të gjithë.

KRYETARE

Ermira URUPI

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	5
1. Hyrje dhe konteksti strategjik	6
2. Parimet udhëzuese dhe qasja konceptuale.....	8
3. Metodologjia.....	10
4. Analiza socio-demografike rajonale	13
5. Prioritetet strategjike rajonale objektivat, masat, aktivitetet dhe indikatorët.....	19
6. Plani i Veprimit (matrica e kostimit)	27
7. Metodologjia e kostimit dhe kuadri financiar	40
8. Mekanizmi i zbatimit dhe qeverisjes	41
9. Monitorimi, vlerësimi dhe mësimet e mësuara.....	45
10. Komunikimi, transparenca dhe pjesëmarrja	48
ANEKSE.....	50
Aneksi 1: Kuadri ligjor dhe strategjik i Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan.....	51
Aneksi 2: Metodologjia.....	55
Aneksi 3: Analiza e burimeve njerëzore	58
Aneksi 4: Analizë krahasuese e Planeve Sociale Vendore – Qarku Elbasan	59
Aneksi 5: Analiza SWOT – Sistemi i Shërbimeve Sociale në Qarkun Elbasan	66
Aneksi 6: Roli i Këshillit të Qarkut në zhvillimin e shërbimeve sociale dhe partneritetet ndërinstitucionale	67
Aneksi 7: Aneksi Analiza e detajuar demografike, Qarku Elbasan	68
Aneksi 8: Analiza e detajuar e situatës së familjeve në nevojë, Qarku Elbasan.....	72
Aneksi 9:Analiza e detajuar e situatës për personat me aftësi të kufizuara (PAK),Q.El... 76	
Aneksi 10:Analiza e detajuar e situatës për fëmijët në nevojë për mbrojtje, Q.El	85
Aneksi 11:Analiza e detajuar e situatës së viktimave të dhunës dhe trafikimit Q. Elb.....	91
Aneksi 12: Analiza e e detajuar e situatës së të moshuarve në nevojë Qarku Elbasan.....	98
Aneksi 13: Analiza e detajuar e situatës së shërbimeve shoqërore Qarku Elbasan.....	104
Aneks 14: Lista e aktorëve lokalë në hartimin e Planit Social Rajonal	111

Përmbledhje Ekzekutive

Qarku Elbasan, i vendosur në Shqipërinë qendrore dhe me një sipërfaqe prej rreth 3,200 km², përbëhet nga 7 bashki dhe ka një popullsi prej rreth 232,580 banorë sipas Censit 2023. Struktura demografike reflekton një proces të qartë plakjeje, ku popullsia mbi 65 vjeç (19.7%) tejkalon atë të fëmijëve 0 -14 vjeç (15.3%). Përqendrimi i popullsisë në Bashkinë Elbasan (rreth 49.5%) dhe diferencat ndërmjet bashkive krijojnë presione të pabarabarta mbi sistemin e shërbimeve sociale.

Analiza e evidenton sfida strukturore që lidhen me pabarazitë territoriale në aksesin ndaj shërbimeve, mbulimin ende të pamjaftueshëm të kategorive në nevojë dhe qëndrueshmërinë e financimit të shërbimeve. Në të njëjtën kohë, modeli i ndërhyrjes mbetet kryesisht i orientuar ndaj reagimit, me potencial për zhvillimin e mëtejshëm të ndërhyrjeve parandaluese. Sistemi karakterizohet nga përqendrim i shërbimeve në disa bashki dhe boshllëqe në mbulimin e nevojave komplekse, duke kufizuar zhvillimin e ndërhyrjeve parandaluese dhe komunitare.

Në këtë kuadër, Plani Social Rajonal 2026–2030 strukturohet në tre prioritetet strategjike: zhvillimi i shërbimeve rajonale të specializuara; forcimi i koordinimit ndër-institucional; dhe përmirësimi i aksesit në shërbime përmes informimit, identifikimit dhe referimit. Këto prioritetet synojnë një sistem më të balancuar territorial, më të orientuar drejt parandalimit dhe më të qëndrueshëm institucionalisht.

Ndërhyrjet fokusohen në vijimësinë e shërbimeve ekzistuese, zhvillimin e shërbimeve të reja rajonale, zgjerimin e mbulimit në bashkitë me mungesë shërbimesh dhe forcimin e mekanizmave të koordinimit dhe të përdorimit të të dhënave. Theks i veçantë i jepet mbështetjes së kategorive me nevoja komplekse dhe reduktimit të varësisë nga projektet afatshkurtra përmes rritjes së rolit të financimit publik.

Kostoja totale orientuese e planit për periudhën 2026-2030 vlerësohet në rreth **363,204,200** lekë, e ndarë ndërmjet kontributit të Këshillit të Qarkut Elbasan, Fondit Social dhe financimeve të pritëshme nga donatorët. Ky konfigurim mbështet realizueshmërinë e ndërhyrjeve dhe vijueshmërinë e shërbimeve në kohë.

Zbatimi i planit mbështetet në një mekanizëm të qartë qeverisjeje, ku Këshilli i Qarkut ushtron rolin koordinues në nivel rajonal, ndërsa bashkitë mbeten përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve në territor. Partneritetet me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet publike kontribuojnë në zgjerimin e kapaciteteve dhe diversifikimin e shërbimeve.

Monitorimi i planit realizohet përmes një sistemi indikatorësh të lidhur me objektivat dhe masat, duke mundësuar ndjekjen e progresit dhe përmirësimin e ndërhyrjeve. Rishikimi vjetor dhe integrimi i feedback-ut nga terreni sigurojnë përshtatjen e planit me zhvillimet reale në qark.

Në tërësi, plani synon transformimin e sistemit të shërbimeve sociale në një model të integruar, të balancuar territorial dhe të qëndrueshëm, në funksion të adresimit efektiv të nevojave të kategorive në nevojë në nivel qarku.

1. Hyrje dhe konteksti strategjik

Qarku Elbasan përballlet me pabarazi të theksuara territoriale në aksesin dhe cilësinë e shërbimeve sociale, të lidhura me diferencat në kapacitete ndërmjet bashkive, shpërndarjen e pabarabartë të shërbimeve dhe kufizimet në burime. Këto sfida, të kombinuara me plakjen e popullsisë, varfërinë, migracionin dhe përjashtimin social, kërkojnë një qasje të koordinuar përtej nivelit vendor.

Plani Social Rajonal i Qarkut Elbasan 2026-2030 përbën instrumentin kryesor për koordinimin dhe orientimin e politikave sociale në nivel rajonal. Ai synon reduktimin e pabarazive territoriale, forcimin e kohezionit social dhe përmirësimin e aksesit në shërbime për grupet në nevojë.

Qarku përbëhet nga shtatë bashki (Elbasan, Cërrik, Belsh, Librazhd, Prrenjas, Gramsh dhe Peqin) me profile të diferencuara, çka kërkon ndërhyrje të integruara. Plani ndërton një kornizë të përbashkët veprimi, duke respektuar kompetencat e bashkive dhe duke forcuar rolin koordinues të Këshillit të Qarkut për një zhvillim social të balancuar në të gjithë territorin.

1.1 Qëllimi i Planit Social Rajonal

Plani përcakton kornizën strategjike për koordinimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale në nivel rajonal, në përputhje me legjislacionin dhe prioritetet kombëtare të mbrojtjes sociale. Ai mbështetet në analizën e diferencave territoriale dhe të nevojave specifike të bashkive.

Qëllimi i planit është reduktimi i pabarazive ndërmjet bashkive, harmonizimi i prioritetëve vendore dhe zhvillimi i shërbimeve me ndikim rajonal, përmes forcimit të rolit koordinues të Këshillit të Qarkut.

Plani nuk zëvendëson kompetencat e bashkive, por i plotëson ato duke garantuar koherencë institucionale dhe përdorim më efikas të burimeve në nivel qarku.

1.2 Mandati ligjor dhe institucional

Kuadri ligjor kombëtar përcakton bazën për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor dhe rajonal, duke garantuar të drejtën për mbrojtje sociale dhe akses të barabartë në shërbime, në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Në këtë kuadër, bashkitë mbeten përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve, ndërsa Këshilli i Qarkut ushtron rol koordinues në zhvillimin e ndërhyrjeve me karakter rajonal.

Ligji nr. 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror vendos parimet për organizimin, financimin dhe standardizimin e shërbimeve, duke theksuar zhvillimin e shërbimeve të specializuara dhe bashkëpunimin ndërinstitutional. Ligji nr. 139/2015 për vetëqeverisjen vendore përcakton kompetencat e njësive vendore dhe rolin e qarkut në koordinimin rajonal.

Kuadri sektorial dhe angazhimet ndërkombëtare mbështesin një qasje të integruar dhe të bazuar në të drejta, duke kërkuar zhvillimin e shërbimeve të aksesueshme, cilësore dhe të

qëndrueshme. Mekanizmat e financimit, veçanërisht Fondi Social, dhe standardet e shërbimeve përbëjnë elementë kyç për realizimin e planit.

Detajet e plota paraqiten në Aneksin 1.

1.3 Pse një plan në nivel rajonal?

Pabarazitë ndërmjet bashkive në kapacitetet, shpërndarjen e shërbimeve dhe burimet financiare dhe njerëzore krijojnë nivele të ndryshme aksesit dhe cilësisë, të cilat nuk mund të adresohen vetëm në nivel vendor.

Shërbimet e specializuara për kategori me nevoja komplekse, si personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës apo fëmijët në rrezik, kërkojnë burime dhe shkallë ndërhyrjeje që tejkalojnë kapacitetet e një bashkie të vetme. Niveli rajonal mundëson zhvillimin e shërbimeve të përbashkëta, standardizimin e proceseve dhe përdorimin më efikas të burimeve.

Plani rrit gjithashtu aftësinë për mobilizimin e fondeve dhe garanton koherencë ndërmjet prioritetëve vendorë dhe politikave kombëtare. Në këtë mënyrë, ai konsolidon rolin e qarkut dhe vendos bazën për një sistem më të balancuar dhe të qëndrueshëm.

1.4 Lidhjet me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare

Plani Social Rajonal bazohet në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe harmonizohet me politikat dhe planet kombëtare për punësimin, rininë, barazinë gjinore, përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Ai kontribuon në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe në përputhjen me kornizat e Bashkimit Europian për përfshirjen sociale.

Në këtë mënyrë, plani siguron koherencë vertikale me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe koherencë horizontale ndërmjet sektorëve. Detajet paraqiten në Aneksin 1.

1.5 Fusha e veprimit dhe kufizimet

Plani përcakton ndërhyrjet në nivel qarku përmes identifikimit të prioritetëve ndërbashkiake dhe zhvillimit të shërbimeve me ndikim rajonal. Ai forcon mekanizmat e koordinimit dhe vendos kornizën e monitorimit dhe raportimit.

Fokusi është tek grupet në nevojë, përfshirë fëmijët në rrezik, të rinjtë vulnerabël, gratë dhe vajzat në situatë dhune, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe familjet në varfëri, duke siguruar përputhshmëri me planet vendorë dhe duke adresuar boshllëqet që tejkalojnë kapacitetet e bashkive.

Plani nuk cenon kompetencat e njësive vendorë dhe nuk zëvendëson planifikimin financiar vendor. Zbatimi i tij varet nga burimet, kapacitetet institucionale dhe cilësia e të dhënave.

Brenda këtyre kufijve, plani vendos bazën për një sistem shërbimesh më të integruar, më të standardizuar dhe më të balancuar territorial në Qarkun Elbasan. Plani Social Rajonal i Qarkut Elbasan është hartuar me mbështetjen teknike të UNICEF, i cili ka ofruar ekspertizë dhe ka kontribuar në sigurimin e cilësisë së procesit në të gjitha fazat e hartimit të planit. Gjithashtu, World Vision Albania ka mbështetur Këshillin e Qarkut Elbasan në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve konsultative, përmes ofrimit të mbështetjes logjistike gjatë procesit të konsultimit dhe përfshirjes së aktorëve lokalë.

2. Parimet udhëzuese dhe qasja konceptuale

Plani Social Rajonal i Qarkut Elbasan mbështetet në një kornizë parimesh që udhëheqin analizën e situatës sociale, përcaktimin e prioriteteve dhe zhvillimin e ndërhyrjeve me ndikim rajonal, duke orientuar planifikimin social drejt adresimit të nevojave reale të popullsisë dhe reduktimit të pabarazive territoriale.

2.1 Parimet e të drejtave të njeriut:

Planifikimi social mbështetet në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke garantuar që ndërhyrjet sociale të kontribuojnë në akses të barabartë ndaj shërbimeve dhe mbështetjes për të gjithë qytetarët, veçanërisht për individët dhe grupet në rrezik përjashtimi social.

2.2 Qasja e bazuar në evidencë:

Prioritetet dhe ndërhyrjet e planit mbështeten në analizën e të dhënave mbi situatën sociale në territor. Vendimmarrja e bazuar në evidencë mundëson orientimin e politikave drejt sfidave reale dhe krijon bazën për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve.

2.3 Qasja territoriale:

Plani merr në konsideratë karakteristikat demografike, sociale dhe ekonomike të territorit të qarkut dhe diferencat ndërmjet bashkive. Qasja territoriale synon të identifikojë boshllëqet në aksesin ndaj shërbimeve sociale dhe të promovojë ndërhyrje që adresojnë pabarazitë territoriale.

2.4 Qasja përfshirëse:

Procesi i planifikimit dhe zbatimit të politikave sociale mbështetet në përfshirjen e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale. Kjo qasje kontribuon në identifikimin më të saktë të nevojave dhe në rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve.

2.5 Qasja e qëndrueshmërisë:

Ndërhyrjet e planit synojnë të jenë të realizueshme dhe të qëndrueshme në aspektin institucional dhe financiar, duke u integruar në proceset e planifikimit dhe buxhetimit publik.

2.6 Qasja ndërsektoriale:

Adresimi i sfidave sociale kërkon bashkëpunim ndërmjet sektorëve të ndryshëm të politikave publike. Plani promovon koordinimin ndërinstytucional për të rritur efektivitetin dhe ndikimin e ndërhyrjeve sociale në nivel rajonal.

Parimet udhëzuese të këtij plani orientojnë analizën e situatës sociale dhe përcaktimin e prioriteteve strategjike në nivel qarku. Qasja e bazuar në evidencë dhe ajo territoriale mbështesin identifikimin e sfidave sociale dhe të boshllëqeve në aksesin ndaj shërbimeve ndërmjet bashkive. Parimet e përfshirjes dhe koordinimit ndërsektorial udhëheqin procesin e konsultimit dhe formulimin e ndërhyrjeve të përbashkëta institucionale. Parimi i qëndrueshmërisë orienton zhvillimin e masave të realizueshme dhe integrimin e tyre në mekanizmat ekzistues të planifikimit, financimit dhe monitorimit të planit.

Tabela në vijim paraqet mënyrën se si parimet udhëzuese reflektohen në strukturën e planit.

Tabela 1: Reflektimi i parimeve udhëzuese në strukturën dhe kapitujt e Planit Social Rajonal

Parimi	Si reflektohet në plan	Ku reflektohet në plan (kapitulli)
Parimet e të drejtave të njeriut	Orienton analizën e grupeve vulnerabël dhe përcaktimin e prioriteteve për akses të barabartë ndaj shërbimeve sociale.	Diagnoza sociale; Prioritetet strategjike
Qasja e bazuar në evidencë	Mbështet analizën e situatës sociale dhe identifikimin e sfidave dhe nevojave prioritare në nivel qarku.	Analiza e situatës sociale; Sistemi i monitorimit dhe indikatorëve
Qasja territoriale	Orienton analizën e diferencave ndërmjet bashkive dhe identifikimin e boshllëqeve territoriale në aksesin ndaj shërbimeve sociale.	Analiza territoriale; Prioritetet rajonale
Qasja përfshirëse	Reflektohet në procesin e konsultimit me institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët lokalë.	Procesi i konsultimit; Mekanizmat e bashkëpunimit institucional
Qasja e qëndrueshmërisë	Orienton formulimin e prioriteteve dhe masave drejt ndërhyrjeve të realizueshme dhe të integrueshme në sistemin e planifikimit dhe financimit publik.	Prioritetet dhe masat e planit; Korniza financiare
Qasja ndërsektoriale	Reflektohet në zhvillimin e ndërhyrjeve që kërkojnë bashkëpunim ndërinstytucional dhe koordinim ndërsektorial.	Mekanizmi i zbatimit; Struktura e koordinimit institucional

3. Metodologjia

Hartimi i Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan është bazuar në një qasje metodologjike të kombinuar, që integron analiza sasiore dhe cilësore për të identifikuar nevojat sociale dhe për të mbështetur përcaktimin e prioriteteve strategjike në nivel rajonal.

Analiza e situatës sociale është mbështetur në një kombinim burimesh statistikore, administrative dhe dokumentare, përfshirë të dhëna nga INSTAT, databaza administrative të bashkive dhe databazën rajonale të shërbimeve sociale të Këshillit të Qarkut Elbasan, si dhe dokumente strategjike kombëtare dhe sektoriale.

Procesi i analizës është plotësuar përmes konsultimeve me aktorët institucionalë dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe përmes analizës së planeve sociale vendore të bashkive të rajonit. Krahasimi dhe ndërthurja e të dhënave statistikore, administrative dhe cilësore është përdorur për të ndërtuar një diagnozë të konsoliduar të situatës sociale.

Rezultatet e analizës janë përdorur për përcaktimin e prioriteteve strategjike dhe për hartimin e masave të planit, të cilat janë konfirmuar përmes konsultimeve institucionale dhe procesit të konsultimit publik.

Tabela në vijim paraqet fazat metodologjike të hartimit të Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan, duke lidhur metodat analitike, burimet e evidencës, aktorët institucionalë dhe rezultatet strategjike të secilës fazë të procesit të planifikimit.

Një përshkrim më i detajuar i metodologjisë paraqitet në **Aneksin 2. Metodologjia**.

Tabela 2: Metodologjia – Korniza analitike e procesit të hartimit të Planit Social Rajonal

Faza	Objekti metodologjik	Instrumentet dhe metodat	Burimet e të dhënave	Aktorët përgjegjës	Produktet	Faza e planit	Rezultati analitik
Analiza e sistemit territorial dhe të shërbimeve	Krijimi i diagnozës rajonale të nevojave sociale	Desk review; analiza statistikore; analiza territoriale e shërbimeve	INSTAT; databaza bashkive; databaza rajonale e shërbimeve sociale	Grupi teknik; Këshilli i Qarkut Elbasan Bashkitë	Diagnoza rajonale e situatës sociale	Kapitulli i diagnozës	Identifikimi i boshllëqeve territoriale në shërbime
Konsultimi dhe evidenca cilësore	Identifikimi i nevojave reale dhe barrierave në aksesin ndaj shërbimeve	Fokus-grupe; intervista me OJF; pyetësorë për bashkitë, workshop konsultativ	OJF; bashkitë; përfaqësues të grupeve në nevojë	Këshilli i Qarkut Elbasan Bashkitë; OJF	Input cilësor për analizën	Diagnoza dhe analiza	Evidentimi i barrierave në aksesin ndaj shërbimeve
Triangulimi dhe analiza integruese	Verifikimi dhe konsolidimi i gjetjeve nga burime të ndryshme	Triangulim i të dhënave statistikore, administrative dhe cilësore	Të dhëna statistikore; të dhëna administrative; evidencë cilësore	Grupi Teknik i Punës	Diagnozë e konsoliduar rajonale	Diagnoza rajonale	Identifikimi i problematikave e strukturore

Prioritizimi strategjik	Përcaktimi i prioriteteve rajonale të ndërhyrjes	Analiza e nevojave; kritere prioritizimi; konsultime institucionale	Rezultatet e analizës dhe konsultimeve	Këshilli i Qarkut Elbasan; Bashkitë; Grupi Teknik i Punës	Lista e prioriteteve strategjike	Kapitulli i prioriteteve	Përzgjedhja e ndërhyrjeve me ndikim rajonal
Planifikimi operacional	Përkthimi i prioriteteve në masa dhe aktivitete konkrete	Hartimi i matricës së planit; analiza e kapaciteteve institucionale	Diagnoza rajonale dhe prioritetet strategjike	Grupi teknik; institucionet partnere	Matrica e masave dhe aktiviteteve	Plani i veprimit	Strukturimi i ndërhyrjeve strategjike
Kostimi dhe burimet financiare	Vlerësimi i kostove dhe identifikimi i burimeve të financimit	Qasje bottom-up; analiza e buxheteve	Buxhetet vendore; programe kombëtare; financime të donatorëve	Këshilli i Qarkut Elbasan; Bashkitë; institucionet qendrore	Matrica e kostimit dhe burimet e financimit	Korniza financiare	Vlerësimi i realizueshmërisë financiare
Validimi dhe konsultimi publik	Sigurimi i legjitimitetit institucional dhe social të planit	Workshop rajonal; konsultime publike	Komentet e aktorëve institucionalë dhe komunitarë	Këshilli i Qarkut Elbasan; Bashkitë; OJF; komunitetet	Versioni final i planit	Miratimi i planit	Konsensusi institucional për planin

4. Analiza socio-demografike rajonale

Qarku Elbasan paraqet një profil social dhe territorial kompleks, të karakterizuar nga diferenca të theksuara ndërmjet bashkive në aspektin demografik, ekonomik dhe në aksesin ndaj shërbimeve sociale. Struktura demografike reflekton një proces të qartë plakjeje të popullsisë, ku grupmosha mbi 65 vjeç përbën rreth 19.7% të popullsisë, ndërsa fëmijët 0-14 vjeç rreth 15.3%. Në të njëjtën kohë, përqendrimi i rreth 49.5% të popullsisë në Bashkinë Elbasan, së bashku me migracionin dhe diferencat në zhvillimin ekonomik lokal, kanë prodhuar presione të ndryshme mbi sistemin e mbrojtjes sociale dhe mbi kapacitetin e bashkive për të ofruar shërbime të qëndrueshme dhe të aksesueshme.

Në nivel qarku operojnë 49 shërbime sociale, nga të cilat 23 janë shërbime ditore dhe komunitare, 11 shërbime të specializuara, ndërsa shërbimet rezidenciale, në familje dhe lëvizëse mbeten të kufizuara. Struktura aktuale e sistemit reflekton një bazë funksionale ndërhyrjesh dhe një përvojë të konsoliduar në disa shërbime me karakter rajonal, por njëkohësisht evidenton boshllëqe të konsiderueshme në mbulimin territorial, në adresimin e nevojave komplekse dhe në zhvillimin e ndërhyrjeve parandaluese dhe komunitare. Në praktikë, sistemi vijon të mbështetet kryesisht në ndërhyrje reaktive dhe në mbështetje financiare përmes skemave cash, ndërsa zhvillimi i shërbimeve të integruara sociale dhe të kujdesit afatgjatë mbetet i kufizuar. Në këtë kuadër, analiza e mbulimit dhe e përfituesve ndihmon në evidentimin më të qartë të hendekut ndërmjet nevojave sociale dhe kapaciteteve aktuale të sistemit.

Analiza e përfituesve dhe mbulimit të shërbimeve evidenton një hendek të rëndësishëm ndërmjet nevojave dhe kapacitetit aktual të sistemit. Në Qarkun Elbasan rezultojnë rreth 14,022 persona me aftësi të kufizuara, ndërsa nga shërbimet sociale ekzistuese përfitojnë vetëm rreth 428 persona. Në të njëjtën kohë, mbi 45,739 persona janë mbi moshën 65 vjeç, ndërsa shërbimet për moshën e tretë mbeten të kufizuara dhe të përqendruara kryesisht në Bashkinë Elbasan. Edhe në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve evidentohet një hendek i konsiderueshëm, ku vetëm rreth 38.9% e fëmijëve të identifikuar në nevojë përfitojnë shërbime sociale. Këta tregues tregojnë se sistemi aktual nuk arrin ende të mbulojë në mënyrë të qëndrueshme dhe të balancuar nevojat e kategorive më vulnerabel në nivel qarku.

Hendeku ndërmjet nevojave dhe mbulimit aktual të shërbimeve paraqitet në figurën në vijim.

Figura 1. Hendeku ndërmjet numrit të personave me aftësi të kufizuara dhe përfituesve të shërbimeve sociale në Qarkun Elbasan/ *Burimi: Drejtoria Rajonale e SHSSH, Korrik 2025*




Figura evidenton hendekun e konsiderueshëm ndërmjet nevojave dhe kapacitetit aktual të sistemit, duke theksuar nevojën për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve sociale dhe të specializuara në nivel qarku.

Në mënyrë të veçantë, analiza evidenton mungesën e shërbimeve të specializuara afatgjata për personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç me nivel të lartë varësie dhe për të moshuarit në pamundësi për jetesë të pavarur, veçanërisht për ata që jetojnë vetëm ose pa mbështetje familjare. Aktualisht, sistemi i shërbimeve sociale në nivel qarku mbetet kryesisht i orientuar drejt fëmijëve dhe ndërhyrjeve afatshkurtra, ndërsa për këto kategori mungojnë modele të integruara të kujdesit afatgjatë, shërbime në familje, ekipe lëvizëse dhe alternativa rezidenciale të përshtatura. Kjo situatë rrit rrezikun e izolimit social, institucionalizimit të papërshtatshëm dhe përjashtimit social për kategori me nevoja komplekse dhe të vazhduara mbështetjeje. Këto boshllëqe reflektohen gjithashtu në mënyrën e shpërndarjes territoriale të shërbimeve dhe në diferencat ndërmjet bashkive në aksesin ndaj tyre.

Në aspektin territorial, sistemi paraqet diferenca të theksuara ndërmjet bashkive. Bashkia Elbasan përqendron pjesën më të madhe të kapaciteteve institucionale dhe të shërbimeve sociale, duke funksionuar në praktikë si qendra kryesore e ofrimit të shërbimeve me karakter rajonal. Në të kundërt, bashki si Peqin, Belsh dhe Gramsh paraqesin mbulim fragmentar ose minimal të disa tipologjive të shërbimeve, ndërsa në njësitë administrative dhe zonat rurale evidentohet mungesë e theksuar e ndërhyrjeve komunitare dhe e modeleve fleksibël të aksesit. Si rezultat, aksesin real në shërbime vazhdon të kushtëzohet nga vendndodhja territoriale dhe nga kapacitetet lokale të bashkive, duke prodhuar pabarazi të konsiderueshme në mbështetjen sociale të qytetarëve. Përtej dimensionit territorial, analiza evidenton edhe kufizime që lidhen me qëndrueshmërinë financiare dhe organizimin institucional të sistemit.

Shpërndarja territoriale e shërbimeve paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 3: Shpërndarja territoriale e shërbimeve shoqërore/ *Burimi: Drejtoria Rajonale e SHSSH, Korrik 2025*

Bashkia	Ditore	Specializuara	Rezidenciale	Në familje	Lëvizëse	Vlerësim
Elbasan	✓	✓	✓	✓	✓	I lartë
Cërrik	✓	(✓)	(✓)	(✓)	✗	Mesatar
Librazhd	✓	✓	✗	✗	✓	Mesatar
Prrenjas	✓	✓	✗	✗	✓	Mesatar
Belsh	✓	✗	✗	✗	✗	Fragmentar
Gramsh	✗	✓	✗	✗	✗	Fragmentar
Peqin	(✓)	✗	✗	✗	✗	Minimal
Kësh. i Qarkut Elbasan	✗	(✓)	(✓)	✗	✗	I kufizuar

Shënim: ✓ = shërbimi ekziston; (✓) = i kufizuar; ✗ = mungon.

Tabela eidenton përqendrimin e kapaciteteve në Bashkinë Elbasan dhe mungesën e diversifikimit të shërbimeve në bashkitë e tjera, duke konfirmuar pabarazitë territoriale në akses.

Megjithatë, ekzistenca e disa shërbimeve me funksion rajonal dhe përvoja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve krijojnë një bazë të rëndësishme për forcimin gradual të sistemit social në nivel qarku.

Në planin financiar, sistemi karakterizohet nga një varësi e lartë nga financimet e jashtme. Rreth 68% e shërbimeve sociale mbështeten nga organizata jofitimprurëse dhe donatorë, ndërsa vetëm rreth 25% financohen nga burime publike dhe 7% përmes financimit të kombinuar. Ky konfigurim financiar ka mundësuar zhvillimin e një pjese të rëndësishme të shërbimeve ekzistuese, por njëkohësisht krijon pasiguri për qëndrueshmërinë afatgjatë të tyre dhe kufizon institucionalizimin e plotë të sistemit të shërbimeve sociale në nivel qarku.

Struktura e financimit të shërbimeve sociale në nivel qarku paraqitet në figurën në vijim.

Figura 2: Struktura e financimit të shërbimeve shoqërore në Qarkun Elbasan/*Burimi: Drejtoria Rajonale e SHSSH, Korrik 2025*




Figura nxjerr në pah dominimin e financimit nga donatorët dhe varësinë e sistemit nga burimet e jashtme, duke sinjalizuar rreziqe për qëndrueshmërinë e shërbimeve në kohë.

Në aspektin institucional, sistemi mbështetet në kapacitete funksionale, por të kufizuara përballë kompleksitetit të nevojave sociale në territor. Bashkitë paraqesin nivele të ndryshme organizimi dhe kapacitetesh profesionale, ndërsa në disa prej tyre funksionet e NJVNR-ve mbulohen nga administratorët shoqërorë ose nga staf me role të mbivendosura. Në nivel qarku, funksionet që lidhen me përkujdesin social janë të integruara brenda një drejtorie me fushë të zgjeruar përgjegjësie, çka kufizon specializimin dhe ndjekjen e dedikuar të zhvillimit të shërbimeve sociale dhe të monitorimit të tyre. Megjithatë, struktura ekzistuese krijon një bazë funksionale për ushtrimin e rolit koordinues të qarkut dhe për zhvillimin gradual të mekanizmave rajonale të planifikimit dhe koordinimit.

Në të njëjtën kohë, analiza eidenton se sistemi social në qark mbështetet në një rrjet partneritetesh ndërmjet bashkive, organizatave të shoqërisë civile dhe donatorëve, të cilat kanë qenë vendimtare për ngritjen dhe funksionimin e një pjese të konsiderueshme të shërbimeve ekzistuese. Në praktikë, një pjesë e shërbimeve me funksion rajonal zhvillohen përmes mekanizmave të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Qarkut Elbasan, Fondit Social, bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile. Shërbime si Qendra Rajonale e Autizmit, Qendra “Lulet e Diellit” në Gramsh, shërbimet për viktimat e trafikimit dhe strehëza për viktimat e dhunës funksionojnë mbi modele të përbashkëta mbështetjeje financiare dhe institucionale, duke krijuar një bazë ekzistuese për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve me karakter rajonal.

Në të njëjtën kohë, analiza eidenton një rritje të kërkesës për shërbimet e Qendrës Rajonale të Autizmit, e cila përfaqëson një nga ndërhyrjet më të rëndësishme të specializuara me karakter rajonal në Qarkun Elbasan. Pavarësisht rolit të saj në mbështetjen

e fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizmit nga të gjitha bashkitë e qarkut, kapacitetet aktuale të qendrës mbeten të kufizuara në raport me nevojat në rritje, veçanërisht për shërbime terapeutike, logopedike dhe për mbështetje në familje. Në të njëjtën kohë, aksesit i familjeve nga bashkitë dhe njësitë administrative më të largëta mbetet i vështirësuar për shkak të kufizimeve territoriale dhe mungesës së modeleve fleksibël të ofrimit të shërbimit. Kjo situatë e vë në dukje nevojën për zgjerimin gradual të kapaciteteve dhe të tipologjisë së ndërhyrjeve të Qendrës Rajonale të Autizmit në funksion të rritjes së mbulimit territorial dhe përmirësimit të aksesit në shërbime të specializuara.

Në nivel qarku funksionon Komiteti Teknik për Shërbimet Sociale, i ngritur pranë Këshillit të Qarkut Elbasan dhe i drejtuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut. Në përbërje të tij marrin pjesë drejtuesit e strukturave sociale të bashkive të qarkut, përfaqësues të institucioneve publike rajonale dhe organizata të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime sociale në territor. Deri më tani, funksionimi i komitetit është fokusuar kryesisht në koordinimin ndër-institucional dhe në menaxhimin dhe orientimin e rasteve sociale. Megjithatë, analiza e vë në dukje nevojën për konsolidimin e mëtejshëm të këtij mekanizmi dhe orientimin gradual të funksionit të tij drejt planifikimit, monitorimit dhe zhvillimit të politikave sociale rajonale, në funksion të ndërtimit të një sistemi më të koordinuar dhe më të integruar të shërbimeve sociale në nivel qarku. Krahas forcimit të koordinimit institucional, analiza e vë në dukje nevojën për një qasje më funksionale ndaj aksesit real të qytetarëve në shërbime sociale.

Në nivel qarku zhvillohen vazhdimisht aktivitete ndërgjegjëse dhe informuese për kategori të ndryshme në nevojë, të organizuara nga bashkitë, institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht në kuadër të datave ndërkombëtare dhe fushatave tematike sociale. Megjithatë, analiza e vë në dukje se sfida kryesore nuk lidhet më vetëm me ndërgjegjësimin publik, por me mundësinë reale të aksesit në shërbime sociale si e drejtë e individit, veçanërisht për kategoritë me nevoja komplekse dhe për qytetarët që jetojnë në zona me mbulim të kufizuar të shërbimeve.

Në këtë kontekst, e vë në dukje nevojën për forcimin e mekanizmave rajonalë të koordinimit, referimit dhe ndjekjes së rasteve sociale, si dhe për zgjerimin e bashkëpunimit ndër-institucional përtej strukturave që mbulohen drejtpërdrejt nga Ligji nr. 121/2016. Në praktikë, kjo kërkon ndërtimin e partneriteteve funksionale ndërmjet Këshillit të Qarkut, bashkive dhe institucioneve të tjera rajonale, përfshirë Operatorin Rajonal të Kujdesit Shëndetësor, Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, strukturat e punësimit dhe aktorë të tjerë ndërsektorialë, në funksion të ndërtimit të një sistemi më të integruar të mbështetjes sociale dhe të aksesit efektiv në shërbime për qytetarët në nevojë. Në këtë kontekst, analiza e Planeve Sociale Vendore ndihmon në identifikimin e sfidave dhe nevojave të përbashkëta në nivel territori.

Analiza krahasuese e Planeve Sociale Vendore të shtatë bashkive të qarkut e vë në dukje ndryshime të rëndësishme në nivelin e zhvillimit të planifikimit social vendor, në përdorimin e evidencës dhe në strukturimin e prioritetëve sociale. Në disa bashki e vë në dukje ndryshime të rëndësishme të thelluar dhe një organizim më të konsoliduar i shërbimeve, ndërsa në bashki të tjera planifikimi mbetet më përshkrues dhe i kufizuar nga mungesa e të dhënave dhe e

kapaciteteve institucionale. Megjithatë, në pothuajse të gjitha planet vendore evidentohen nevoja të përbashkëta që lidhen me zhvillimin e shërbimeve të specializuara, forcimin e koordinimit ndërinstytucional, zgjerimin e shërbimeve për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimin e aksesit territorial në shërbime.

Në shumicën e bashkive konstatohet mungesë e të dhënave të strukturuar për kategori të caktuara në nevojë, veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe kategori të tjera me vulnerabilitet të lartë. Gjithashtu identifikohen boshllëqe në zhvillimin e shërbimeve për kategori si personat me probleme të shëndetit mendor, përdoruesit e drogave dhe alkoolit dhe kategori të tjera të nënadresuara në nivel vendor. Këto gjetje tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e nevojave sociale në territor tejkalojnë kapacitetet individuale të bashkive dhe kërkojnë një qasje të koordinuar në nivel rajonal.

Megjithëse sistemi i shërbimeve sociale në Qarkun Elbasan përballet me pabarazi territoriale, kapacitete të kufizuara dhe varësi të lartë nga financimet e jashtme, analiza eidenton gjithashtu ekzistencën e disa elementëve të rëndësishëm zhvillimi. Prania e shërbimeve të specializuara me funksion rajonal, përvoja e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërbashkiak, mekanizmat ekzistues të koordinimit dhe baza e krijuar e partneriteteve me organizatat e shoqërisë civile krijojnë kushte reale për zhvillimin gradual të një sistemi më të integruar, më të koordinuar dhe më të qëndrueshëm të shërbimeve sociale në nivel qarku.

Në tërësi, analiza eidenton se një pjesë e konsiderueshme e sfidave sociale në Qarkun Elbasan tejkalojnë kapacitetet individuale të bashkive dhe nuk mund të adresohen në mënyrë efektive vetëm në nivel vendor. Pabarazitë territoriale në aksesin ndaj shërbimeve, përqendrimi i kapaciteteve në disa bashki, nevoja për shërbime të specializuara me funksion ndërbashkiak, fragmentimi i të dhënave dhe varësia nga financimet e jashtme kërkojnë një rol më të konsoliduar koordinues të Këshillit të Qarkut në planifikimin, zhvillimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale në nivel rajonal. Në këtë kuadër, roli i qarkut nuk lidhet me ofrimin direkt të shërbimeve bazë, por me koordinimin ndërbashkiak, zhvillimin e mekanizmave rajonale të bashkëpunimit dhe mbështetjen e shërbimeve me karakter rajonal dhe të specializuar.

Bazuar në gjetjet e analizës, prioritetet strategjike të planit fokusohen në:

- zhvillimin dhe zgjerimin e shërbimeve të specializuara me karakter rajonal;
- reduktimin e pabarazive territoriale në aksesin ndaj shërbimeve;
- zhvillimin e shërbimeve të kujdesit afatgjatë për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç;
- forcimin e koordinimit ndërinstytucional dhe ndërbashkiak;
- standardizimin e përdorimit të të dhënave sociale për planifikim dhe vendimmarrje;
- si dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të sistemit të shërbimeve sociale.

Në tërësi, analiza e situatës sociale rajonale eidenton nevojën për kalimin nga një model i fragmentuar dhe kryesisht reaktiv i ndërhyrjeve sociale drejt ndërtimit të një sistemi rajonal më të integruar, më të koordinuar dhe më të qëndrueshëm, ku aksesin në shërbime

sociale të mos kushtëzohet nga territori, kapacitetet lokale apo mbështetja familjare, por të garantohet si një e drejtë për çdo qytetar në nevojë në të gjithë territorin e Qarkut Elbasan.

Analizat e detajuara tematike, institucionale dhe teknike mbi të cilat mbështetet kjo diagnozë paraqiten në Aneksat 3–13 të dokumentit.

5. Prioritetet strategjike rajonale objektivat, masat, aktivitetet dhe indikatorët

Në vijim të analizës së situatës sociale dhe në përgjigje të sfidave të identifikuar në nivel qarku, ky kapitull përcakton kornizën strategjike të ndërhyrjes për periudhën 2026-2030, duke orientuar zhvillimin e shërbimeve sociale përmes prioriteteve, objektivave, masave, aktiviteteve dhe indikatorëve të matshëm. Kjo kornizë synon të përkthejë gjetjet analitike në ndërhyrje konkrete dhe të realizueshme, duke siguruar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet nevojave të identifikuar dhe veprimit institucional në nivel qarku.

Vizioni

Qarku Elbasan zhvillon një sistem të integruar dhe të koordinuar rajonal të shërbimeve sociale, i cili përmes ofrimit të shërbimeve të specializuara ndërbashkiake, reduktimit të pabarazive territoriale dhe forcimit të mekanizmave të bashkëpunimit dhe referimit ndërinstitutional garanton akses të barabartë, cilësi të lartë dhe përmirësim të qëndrueshëm të mirëqenies për të gjitha kategoritë në nevojë.

Misioni

Plani Social Rajonal i Qarkut Elbasan orienton dhe koordinon zhvillimin e një sistemi funksional dhe të integruar të shërbimeve sociale, përmes forcimit të bashkëpunimit ndërbashkiak dhe ndërinstitutional, me synim përmirësimin e aksesit, cilësisë dhe mbulimit të shërbimeve për kategoritë në nevojë dhe reduktimin e pabarazive territoriale në të gjithë qarkun.

Qëllimi i përgjithshëm i Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan është të sigurojë zhvillimin e një sistemi të integruar, efektiv dhe të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, përmes koordinimit ndërbashkiak dhe zhvillimit të shërbimeve të specializuara rajonale, me synim rritjen e mbulimit, përmirësimin e cilësisë dhe reduktimin e pabarazive territoriale në aksesin e barabartë të kategorive në nevojë.

Në nivel qarku, sistemi i shërbimeve sociale paraqet një kombinim të shërbimeve ekzistuese me funksion rajonal dhe boshllëqe të rëndësishme në mbulim dhe akses. Ndërkohë që disa shërbime të specializuara funksionojnë dhe kërkojnë vijimësi dhe zgjerim, mungojnë ndërhyrje të integruara për kategori me nevoja të larta, si të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç. Aksesin në shërbime mbetet i pabarabartë ndërmjet bashkive, ndërsa koordinimi ndërinstitutional dhe përdorimi i shërbimeve

rajonale mbeten të kufizuara. Në këtë kontekst, plani orienton ndërhyrjet drejt forcimit të shërbimeve, koordinimit dhe aksesit në nivel qarku.

Plani strukturohet në tre prioritete të ndërlidhura, që synojnë zhvillimin e ofertës së shërbimeve, forcimin e rolit koordinues të qarkut dhe përmirësimin e aksesit për kategoritë në nevojë. Në afat të shkurtër, ndërhyrjet fokusohen në konsolidimin e shërbimeve ekzistuese dhe përmirësimin e mekanizmave të identifikimit dhe informimit; në afat të mesëm, në zhvillimin e shërbimeve të reja dhe zgjerimin e mbulimit territorial; ndërsa në afat të gjatë, në ndërtimin e një sistemi të integruar dhe të qëndrueshëm, të bazuar në koordinim ndërsektorial dhe përdorim efektiv të të dhënave

PRIORITETI 1: Konsolidimi dhe zhvillimi i shërbimeve sociale rajonale për rritjen e aksesit, mbulimit dhe cilësisë.

Ky prioritet synon forcimin e ofertës së shërbimeve sociale në nivel qarku, përmes konsolidimit të shërbimeve ekzistuese me funksion rajonal dhe zhvillimit të shërbimeve të reja të integruara për kategoritë me nevoja të larta dhe mbulim të kufizuar. Ndërhyrja fokusohet në sigurimin e vijimësisë së shërbimeve, zgjerimin territorial të mbulimit, përmirësimin e cilësisë dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare.

OBJEKTIVI 1.1: Konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve sociale rajonale, me fokus qëndrueshmërinë, cilësinë dhe mbulimin territorial.

Ky objektivi synon të forcojë shërbimet ekzistuese të specializuara me funksion rajonal dhe të zhvillojë shërbime të integruara të kujdesit afatgjatë për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç pa mbështetje familjare.

Masa 1.1.1: Konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve ekzistuese të specializuara me funksion rajonal.

Masa siguron vijimësinë, financimin dhe zgjerimin e shërbimeve rajonale ekzistuese, duke garantuar akses më të gjerë dhe përdorim efektiv nga të gjitha bashkitë

Aktivitete:

A 1.1.1.1 Identifikimi dhe listimi zyrtar i shërbimeve sociale me funksion rajonal

A 1.1.1.2 Formalizimi dhe rishikimi periodik i marrëveshjeve ndërmjet qarkut, bashkive dhe ofruesve, përfshirë transportin e përfituesve

A 1.1.1.3 Sigurimi i financimit dhe bashkëfinancimit për vijimësinë e shërbimeve rajonale prioritare

- A 1.1.1.3.1 sigurimit të vijimësisë së funksionimit për Qendrën Rajonale të Autizmit përmes financimit/bashkëfinancimit

- A 1.1.1.3.2 mbështetjes për funksionimin e Qendrës “Lulet e Diellit” në Gramsh
- A 1.1.1.3.3 sigurimit të vijimësisë së shërbimeve për viktimat e trafikimit (Tjetër Vizion)
- A 1.1.1.3.4 bashkëfinancimit të shërbimit të strehëzës për viktimat e dhunës, me synim zgjerimin e mbulimit rajonal
- A 1.1.1.3.5 planifikimit shumëvjeçar të financimit përmes buxhetit të qarkut, bashkive, Fondit Social dhe burimeve të tjera të mundshme.

A 1.1.1.4 Zgjerimi i shërbimeve të specializuara pranë Qendrës Rajonale të Autizmit, përfshirë shërbimet në familje dhe logopedinë

A 1.1.1.5 Monitorimi periodik i funksionimit, cilësisë, mbulimit dhe performancës së shërbimeve rajonale

Indikatorë:

- Numri i shërbimeve rajonale me financim/bashkëfinancim të siguruar nga buxheti i qarkut, bashkitë, Fondi Social ose burime të tjera të përcaktuara.
- Numri i shërbimeve të specializuara të zgjeruara ose të përmirësuara, përfshirë shërbimin në shtëpi, ekipin lëvizës dhe/ose logopedinë, sipas nevojës së evidentuar.
- Numri i përfituesve nga shërbimet rajonale, sipas kategorisë, bashkisë dhe gjinisë, përfshirë rastet e mbështetura me transport shtëpi - qendër - shtëpi.

Masa 1.1.2: Zhvillimi dhe funksionalizimi gradual i shërbimeve të integruara të kujdesit afatgjatë për të moshuarit në pamundësi për jetesë të pavarur dhe personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç pa mbështetje familjare ose në varësi të lartë.

Masa krijon kushtet për zhvillimin e një modeli të integruar të kujdesit afatgjatë për të moshuarit dhe PAK 18+, duke garantuar mbështetje të vazhdueshme për individët me nevoja të larta.

Aktivitetet:

A 1.1.2.1 Vlerësimi i nevojave dhe hartimi i modelit të integruar të kujdesit afatgjatë për të moshuarit dhe PAK 18+

A 1.1.2.2 Ngritja e shërbimit të kujdesit afatgjatë për të moshuarit (kujdes në familje, ekip lëvizës dhe/ose rezidencial)

A 1.1.2.3 Ngritja e shërbimit të kujdesit afatgjatë për PAK 18+ (kujdes në familje, ekip lëvizës dhe/ose rezidencial)

Indikatorë:

- Modeli i shërbimit të integruar i hartuar, kostuar, miratuar dhe i pajisur me plan zbatimi;
- Numri i shërbimeve të integruara të kujdesit afatgjatë të ngritura dhe funksionale, sipas kategorisë së përfituesve;
- Numri i përfituesve nga shërbimi i integruar i kujdesit afatgjatë, sipas kategorisë, bashkisë, gjinisë dhe llojit të kujdesit;
- % e përfituesve me plan individual kujdesi të hartuar, në zbatim dhe të rishikuar periodikisht

Prioriteti 2: Forcimi i rolit koordinues të Këshillit të Qarkut për planifikimin dhe zhvillimin e integruar të shërbimeve sociale

Ky prioritet adreson fragmentimin e ndërhyrjeve dhe përdorimin e kufizuar të të dhënave, duke synuar forcimin e koordinimit ndërinstytucional dhe ndërsektorial për planifikim dhe reagim më efektiv në fushën e shërbimeve sociale.

Ndërhyrja fokusohet në tre drejtime kryesore:

- mekanizma funksionale koordinimi ndërinstytucional dhe ndërsektorial
- përdorimi i të dhënave për planifikim dhe vendimmarrje
- reagimi i koordinuar në situata emergjente

OBJEKTIVI 2.1: Konsolidimi i koordinimit rajonal ndërinstytucional dhe ndërsektorial për planifikimin, referimin, ndjekjen e rasteve dhe reagimin në emergjenca

Ky objektivi synon forcimin e Komitetit Teknik Rajonal, formalizimin e bashkëpunimit me aktorët ndërsektorialë, miratimin e mekanizmave rajonale të referimit dhe ndjekjes së rasteve, funksionalizimin e sistemit të ndjekjes së rasteve (tracking), si dhe koordinimin e reagimit institucional në situata emergjente.

Masa 2.1.1: Forcimi i mekanizmit rajonal të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërsektorial

Masa fokuson ndërhyrjen në forcimin e mekanizmit rajonal të koordinimit ndërinstytucional për planifikimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale.

Aktivitete:

A 2.1.1.1 Konsolidimi dhe funksionimi i rregullt i Komitetit Teknik Rajonal

A 2.1.1.2 **Formalizimi i bashkëpunimit ndërinstytucional me aktorët sektorialë**, përfshirë Drejtorinë Rajonale të SHSSH-së, Universitetin ‘Aleksandër Xhuvani’, Zyrën Rajonale të AKPA-së dhe Operatorin Rajonal të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor

A 2.1.1.3 Organizimi i takimeve periodike të koordinimit ndërinstytucional ndërmjet qarkut, bashkive, institucioneve dhe aktorëve të tjerë

2.1.1.4 Përcaktimi dhe formalizimi i roleve dhe përgjegjësiive ndërinstytucionale.

- A 2.1.1.4.1 Mbështetja e bashkisë Peqin për referimin drejt shërbimeve rajonale.
- A 2.1.1.4.2 Lehtësimi i bashkëpunimit ndërbashkiak për përdorimin e shërbimeve rajonale.

A 2.1.1.5 Rishikimi periodik i Planit Social Rajonal bazuar në të dhëna dhe progres zbatimi

A 2.1.1.6 Publikimi periodik i vendimeve dhe rekomandimeve të Komitetit Teknik Rajonal në platformat zyrtare.

Indikatorë:

- Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me aktorë ndërsektorialë;
- Numri i takimeve koordinuese të zhvilluara në vit;
- % e vendimeve/rekomandimeve të Komitetit Teknik Rajonal të zbatuara.

Masa 2.1.2: Zhvillimi dhe zbatimi i modelit rajonal të referimit dhe ndjekjes së rasteve

Masa standardizon dhe bën funksional procesin e referimit dhe ndjekjes së rasteve ndërmjet bashkive dhe institucioneve.

Aktivitete:

A 2.1.2.1 Hartimi dhe miratimi i mekanizmit rajonal të referimit dhe ndjekjes së rasteve

A 2.1.2.2 Përfshirja e aktorëve jashtë sistemit social, përfshirë AKPA, shëndetësinë, qendrat e shëndetit mendor dhe arsimin, në rrjedhën e referimit dhe ndjekjes së rasteve

A 2.1.2.3 Lehtësimi i bashkëpunimit ndërbashkiak për akses në shërbime ndërterritoriale

A 2.1.2.4 Vendosja dhe funksionalizimi i sistemit të ndjekjes së rasteve (tracking)

A 2.1.2.5 Trajnimi i stafit të sektorëve socialë, veçanërisht NJVNR-ve, për zbatimin e mekanizmit ndërsektorial të referimit

A 2.1.2.6 Pilotimi, zbatimi dhe monitorimi i mekanizmit në nivel qarku.

Indikatorë:

- Mekanizmi rajonal i referimit dhe ndjekjes së rasteve të miratuara dhe në zbatim;

- % e bashkive dhe institucioneve që zbatojnë mekanizmin rajonal të referimit dhe ndjekjes së rasteve;
- % e rasteve të referuara që marrin shërbim ose ndiqen sipas procedurës së miratuar.

Masa 2.1.3: Forcimi i koordinimit ndërinstytucional për reagim në situata emergjente

Masa siguron një reagim të koordinuar dhe efektiv ndërinstytucional në situata emergjente sociale në nivel qarku.

Aktivitete:

A 2.1.3.1 Integrimi i aktorëve ndërsektorialë në protokollet e reagimit ndaj emergjencave sociale

A 2.1.3.2 Aktivizimi i roleve dhe përgjegjësive të përcaktuara për çdo aktor në situata krize

Indikatorë:

- Lista e kapaciteteve dhe shërbimeve të mobilizueshme e përditësuar;

OBJEKTIVI 2.2: Përmirësimi i përdorimit të të dhënave sociale për planifikim dhe vendimmarrje në nivel qarku

Ky objektivi synon të sigurojë që planifikimi dhe vendimmarrja në nivel qarku të bazohen në të dhëna të sakta, të unifikuara dhe të krahasueshme, përmes standardizimit të mbledhjes, shkëmbimit dhe analizës së të dhënave sociale ndërinstytucionale.

Masa 2.2.1: Standardizimi i mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave sociale ndërsektoriale

Masa mundëson ndërtimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave sociale për planifikim dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë në nivel qarku.

Aktivitete:

A 2.2.1.1 Hartimi i modelit të unifikuar të raportimit të të dhënave sociale

A 2.2.1.2 Përfshirja e të dhënave nga aktorë të tjerë, përfshirë punësimin, arsimin dhe shëndetësinë

A 2.2.1.3 Formalizimi i procedurave të shkëmbimit të të dhënave ndërinstytucionale

A 2.2.1.4 Zbatimi i modelit të unifikuar të raportimit të të dhënave në bashkitë dhe institucionet partnere

A 2.2.1.5 Hartimi i raporteve analitike rajonale për vendimmarrje

A 2.2.1.6 Përdorimi i të dhënave për rishikimin periodik të Planit Social Rajonal

Indikatorë:

- Modeli i unifikuar i raportimit të të dhënave sociale i miratuar dhe në përdorim;
- % e bashkive dhe institucioneve partnere që raportojnë rregullisht sipas modelit të unifikuar;
- Numri i raporteve analitike rajonale të hartuara dhe të përdorura për planifikim dhe vendimmarrje

PRIORITETI 3: Përmirësimi i aksesit efektiv në shërbimet sociale për kategoritë në nevojë

Ky prioritet synon të rrisë aksesin real të qytetarëve në shërbimet sociale përmes informimit të strukturuar, identifikimit të hershëm, orientimit fillestar dhe mbështetjes për përdorimin efektiv të shërbimeve. Ndërhyrja fokusohet veçanërisht në njësitë administrative dhe komunitetet ku niveli i informimit, identifikimit dhe përdorimi i shërbimeve sociale mbetet i kufizuar.

Prioriteti adreson hendekun ndërmjet nevojave të identifikuara dhe përfitimit real nga shërbimet, i lidhur kryesisht me nivelin e ulët të informimit, identifikimit e vonuar të rasteve dhe aksesin e kufizuar në shërbime, sidomos në njësitë administrative.

OBJEKTIVI 3.1: Rritja e aksesit efektiv në shërbimet sociale përmes informimit, identifikimit të hershëm dhe orientimit fillestar të qytetarëve në nevojë

Ky objektivi synon të forcojë lidhjen ndërmjet qytetarëve në nevojë dhe sistemit të shërbimeve sociale, duke siguruar informacion të qartë, identifikim më të hershëm të rasteve, orientim funksional dhe mbështetje fillestare për akses në shërbime.

Masa 3.1.1: Zhvillimi i fushatave të koordinuara rajonale për informimin dhe ndërgjegjësimin mbi shërbimet sociale

Kjo masë synon të rrisë informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi shërbimet sociale, përmes fushatave të koordinuara në nivel qarku, duke siguruar mesazhe dhe informacion të unifikuar, si dhe mbulim të balancuar territorial, veçanërisht në zonat dhe kategoritë me akses të kufizuar

Aktivitete

A 3.1.1.1. Hartimi i planit rajonal të komunikimit për shërbimet sociale

A 3.1.1.2 Përgatitja e paketës së unifikuar informuese për shërbimet sociale

A 3.1.1.3 Zbatimi i fushatave informuese në nivel qarku

A 3.1.1.4 Përdorimi i kanaleve të koordinuara të komunikimit

A 3.1.1.5 Monitorimi i zbatimit dhe mbulimit të fushatave

Indikatorë

- Plani rajonal i komunikimit dhe paketa e unifikuar informuese të hartuara dhe të përdorura nga bashkitë dhe institucionet partnere.
- Numri i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere të zhvilluara në nivel qarku, sipas bashkive/zonave prioritare.

Masa 3.1.2: Mbështetja e bashkive për orientimin fillestar dhe monitorimin rajonal të aksesit në shërbime sociale

Kjo masë synon të forcojë rolin mbështetës dhe koordinues të Këshillit të Qarkut në lehtësimin e aksesit të qytetarëve në shërbime sociale, përmes hartëzimit të shërbimeve ekzistuese, unifikimit të informacionit bazë për orientim fillestar dhe monitorimit të vështirësive që hasen nga bashkitë në aksesin në shërbime.

Aktivitete:

A 3.1.2.1 Hartimi dhe përditësimi i hartës/katalogut rajonal të shërbimeve sociale

A 3.1.2.2 Përcaktimi, në bashkëpunim me bashkitë, i pikave/personave të kontaktit për orientimin fillestar në bashki

A 3.1.2.3 Përgatitja dhe shpërndarja e paketës së unifikuar të informacionit për shërbimet sociale

A 3.1.2.4 Mbledhja periodike e të dhënave të agreguara mbi orientimin dhe vështirësitë në akses

A 3.1.2.5 Hartimi i rekomandimeve rajonale për përmirësimin e aksesit në shërbime sociale

Indikatorë

- Harta/katalogu rajonal i shërbimeve sociale i hartuar, i përditësuar periodikisht dhe i shpërndarë tek bashkitë dhe institucionet partnere.
- Raport periodik rajonal mbi aksesin në shërbime sociale i hartuar mbi bazën e të dhënave të agreguara nga bashkitë, me rekomandime për përmirësimin e aksesit.

6. Plani i Veprimit (matrica e kostimit)

PRIORITETI 1 - Zhvillimi dhe konsolidimi i shërbimeve të specializuara rajonale për rritjen e aksesit, mbulimit dhe cilësisë për kategoritë në nevojë

Masa	Aktivitete	Treguesit	Buxheti/ Burimi Financimit	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Institucionet përgjegjëse	
						Drejtoria/Spektori/ Departamenti (Udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)
Objektivi 1.1 – Konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve sociale rajonale, me fokus qëndrueshmërinë, cilësinë dhe mbulimin territorial							
<i>Masa 1.1.1 Konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve ekzistuese të specializuara me funksion rajonal</i>	1 - Identifikimi dhe listimi i shërbimeve rajonale	i) Numri i shërbimeve rajonale me financim të siguruar ii) Numri i shërbimeve të zgjeruara/përmirësuar (p.sh. ekip lëvizës, shërbim në shtëpi)	22,350 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2026	2026	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF dhe Donatorë
	2 - Formalizimi dhe rishikimi i marrëveshjeve ndërinstytucionale (përfshirë transportin e përfituesve)	iii) Numri i përfituesve nga shërbimet rajonale,	245,850 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2026	2027	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF dhe Donatorë

	3-Sigurimi i financimit/bashkëfinancimit për shërbimet rajonale prioritare	përfshirë rastet me transport të mbështetur					
	3.1 Qendra Rajonale e Autizmit		25,138,700 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 90,845,000 ALL Fondi Social	2026	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF dhe Donatorë
	3.2 Qendra “Lulet e Diellit”		9,300,000 ALL Keshilli i Qarkut 22,200,000 ALL Fondi Social 6,750,000 ALL Bashkia Gramsh	2026	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF dhe Donatorë

	3.3 Shërbimet për viktimat e trafikimit		11,575,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 79,257,500 ALL Fondi Social 6,750,000 ALL Tjetër Vizion	2026	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF dhe Donatorë
	3.4 Shërbimi i strehëzës për viktimat e dhunës		2,500,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2026	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF dhe Donatorë
	3.5 Planifikimi shumëvjeçar i financimit		Pa kosto shtesë për Këshillin e Qarkut Elbasan				
	4 - Zgjerimi i shërbimeve të specializuara të QRA (ekip lëvizës, shërbim në shtëpi)		11,520,000 ALL Fondi Social	2027	2030		

	5- Monitorimi dhe vlerësimi periodik i shërbimeve rajonale		204,160 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2027	2030		
<i>Masa 1.1.2 Zhvillimi dhe funksionalizimi gradual i shërbimeve të integruara të kujdesit afatgjatë për të moshuarit në pamundësi për jetesë të pavarur dhe personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç pa mbështetje familjare ose në varësi të lartë.</i>	1-Vlerësimi dhe projektimi i modelit të shërbimit të integruar (të moshuar & PAK 18+)	i) Modeli i shërbimit të integruar i hartuar dhe i miratuar ii) Numri i shërbimeve të kujdesit afatgjatë të ngritura dhe funksionale	40,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 160,000 All Donator i pambulluar	2027	2028	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF dhe Donatorë
	2- Ngritja e shërbimit të kujdesit afatgjatë për të moshuarit (në familje, ekip lëvizës, rezidencial)	iii) Numri i përfituesve nga shërbimi (sipas kategorisë, bashkisë dhe gjinisë)	12,960,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 51,840,000 ALL Donator i pambulluar	2028	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF dhe Donatorë
	3- Ngritja e shërbimit të kujdesit afatgjatë për PAK 18+ (në familje, ekip lëvizës, rezidencial)	iv) % e përfituesve me plan individual kujdesi në zbatim dhe të rishikuar	5,760,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 23,040.000 ALL	2030	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF dhe Donatorë

			Donator i pambuluar				
Totali			353,392,800				

PRIORITETI 2 – Forcimi i koordinimit rajonal për planifikimin dhe zhvillimin e integruar të shërbimeve sociale, nën drejtimin e Qarkut

Masa	Aktivitete	Treguesit	Buxheti/ Burimi Financimit	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Institucionet përgjegjëse	
						Drejtoria/Sektori/ Departamenti (Udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)
Objektivi 2.1 – Përmirësimi i koordinimit ndërbashkiak dhe zhvillimi i mekanizmave rajonalë për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale.							
<i>Masa 2.1.1: Forcimi i mekanizmit rajonal të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërsektorial</i>	1- Konsolidimi dhe funksionimi i Komitetit Teknik Rajonal	i) Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit ii) Numri i takimeve koordinuese	Pa kosto shtesë për Këshillin e Qarkut Elbasan	2026	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë

	2- Formalizimi i marrëveshjeve ndërsektoriale të bashkëpunimit	vjetore iii) % e vendimeve të zbatuara të Komitetit Teknik Rajonal	111,750 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2026	2027	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
	3- Organizimi i takimeve periodike të koordinimit ndërinstytucional		201,150 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2026	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
	4-Formalizimi i roleve dhe përgjegjësi në planifikim, zhvillim dhe monitorim (përfshirë koordinimin ndërbashkiak) 4.1Mbështetja e bashkisë Peqin për akses në shërbime rajonale 4.2 Lehtësimi i bashkëpunimit ndërbashkiak për		228,300 ALL Këshillin e Qarkut Elbasan	2026	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë

	përdorimin e shërbimeve rajonale						
	5- Rishikimi periodik i Planit Social Rajonal		40,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 160,000 ALL Donator i pambulluar	2028	2028	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
	6- Publikimi i vendimeve të Komitetit Teknik Rajonal në platformat zyrtare të Këshillit të Qarkut		Pa kosto shtesë për Këshillin e Qarkut Elbasan	2026	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
<i>Masa 2.1.2: Zhvillimi dhe zbatimi i modelit rajonal të referimit dhe ndjekjes së rasteve</i>	1- Hartimi dhe miratimi i modelit rajonal për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave sociale	i) Mekanizmi rajonal i referimit dhe ndjekjes në zbatim ii) % e bashkive/institu	40,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 160,000 ALL Donator i pambulluar	2027	2028	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë

	2- Përfshirja e aktorëve ndërsektorialë në mekanizmin e referimit	cioneve që zbatojnë mekanizmin	74,500 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2027	2028	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
	3- Lehtësimi i bashkëpunimit ndërbashkiak për akses në shërbime	iii) % e rasteve të referuara që marrin shërbim/ndiqen sipas procedurës	223,300 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2027	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
	4-Vendosja dhe funksionalizimi i sistemit të ndjekjes së rasteve (tracking)		40,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 160,000 ALL Donator i pambuluar	2027	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
	5-Trajnimi i stafit për zbatimin e mekanizmit të referimit		40,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 160,000 ALL	2027	2028	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social	OJF/ Donatorë

	6- Testimi, zbatimi dhe monitorimi i mekanizmit të referimit		Donator i pambulluar			dhe Shërbimeve Juridike	
Masa 2.1.3: Forcimi i koordinimit ndërinstytucional për reagim në situata emergjente	1- Integrimi i aktorëve ndërsektorialë në protokollet e emergjencës	i) Lista e kapaciteteve/ shërbimeve e përditësuar	40,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 160,000 ALL Donator i pambulluar	2027	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
	2- Aktivizimi i roleve dhe përgjegjësi në situata krize	ii) Numri i simulimeve/ takimeve për emergjenca iii) Protokollin e reagimit në emergjenca i miratuar dhe i përditësuar					
OBJEKTIVI 2.2: Përmirësimi i përdorimit të të dhënave sociale për planifikim dhe vendimmarrje në nivel Qarku							
Masa 2.2.1: Standardizimi i mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave sociale ndërsektoriale	1- Hartimi i modelit të unifikuar të raportimit	i) Modeli i unifikuar i raportimit në përdorim	80,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2028	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
	2- Përfshirja e të dhënave ndërsektoriale	ii) % e bashkive/institucioneve që raportojnë sipas modelit	320,000 ALL Donator i pambulluar				
	3- Formalizimi i shkëmbimit të të dhënave ndërinstytucionale						

	4- Zbatimi i modelit të raportimit në bashki dhe institucione	iii) Numri i raporteve analitike të përdorura për vendimmarrje					
	5- Hartimi i raporteve analitike rajonale						
	6- Përdorimi i të dhënave për rishikimin e planit						
Totali			2,457,900				

PRIORITETI 3 – Përmirësimi i aksesit efektiv në shërbime përmes informimit, identifikimit dhe orientimit të kategorive në nevojë.

Masa	Aktivitete	Treguesit	Buxheti /Burimi Financimit	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Institucionet përgjegjëse	
						Drejtoria/Spektori/ Departamenti (Udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)
Objektivi 3.1 – Rritja e informimit dhe ndërgjegjësimin të komunitetit për shërbimet sociale dhe për të drejtat e kategorive në nevojë.							
<i>Masa 3.1.1 – Zhvillimi i fushatave të koordinuara rajonale për informimin dhe ndërgjegjësimin</i>	1- Hartimi i planit rajonal të komunikimit	i) Plani i komunikimit dhe paketa informuese në përdorim ii) Numri i fushatave	255,200 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2027	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë

<i>mbi shërbimet sociale</i>	2- Përgatitja e paketës së unifikuar informuese	informuese të zhvilluara (sipas bashkive/zonave)	80,000 All Këshilli i Qarkut Elbasan 320,000 ALL Donator i pambuluar	2027	2030	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë		
	3- Zbatimi i fushatave informuese në nivel qarku		2.403,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan 2.597,000 ALL Donator i pambuluar	2026	2030				
	4- Përdorimi i kanaleve të koordinuara të komunikimit		Pa kosto shtesë për Këshillin e Qarkut Elbasan	2026	2030			Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
	5- Monitorimi i fushatave dhe mbulimit territorial		111,750 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2027	2030			Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë

<i>Masa 3.1.2: Mbështetja e bashkive për orientimin fillestar dhe monitorimin rajonal të aksesit në shërbime sociale</i>	1- Hartimi dhe përditësimi i hartës/katalogut të shërbimeve	i)Harta/katalogu i shërbimeve i përditësuar dhe i shpërndarë	111,750 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2028	2029	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë
	2- Përcaktimi i pikave/personave të kontaktit në bashkiPërcaktimi i pikave/personave të kontaktit në bashkiPërcaktimi i pikave/personave të kontaktit në bashki	ii) Raport periodik mbi aksesin në shërbime me rekomandime	388,250 ALL Donator i pambuluar				
	3- Përgatitja dhe shpërndarja e paketës informuese		133,980 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	120,000 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan	2027	2028	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike
			480,000 ALL Donator i pambuluar			Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike	OJF/ Donatorë

	4- Mbledhja periodike e të dhënave mbi aksesin në shërbime		255,200 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan				
	5- Hartimi i rekomandimeve për përmirësimin e aksesit		63,800 ALL Këshilli i Qarkut Elbasan				
Totali			7,353,500				

7. Metodologjia e kostimit dhe kuadri financiar

Kostimi i Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan është realizuar mbi bazën e një vlerësimi praktik të ndërhyrjeve të parashikuara, duke u mbështetur në analizën e nevojave të identifikuar dhe në kapacitetet reale institucionale dhe financiare të qarkut dhe bashkive. Vlerësimi është kryer nga stafi i Këshillit të Qarkut në bashkëpunim me bashkitë dhe aktorët lokalë, me qëllim që çdo ndërhyrje të jetë e realizueshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me burimet e disponueshme.

Kostimi është ndërtuar mbi një qasje nga poshtë-lart, duke u bazuar në aktivitetet konkrete të përcaktuara për çdo masë. Për çdo aktivitet janë analizuar elementët përbërës (burime njerëzore, materiale, logjistike dhe shërbime mbështetëse), duke siguruar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet planifikimit të ndërhyrjeve dhe vlerësimit financiar të tyre. Kostot janë strukturuar në funksion të natyrës së ndërhyrjeve dhe të zbatimit praktik të planit, duke përfshirë: (i) kosto për funksionimin dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese; (ii) kosto për zhvillimin e shërbimeve të reja; (iii) kosto për koordinimin, monitorimin dhe ngritjen e kapaciteteve; (iv) kosto për aktivitete ndërgjegjësuese dhe mbështetëse në komunitet.

Ndërhyrjet prioritare janë kostuar në mënyrë të detajuar, duke reflektuar shpenzimet reale të nevojshme për zbatimin e tyre në nivel qarku dhe ndërbashkiak. Vlerat e përcaktuara përfaqësojnë angazhimin financiar të nevojshëm për të garantuar vijimësinë e shërbimeve ekzistuese, përmirësimin e cilësisë dhe zgjerimin e mbulimit territorial.

Për shërbimet e identifikuar si prioritare, por që aktualisht nuk kanë mbështetje financiare, është realizuar një vlerësim indikativ i koston. Ky vlerësim shërben si bazë për planifikim afatmesëm dhe për orientimin e aplikimeve për financim, pa krijuar angazhim të menjëhershëm financiar për Këshillin e Qarkut.

Kuadri financiar i planit mbështetet në burime të identifikuar konkretisht gjatë procesit të hartimit: (i) kontributi i Këshillit të Qarkut Elbasan, i bazuar në fondet e planifikuara për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2026 dhe për periudhën 2027–2030; (ii) Fondi Social, si instrument financiar i dedikuar për mbështetjen e shërbimeve sociale në nivel vendor për të njëjtën periudhë; (iii) kontributet e donatorëve dhe partnerëve të tjerë, të cilat parashikohen të mobilizohen për mbulimin e ndërhyrjeve që nuk financohen nga burimet publike ekzistuese. Kjo ndarje siguron një balancë ndërmjet burimeve të brendshme dhe atyre të jashtme, duke rritur realizueshmërinë e planit.

Zbatimi i planit lidhet drejtpërdrejt me procesin e planifikimit buxhetor afatmesëm të Këshillit të Qarkut dhe bashkive, duke siguruar që ndërhyrjet prioritare të reflektohen në programet përkatëse buxhetore. Ky integrim mundëson vijueshmëri financiare, rrit transparencën dhe garanton ndjekjen e rregullt të zbatimit të planit në përputhje me burimet e disponueshme.

Tabela në vijim paraqet shpërndarjen e kostos totale të planit sipas prioriteteve strategjike dhe burimeve kryesore të financimit, duke reflektuar kontributin e Këshillit të Qarkut Elbasan dhe financimet e pritëshme nga Fondi Social dhe donatorët.

Tabela 4: Kostimi i prioriteteve strategjike dhe burimet e financimit për periudhën 2026-2030

Prioriteti	Kosto totale e prioritetit	Këshilli i Qarkut	Fondi Social	Donatorë
Prioriteti 1	353,392,800	67,780,300	255,662,500	29,950,000
Prioriteti 2	2,457,900	1,337,900	-	1,120,000
Prioriteti 3	7,353,500	3,568,250	-	3,785,250
Totali	363,204,200	72,686,450	255,662,500	34,855,250

8. Mekanizmi i zbatimit dhe qeverisjes

Zbatimi i Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan kërkon një ndarje të qartë rolesh dhe një koordinim funksional ndërmjet aktorëve. Këshilli i Qarkut merr përgjegjësinë për drejtimin dhe koordinimin në nivel rajonal, ndërsa bashkitë mbeten përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve në territor. Efektiviteti i këtij mekanizmi varet nga bashkëpunimi real ndërmjet institucioneve, nga përdorimi i përbashkët i burimeve dhe nga funksionimi i rregullt i mekanizmave të koordinimit dhe monitorimit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe praktikatat ekzistuese të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qarku.

8.1 Roli i Këshillit të Qarkut

Këshilli i Qarkut vepron si nyja kryesore e koordinimit dhe zhvillimit të shërbimeve me karakter rajonal. Roli i tij nuk është operativ, por orientues dhe mbështetës.

Në praktikë, kjo nënkupton:

- drejtimin e zbatimit të planit në nivel qarku dhe sigurimin e bashkërendimit ndërbashkiak;
- zhvillimin dhe mbështetjen e shërbimeve të specializuara që nuk mund të mbulohen në nivel bashkie;
- garantimin e vijimësisë së shërbimeve ekzistuese dhe mbështetjen e atyre që kanë karakter rajonal;
- orientimin dhe koordinimin e përdorimit të burimeve financiare;
- ndjekjen sistematike të progresit dhe raportimin mbi rezultatet.

Ky rol është thelbësor për të shmangur fragmentimin dhe për të ndërtuar një ofertë shërbimesh të balancuar në territor.

8.2 Roli i bashkive

Bashkitë mbeten përgjegjëse për kontaktin e drejtpërdrejtë me komunitetin dhe për ofrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor.

Ato:

- ofrojnë shërbimet bazë dhe komunitare;
- identifikojnë dhe referojnë rastet që kërkojnë ndërhyrje të specializuara;
- bashkëpunojnë në zhvillimin dhe bashkëfinancimin e shërbimeve ndërbashkiake;
- kontribuojnë në monitorimin e zbatimit të planit.

Ky rol garanton që ndërhyrjet të mbeten të lidhura me nevojat reale në territor.

8.3 Roli i organizatave joqeveritare

Organizatat joqeveritare janë një komponent i rëndësishëm i sistemit, veçanërisht në fushën e shërbimeve të specializuara.

Ato:

- ofrojnë shërbime për kategori specifike;
- testojnë dhe zhvillojnë modele të reja ndërhyrjeje;
- mbështesin zgjerimin e mbulimit dhe përmirësimin e cilësisë.

Kontributi i tyre rrit fleksibilitetin e sistemit, por kërkon koordinim të vazhdueshëm me institucionet publike.

8.4 Koordinimi ndërinstytucional

Koordinimi ndërinstytucional është kusht për funksionimin efektiv të planit dhe duhet të jetë i rregullt, i strukturuar dhe i orientuar drejt zgjidhjes së problematikave konkrete.

Ky koordinim realizohet përmes:

- takimeve periodike të aktorëve kryesorë;
- shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit dhe të dhënave;
- ndërhyrjeve të përbashkëta për rastet komplekse.

Në këtë proces, institucionet publike rajonale dhe qendrore luajnë një rol mbështetës dhe rregullator, duke kontribuar në harmonizimin e politikave sektoriale, garantimin e standardeve të shërbimeve dhe mbështetjen teknike të ndërhyrjeve në nivel qarku.

Në mungesë të një koordinimi funksional, ndërhyrjet paraqesin nevojë për konsolidim dhe koordinim më të strukturuar, duke kufizuar ndikimin e tyre në territor

8.5 Partneritetet

Partneritetet janë instrument kyç për zgjerimin e kapaciteteve dhe sigurimin e burimeve.

Në këtë kuadër:

- mundësojnë bashkëfinancimin e shërbimeve dhe projekteve;
- mbështesin ngritjen e shërbimeve të reja;
- lehtësojnë transferimin e praktikave të mira.

Roli i tyre është veçanërisht i rëndësishëm në kushtet e kufizimeve financiare të sistemit.

8.6 Menaxhimi i rrezikut

Zbatimi i planit përballet me rreziqe konkrete që lidhen me financimin, kapacitetet institucionale dhe funksionimin e koordinimit ndërinstitucional.

Rreziqet kryesore përfshijnë:

- **ndërprerjen e financimit të shërbimeve të mbështetura nga donatorët**, duke rrezikuar vijimësinë e tyre;
- **mbingarkesën e kapaciteteve ekzistuese njerëzore**, që mund të kufizojë ndjekjen dhe monitorimin e ndërhyrjeve;
- **mosfunksionimin e rregullt të mekanizmave të koordinimit ndërbashkiak**, duke çuar në fragmentim të ndërhyrjeve;
- **mosrealizimin e bashkëfinancimit ndërmjet bashkive**, që mund të pengojë zhvillimin e shërbimeve rajonale.

Për adresimin e këtyre rreziqeve, parashikohen masa të drejtpërdrejta që përfshijnë:

- përdorimin e **marrëveshjeve ndërbashkiake** për garantimin e bashkëfinancimit dhe ndarjen e përgjegjësisë;
- forcimin e rolit të qarkut **në monitorimin periodik të zbatimit të planit** dhe në ndjekjen e shërbimeve rajonale;
- integrimin e shërbimeve ekzistuese **në mekanizma më të qëndrueshëm financimi publik**;
- organizimin e **takimeve të rregullta koordinuese** për ndjekjen e progresit dhe zgjidhjen e problematikave në kohë reale.

Tabela 5: Mekanizmi i zbatimit dhe qeverisjes

Aktori	Roli kryesor	Përgjegjësitë kryesore	Instrumentet e zbatimit	Niveli i ndërhyrjes
Këshilli Qarkut Elbasan	Koordinues, mbështetës dhe zhvillues i shërbimeve të specializuara	<ul style="list-style-type: none"> - Drejton dhe koordinon zbatimin e planit - Zhvillon dhe mbështet shërbime rajonale - Siguron vijimësinë e shërbimeve ekzistuese - Bashkërendon burimet financiare - Monitoron progresin 	<ul style="list-style-type: none"> - Fondi Social - Marrëveshje ndërbashkiake - Plane veprimi rajonale - Mekanizma monitorimi - Takime koordinuese 	Strategjik/ Rajonal
Bashkitë	Ofrues dhe planifikues vendor i shërbimeve	<ul style="list-style-type: none"> - Ofron shërbime bazë - Identifikon dhe referon rastet - Bashkëfinancon shërbimet rajonale - Raporton mbi zbatimin 	<ul style="list-style-type: none"> - Plane sociale vendore - Buxhete bashkiake - Mekanizma referimi - Marrëveshje bashkëpunimi 	Operacional/ Vendor
Organizatat joqeveritare	Ofrues komplementar dhe zhvillues modelesh	<ul style="list-style-type: none"> - Ofron shërbime të specializuara - Teston modele të reja - Mbështet zgjerimin e mbulimit 	<ul style="list-style-type: none"> - Projekte - Kontrata shërbimi - Partneritete 	Operacional / Komplementar
Institucionet publike	Mbështetës institucional dhe rregullator	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurojnë mbështetje teknike - Harmonizojnë politikat - Vendosin standarde 	<ul style="list-style-type: none"> - Kuadër ligjor - Programe kombëtare - Udhëzime 	Politikëbërës / Mbështetës
Partnerët dhe donatorët	Mbështetës financiar dhe teknik	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëfinancojnë shërbime - Mbështesin ngritjen e shërbimeve - Ofron asistencë teknike 	<ul style="list-style-type: none"> - Projekte - Grante - Asistencë teknike 	Mbështetës / Zhvillimor

Tabela përcakton ndarjen funksionale të roleve dhe instrumenteve të zbatimit, duke vendosur Këshillin e Qarkut si nivel koordinues dhe zhvillues të shërbimeve rajonale, ndërsa bashkitë mbeten përgjegjëse për ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve në territor.

9. Monitorimi, vlerësimi dhe mësimet e mësuara

Zbatimi i Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan mbështetet në një proces të vazhdueshëm monitorimi dhe vlerësimi, i cili nuk synon vetëm ndjekjen e progresit, por mbi të gjitha përmirësimin e ndërhyrjeve në kohë. Në këtë kuadër, monitorimi nuk trajtohet si një proces formal raportimi, por si një mekanizëm pune që lidh të dhënat me vendimmarrjen dhe rregullimin e ndërhyrjeve në nivel qarku.

Korniza e monitorimit ndërtohet mbi një ndarje të qartë përgjegjësish ndërmjet niveleve. Bashkitë dhe ofruesit e shërbimeve mbeten burimi kryesor i të dhënave, ndërsa Këshilli i Qarkut ka rolin e konsolidimit, analizës dhe ndjekjes së progresit në nivel rajonal. Ky organizim mundëson që informacioni të qarkullojë në mënyrë të rregullt dhe të përdoret për të kuptuar jo vetëm çfarë është realizuar, por edhe ku evidentohen hapësira për përmirësim.

Monitorimi zhvillohet në mënyrë periodike, duke ndjekur realizimin e aktiviteteve, funksionimin e shërbimeve dhe arritjen e rezultateve, me një fokus të veçantë të diferencat ndërmjet bashkive dhe aksesit real të kategorive në nevojë.

Matja e progresit bazohet në një set indikatorësh që mbulojnë gjithë ciklin e ndërhyrjes – nga burimet e përdorura deri te rezultatet e arritura. Përveç treguesve sasiorë, rëndësi i jepet edhe cilësisë së shërbimeve dhe përvojës së përfituesve, në mënyrë që monitorimi të mos kufizohet në numra, por të reflektojë realisht efektin e ndërhyrjeve në territor.

Indikatorët lidhen drejtpërdrejt me objektivat dhe masat e planit dhe përdoren si bazë për analizën e progresit dhe për vendimmarrje.

Raportimi shërben si mekanizëm lidhës ndërmjet të dhënave dhe vendimmarrjes. Të dhënat e mbledhura nga bashkitë dhe ofruesit konsolidohen në nivel qarku dhe përkthehen në raporte periodike, të cilat japin një pasqyrë të qartë mbi ecurinë e planit.

Ky proces synon gjithashtu identifikimin në kohë të çështjeve prioritare për përmirësim dhe nevojës për ndërhyrje korrigjuese. Standardizimi i të dhënave është thelbësor për të siguruar krahasueshmëri ndërmjet bashkive dhe për të ndërtuar një analizë të besueshme.

Një element thelbësor i sistemit është integrimi i feedback-ut nga terreni. Përvoja e përfituesve, vlerësimi i ofruesve dhe komunikimi me bashkitë kontribuojnë në një pasqyrë më të plotë të funksionimit të shërbimeve.

Ky informacion përdoret për të kuptuar më mirë pengesat në akses, cilësinë e ndërhyrjeve dhe nevojat që nuk adresohen mjaftueshëm, duke e bërë sistemin më të ndjeshëm ndaj realitetit në territor.

Rishikimi vjetor është momenti kryesor ku të dhënat e mbledhura gjatë vitit analizohen në mënyrë të strukturuar për të vlerësuar progresin dhe për të përcaktuar drejtimin e mëtejshëm të planit.

Ky proces shërben për të identifikuar devijimet dhe për të orientuar përmirësimet e nevojshme, për të kuptuar arsyet e tyre dhe për të përshtatur masat dhe aktivitetet, duke ruajtur fleksibilitetin e planit dhe lidhjen e tij me zhvillimet reale në qark.

Mësimet e mësuara: Monitorimi dhe vlerësimi marrin vlerë reale vetëm kur përkthehen në përmirësim të mënyrës së punës. Përvojat e krijuara gjatë zbatimit të planit shërbejnë si bazë për të nxënit institucional, duke mundësuar përhapjen e praktikave të mira, përmirësimin e procedurave dhe rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve.

Në këtë mënyrë, sistemi evoluon gradualisht drejt një modeli më të qëndrueshëm, më të koordinuar dhe më të orientuar drejt rezultateve të matshme në nivel qarku.

Tabela 6: Indikatorët dhe mjetet e monitorimit

Fusha / Objektivi	Indikatori	Njësia matëse	Burimi i të dhënave	Mjeti i monitorimit	Frekuenca	Institucioni përgjegjës
Zhvillimi i shërbimeve	Numri i shërbimeve të reja	Nr.	Këshilli i Qarkut Elbasan/ Bashkitë / OJF	Raport progresi	Vjetore	Këshilli i Qarkut Elbasan/ Bashkitë
Zhvillimi i shërbimeve	Shërbime të zgjeruara	Nr.	Këshilli i Qarkut Elbasan/ Bashkitë / OJF	Raport progresi	Vjetore	Bashkitë
Mbulimi	Përfitues total të ndarë sipas grupmoshës dhe gjinisë	Nr.	Këshilli i Qarkut Elbasan/ Bashkitë/OJFBashkitë / OJF	Databazë	Vjetore	Bashkitë
Mbulimi	Mbulimi i kategorive	%	Regjistrat e shërbimeve (bashki + OJF)	Raport analitik	Vjetore	Këshilli i Qarkut Elbasan/ Bashkitë
Kategori në nevojë	Përfitues të ndarë sipas grupmoshës dhe gjinisë	Nr.	Analizë e të dhënave (bashki + OJF)	Raport shërbimi	Vjetore	Bashkitë
Kategori në nevojë	Shërbime	Nr.	Qendrat / OJF / Bashkitë	Raport progresi	Vjetore	Këshilli i Qarkut Elbasan/ Bashkitë
Akses territorial	Bashki të mbuluara	Nr.	Këshilli i Qarkut Elbasan / OJF	Raport progresi	Vjetore	Këshilli i Qarkut Elbasan/ Bashkitë
Financimi	Financim publik	%	Këshilli i Qarkut Elbasan	Analizë	Vjetore	Këshilli i Qarkut Elbasan/ Bashkitë
Koordinimi	Takime koordinimi	Nr.	Raport financiar	Raport	Vjetore	Këshilli i Qarkut Elbasan/ Bashkitë
Cilësia	Kënaqësia e përfituesve, e analizuar sipas gjinisë dhe grupmoshës	%	Procesverbale (qark + bashki + OJF)	Anketim	Vjetore	Bashkitë
Kapacitetet	Trajnime stafi	Nr.	Pyetësorë (bashki + OJF)	Raport	Vjetore	Këshilli i Qarkut Elbasan

Tabela përcakton indikatorët kyç dhe mjetet për ndjekjen e progresit të planit, duke siguruar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet objektivave, rezultateve dhe mekanizmave të monitorimit në nivel qarku.

10. Komunikimi, transparenca dhe pjesëmarrja

Zbatimi i Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan kërkon një qasje të qëndrueshme komunikimi dhe transparenca, e cila shkon përtej publikimit formal të informacionit dhe mbështet funksionimin e vetë sistemit.

Në këtë kuadër, komunikimi, llogaridhënia dhe pjesëmarrja e komunitetit ndërthuren si elementë të një procesi të vetëm, që synon rritjen e aksesit, besimit dhe efektivitetit të ndërhyrjeve në territor.

10.1 Qasja e komunikimit

Qasja e komunikimit mbështetet në një proces të vazhdueshëm dhe funksional, ku informacioni nuk shpërndahet vetëm në mënyrë njëkahëshe, por qarkullon ndërmjet institucioneve dhe aktorëve në mënyrë të rregullt.

Në praktikë, kjo do të thotë që komunikimi shoqëron zbatimin e planit në çdo fazë, duke lehtësuar koordinimin ndërinstytucional, adresimin e problematikave dhe ndarjen e zgjidhjeve në kohë reale.

Në këtë kuadër, komunikimi nuk trajtohet si funksion i veçuar, por si instrument pune që ndihmon në mbajtjen aktive të lidhjes ndërmjet qarkut, bashkive dhe ofruesve të shërbimeve.

10.2 Informimi publik

Informimi publik synon të garantojë transparencë mbi zbatimin e planit dhe të sigurojë që komuniteti të ketë njohuri të qarta mbi shërbimet dhe mënyrën e aksesimit të tyre. Ky proces zhvillohet në mënyrë periodike dhe në forma të kuptueshme, duke synuar jo vetëm publikimin e informacionit, por edhe përdorimin e tij nga qytetarët.

Në praktikë, rëndësi i jepet përditësimit të rregullt të informacionit mbi progresin e planit dhe mbi shërbimet në dispozicion, duke shmangur komunikimin formal dhe duke u fokusuar në rritjen e aksesit real të kategorive në nevojë.

10.3 Mekanizmat e llogaridhënies

Llogaridhënia realizohet përmes një procesi të rregullt raportimi dhe transparenca, ku progresi i zbatimit të planit ndiqet dhe bëhet i aksesueshëm për aktorët institucionalë dhe publikun. Ky proces nuk kufizohet në përgatitjen e raporteve, por përfshin edhe diskutimin e rezultateve dhe të sfidave në kuadër të mekanizmave të koordinimit.

Në këtë mënyrë, llogaridhënia shërben si instrument për të mbajtur përgjegjësi mbi zbatimin e planit dhe për të mbështetur vendimmarrjen në bazë të të dhënave.

10.4 Pjesëmarrja e komunitetit

Pjesëmarrja e komunitetit është një element thelbësor për të siguruar që ndërhyrjet të jenë të lidhura me nevojat reale në territor. Përfshirja e përfituesve dhe aktorëve lokalë në proceset e konsultimit dhe feedback-ut mundëson identifikimin e problematikave që nuk reflektohen gjithmonë në të dhënat formale.

Në këtë kuadër, pjesëmarrja nuk trajtohet si një proces episodik, por si një mekanizëm i vazhdueshëm që kontribuon në përmirësimin e cilësisë dhe relevancës së shërbimeve.

ANEKSE

Aneksi 1: Kuadri ligjor dhe strategjik i Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan

Tabela 1.1

Niveli	Akti ligjor / politik	Qëllimi kryesor	Përdorimi në Planin Social Rajonal	Lidhja me Këshillin e Qarkut
Kushtetues	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	Garanton të drejtat sociale, barazinë dhe mosdiskriminimin	Vendos bazën normative për planifikimin e shërbimeve sociale	Justifikon rolin koordinues dhe ndërinstytucional të Këshillit të Qarkut
Ndërkombëtar	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC), Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD), CEDAW etj	Vendosin standarde minimale për mbrojtjen e grupeve vulnerabël	Orientojnë prioritetet për shërbime të specializuara dhe gjithëpërfshirëse	Justifikojnë nevojën për shërbime rajonale ndërbashkiake
Strategjik	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe Plani i Veprimit (VKM nr.152, 13.3.2024)	Orienton reformën e shërbimeve sociale	Siguron përputhshmëri strategjike të planit rajonal	Forcon rolin harmonizues dhe koordinues të Këshillit të Qarkut
	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 dhe Plani i Veprimit në zbatim të saj	Garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, parandalimi i dhunës dhe neglizhencës	Orienton zhvillimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe ndërhyrjeve të specializuara në nivel rajonal	Koordinon bashkitë për forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijës dhe monitoron zbatimin në nivel qarku

	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me aftësi të kufizuara	Përmirësimi i aksesit, përfshirjes dhe cilësisë së jetës për PAK	Orienton planifikimin e shërbimeve të specializuara dhe mbështetëse për PAK në nivel rajonal	Koordinon bashkitë për zhvillimin e shërbimeve të përbashkëta dhe monitoron zbatimin në nivel qarku
	Plani i Veprimit për Personat e Moshuar 2025–2030	Promovimi i moshimit aktiv dhe ofrimi i shërbimeve mbështetëse për të moshuarit	Mbështet identifikimin dhe planifikimin e shërbimeve komunitare dhe rezidenciale për të moshuarit	Lehtëson koordinimin ndërbashkiak për shërbime që nuk mbulohen individualisht nga bashkitë
	Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë Gjinore	Nxitja e barazisë gjinore dhe parandalimi i diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore	Orientojnë masat për shërbime mbështetëse për gratë dhe vajzat në nivel rajonal	Koordinon aktorët institucionalë për zbatimin e masave ndërsektoriale në nivel qarku
	Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve	Përmirësimi i përfshirjes sociale dhe aksesit në shërbime për komunitetet rome dhe egjiptiane	Mbështet ndërhyrjet e synuara dhe shërbimet gjithëpërfshirëse për komunitetet vulnerabël	Siguron koordinim dhe monitorim të masave ndërbashkiake për integrimin social
Ligjor	Ligji nr.121/2016 Për shërbimet e kujdesit shoqëror	Rregullon sistemin e shërbimeve sociale	Korniza bazë për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve	Përcakton detyrimin për Plane Sociale Rajonale

	Ligji nr.139/2015 Për vetëqeverisjen vendore	Përcakton kompetencat e pushtetit vendor	Qartëson rolet institucionale në planifikim	Legjitimon funksionin koordinues të Këshillit të Qarkut
	Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”	Garantimi i mbrojtjes, zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijës përmes një sistemi të integruar mbrojtjeje	Orienton masat për shërbimet për fëmijët në nevojë, parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të rrezikut, si dhe standardet e mbrojtjes së fëmijës në nivel rajonal	Këshilli i Qarkut siguron koherencën e planifikimit rajonal me politikat kombëtare për mbrojtjen e fëmijës dhe mbështet koordinimin ndërinstitutional
	Ligji nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore”	Promovimi i barazisë gjinore dhe parandalimi i diskriminimit me bazë gjinore në jetën publike dhe private	Siguron integrimin e perspektivës gjinore në analizën e nevojave, objektivat dhe masat e Planit Social Rajonal	Këshilli i Qarkut kontribuon në promovimin e barazisë gjinore përmes planifikimit rajonal dhe mbështetjes së masave ndërsektoriale
	Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”	Garantimi i përfshirjes së plotë dhe aksesit të barabartë të PAK në shërbime dhe jetë shoqërore	Orienton zhvillimin e shërbimeve të specializuara, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse për PAK në nivel rajonal	Këshilli i Qarkut mbështet koordinimin ndërbashkiak dhe nxit përputhjen me standardet e aksesueshmërisë

VKM	VKM nr.111/2018 dhe VKM nr.150/2019 për Fondin Social	Rregullojnë financimin e shërbimeve sociale	Mbështesin kostimin dhe financimin e masave	Nxisin koordinimin ndërbashkiak për financim
	VKM nr. 518/2018 për shërbimet komunitare dhe rezidenciale	Përcakton llojet dhe standardet e shërbimeve	Orientojnë dizajnin e shërbimeve rajonale	Sigurojnë standarde të unifikuara në nivel qarku
Profesional	Ligji nr.163/2014 Për Urdhrin e Punonjësve Socialë	Rregullon profesionin e punonjësit social	Siguron cilësinë e burimeve njerëzore	Mbështet monitorimin dhe koordinimin e shërbimeve

Aneksi 2: Metodologjia

2.1 Qasja e përgjithshme metodologjike

Metodologjia për hartimin e Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan është ndërtuar për të reflektuar realitetin territorial dhe institucional të rajonit, duke siguruar përputhje me reformën kombëtare të mbrojtjes sociale dhe praktikat ndërkombëtare të planifikimit social.

Në kontekstin e decentralizimit të shërbimeve sipas Ligjit nr. 121/2016, bashkitë kanë përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve sociale, ndërsa këshillat e qarqeve luajnë një rol strategjik në koordinimin e ndërhyrjeve rajonale dhe zhvillimin e shërbimeve të specializuara ndërbashkiake.

Plani Social Rajonal konceptohet si një instrument strategjik për identifikimin e boshllëqeve strukturore në sistemin e shërbimeve sociale, për forcimin e bashkëpunimit ndërbashkiak dhe për promovimin e një shpërndarjeje më të barabartë të shërbimeve në territorin e rajonit.

Metodologjia mbështetet në një qasje të kombinuar (mixed-methods), e cila integron analiza sasiore dhe cilësore në një proces planifikimi ciklik që përfshin analizën e situatës sociale, konsultimin me aktorët institucionalë, prioritizimin strategjik dhe planifikimin operacional.

Kjo qasje metodologjike siguron një lidhje të qartë ndërmjet analizës së situatës sociale, përcaktimit të prioriteteve strategjike, planifikimit të masave dhe mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të planit.

2.2 Burimet e të dhënave

Analiza e situatës sociale mbështetet në një kombinim burimesh statistikore, administrative dhe dokumentare. Burimet kryesore përfshijnë të dhëna nga INSTAT, databaza administrative të bashkive dhe institucioneve rajonale, databazën rajonale të shërbimeve sociale të Këshillit të Qarkut Elbasan, si dhe dokumente strategjike kombëtare dhe sektoriale.

Gjithashtu janë analizuar Planet Sociale Vendore të bashkive të rajonit dhe informacioni i mbledhur nga organizatat e shoqërisë civile dhe ofruesit e shërbimeve sociale. Këto burime përdoren në mënyrë të integruar për ndërtimin e diagnozës rajonale dhe për mbështetjen e procesit të prioritizimit strategjik.

2.3 Metodatat e analizës sasiore

Analiza sasiore përdoret për të identifikuar tendencat kryesore demografike dhe sociale në rajon dhe për të vlerësuar shpërndarjen territoriale të nevojave dhe mbulimin e shërbimeve sociale.

Analiza mbështetet në shqyrtimin e treguesve demografikë, identifikimin e grupeve vulnerabël dhe analizën e mbulimit territorial të shërbimeve sociale. Të dhënat analizohen, sa herë që është e mundur, të ndara sipas moshës, gjinisë dhe territorit, për të identifikuar pabarazitë territoriale dhe grupet më të rrezikuara nga përjashtimi social.

2.4 Metodatat e analizës cilësore

Analiza cilësore përdoret për të kuptuar më thellë nevojat sociale, barrierat në aksesin ndaj shërbimeve dhe sfidat institucionale në ofrimin e tyre.

Kjo analizë mbështetet në një kombinim instrumentesh konsultimi dhe mbledhjeje të evidencës, përfshirë takime institucionale me bashkitë e rajonit, fokus-grupe me përfaqësues të grupeve në nevojë dhe ofrues të shërbimeve sociale, intervista me organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale dhe pyetësorë strategjikë për strukturat sociale të bashkive.

Këto instrumente mundësojnë identifikimin e nevojave të paplotësuara, barrierave në aksesin ndaj shërbimeve dhe mundësive për ndërhyrje në nivel rajonal.

2.5 Krahasimi dhe ndërthurja e të dhënave (Triangulimi i të dhënave)

Për të rritur besueshmërinë e analizës, metodologjia mbështetet në triangulimin e të dhënave, duke kombinuar burime statistikore, administrative dhe cilësore.

Ky proces mundëson verifikimin e gjetjeve analitike, identifikimin e boshllëqeve në sistemin e shërbimeve sociale dhe ndërtimin e një diagnoze të konsoliduar për rajonin. Rezultatet e triangulimit përdoren si bazë për formulimin e prioriteteve strategjike dhe ndërhyrjeve në nivel rajonal.

2.6 Kufizimet metodologjike

Megjithëse metodologjia synon të sigurojë një analizë të plotë dhe të besueshme, procesi përballlet me disa kufizime të mundshme, veçanërisht në lidhje me disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave administrative ndërmjet bashkive. Gjithashtu, niveli i angazhimit të aktorëve lokalë mund të ndryshojë gjatë procesit të konsultimit.

Këto kufizime adresohen përmes triangulimit të të dhënave, konsultimeve interaktive me aktorët institucionalë dhe dokumentimit transparent të boshllëqeve të informacionit.

2.7 Të nxëniti dhe përshtatja interaktive

Procesi metodologjik është konceptuar si një proces adaptiv dhe interaktiv, në të cilin analizat, konsultimet dhe validimi institucional ndërveprojnë vazhdimisht gjatë hartimit të planit.

Gjetjet analitike dhe prioritetet strategjike rishikohen dhe përditësohen në bazë të të dhënave të reja dhe feedback-ut nga aktorët institucionalë. Kjo qasje siguron që planifikimi të mbetet fleksibël dhe i përgjegjshëm ndaj ndryshimeve në kontekstin social dhe institucional.

2.8 Roli i Grupit Teknik të Punës

Një Grup Teknik Pune i ngritur nga Këshilli i Qarkut Elbasan luan një rol të rëndësishëm gjatë gjithë procesit të planifikimit. Ky grup mbështet organizimin e konsultimeve institucionale, interpretimin e gjetjeve analitike dhe konfirmimin e prioritetëve strategjike.

Grupi Teknik shërben gjithashtu si një mekanizëm koordinimi ndërmjet institucioneve dhe si pikë lidhëse ndërmjet ekipit të hartimit të Planit dhe strukturave institucionale në rajon.

2.9 Metodologjia e prioritizimit

Procesi i prioritizimit synon të përkthejë gjetjet analitike në një grup të kufizuar dhe të qëndrueshëm prioritetesh strategjike. Prioritetet përcaktohen mbi bazën e disa kryesore: madhësia dhe rëndësia e nevojës sociale, pabarazitë territoriale, kapacitetet institucionale për ndërhyrje, mundësitë për bashkëpunim ndërbashkiak dhe përputhja me politikat kombëtare.

Prioritetet diskutohen dhe validohen me aktorët institucionalë për të siguruar që ato janë jo vetëm të justifikuara analitikisht, por edhe të realizueshme në praktikë.

2.10 Metodologjia e kostimit

Kostimi është një komponent kyç i metodologjisë dhe synon të përkthejë prioritetet strategjike në masa të realizueshme.

Procesi i kostimit ndjek një qasje poshtë-lart, duke filluar nga identifikimi i aktiviteteve konkrete për çdo masë. Për secilin aktivitet identifikohen kategoritë kryesore të kostove, përfshirë burimet njerëzore, kostot operative, infrastrukturën dhe kostot e ofrimit të shërbimeve. Vlerësimet e kostove zhvillohen në bashkëpunim me Grupin Teknik të Punës dhe institucionet përkatëse, duke u bazuar në standarde financiare ekzistuese dhe të dhëna të mëparshme buxhetore.

2.11 Validimi dhe konsultimi publik

Drafti i Planit Social Rajonal i nënshtrohet një procesi validimi dhe konsultimi publik për të siguruar transparencë, përfshirje dhe pronësi institucionale të dokumentit. Konsultimi përfshin përfaqësues të institucioneve rajonale dhe vendore, organizata të shoqërisë civile, ofrues të shërbimeve dhe përfaqësues të grupeve në nevojë.

Komentet dhe sugjerimet e mbledhura gjatë këtij procesi analizohen dhe reflektohen në versionin përfundimtar të Planit.

Aneksi 3: Analiza e burimeve njerëzore

Struktura organizative e administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan përbëhet nga 16 punonjës, të organizuar në dy drejtori kryesore. Funkcionet që lidhen me përkujdesin social janë të përqendruara brenda **Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike**, e cila mbulon një gamë të gjerë përgjegjësish, përfshirë dimensionin social në nivel qarku.

Ky konfigurim garanton një bazë funksionale për ushtrimin e rolit të qarkut në planifikimin, koordinimin dhe mbështetjen e shërbimeve sociale, në përputhje me kuadrin ligjor. Megjithatë, integrimi i funksioneve sociale brenda një drejtorie me portofol të zgjeruar kufizon nivelin e specializimit dhe fokusin e dedikuar ndaj zhvillimit dhe ndjekjes së politikave dhe shërbimeve sociale.

Në raport me kërkesat e Planit Social Rajonal, burimet njerëzore ekzistuese janë të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve koordinuese dhe mbështetëse, por paraqesin kufizime në ndjekjen proaktive të zhvillimit të shërbimeve të reja dhe në monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe mbulimit të tyre. Në këtë kuadër, ndërhyrjet e planit fokusohen në optimizimin e strukturës ekzistuese, përmes forcimit të koordinimit ndërinstitucional me bashkitë, aktorët publikë dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe përmes përmirësimit të proceseve të planifikimit dhe monitorimit në nivel qarku.

Zhvillimi i shërbimeve të reja me karakter rajonal, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç dhe të moshuarit, nuk mbështetet në zgjerimin e stafit, por në rritjen e eficiencës së kapaciteteve ekzistuese. Në këtë drejtim, roli i qarkut konsolidohet si strukturë planifikuese dhe koordinuese, që mbështet ofrimin e shërbimeve përmes mekanizmave të bashkëpunimit ndërbashkiak dhe partneriteteve. Paralelisht, vijimësia dhe zgjerimi i shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, viktimat e trafikimit dhe viktimat e dhunës kërkon një angazhim më të strukturuar në ndjekjen e kontraktimit, cilësisë dhe rezultateve.

Forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit mbetet një komponent kyç, përmes trajnimeve të targetuara, shkëmbimit të praktikave dhe përmirësimit të përdorimit të të dhënave dhe instrumenteve të monitorimit. Kjo mundëson rritjen e kapacitetit analitik dhe operativ të administratës pa shtuar personel.

Në përmbledhje, sfida kryesore nuk lidhet me numrin e burimeve njerëzore, por me organizimin dhe përdorimin e tyre në funksion të prioriteteve të planit, duke kërkuar një qasje më të strukturuar, të orientuar drejt rezultateve dhe me ndarje më të qartë funksionale për një ushtrim më efektiv të rolit të qarkut.

Aneksi 4: Analizë krahasuese e Planeve Sociale Vendore - Qarku Elbasan

1. Panorama e përgjithshme e planifikimit social vendor dhe qasja metodologjike

Analiza krahasuese përfshin Planet Sociale Vendore të shtatë bashkive të Qarkut Elbasan, të hartuara në periudha dhe cikle të ndryshme planifikimi për intervalin 2023-2028. Krahasimi fokusohet në mënyrën se si këto dokumente trajtojnë analizën e situatës sociale, identifikimin e grupeve në nevojë, pasqyrimin e burimeve dhe kapaciteteve, si dhe strukturën e formulimit të objektivave dhe masave. Evidentohen diferenca në nivelin e detajimit dhe strukturimit të analizës, të lidhura me disponueshmërinë e të dhënave, kapacitetet njerëzore dhe mënyrën e organizimit të procesit të planifikimit në nivel vendor, pa përbërë vlerësim krahasues të bashkive.

2. Diagnoza sociale dhe të dhënat në Planet Sociale Vendore

Në shumicën e Planeve Sociale Vendore evidentohet nevojë për forcimin dhe standardizimin e të dhënave të strukturuar për disa kategori në nevojë, veçanërisht për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, përtej informacionit që lidhet me përfitimet nga skemat cash. Kjo lidhet kryesisht me mungesën e formateve të unifikuara për mbledhjen sistematike të të dhënave sociale, duke kufizuar aftësinë e bashkive për identifikim dhe analizë të plotë të nevojave. Si rrjedhojë, planifikimi i shërbimeve mbetet i fragmentuar dhe i orientuar më shumë drejt menaxhimit të rasteve individuale sesa drejt ndërhyrjeve të bazuara në evidencë dhe planifikim afatmesëm.

3. Analiza e situatës së kategorive në nevojë dhe hapësirat për planifikim rajonal

Analiza tregon se situata sociale në Planet Vendore ndërtohet kryesisht mbi kategori për të cilat ekzistojnë të dhëna dhe shërbime funksionale në nivel bashkie, si familjet në nevojë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe komunitetet rom dhe egjiptian aty ku janë të pranishme. Në këtë kuadër, disa kategori të tjera, si personat LGBTIQ+ dhe përdoruesit e drogave dhe alkoolit, nuk reflektohen në mënyrë të njëtrajtshme në analizën e situatës së planeve vendore, duke nxjerrë në pah nevojën për një qasje plotësuese në nivel rajonal.

4. Shërbimet shoqërore dhe shpërndarja territoriale

Ofrimi i shërbimeve shoqërore në Qarkun Elbasan paraqet ndryshime në mbulimin dhe shpërndarjen territoriale ndërmjet bashkive, me përqëndrim më të lartë të shërbimeve në bashkitë me kapacitete më të konsoliduara dhe gamë më të kufizuar shërbimesh në bashkitë më të vogla dhe rurale. Ky konfigurim ndikon në aksesin dhe efektivitetin e ndërhyrjeve sociale dhe nxjerr në pah nevojën për një qasje më të koordinuar në nivel rajonal. Në të njëjtën kohë, përvoja dhe shërbimet ekzistuese në disa bashki përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin gradual të shërbimeve të përbashkëta në nivel qarku.

5. Kapacitetet institucionale dhe burimet njerëzore

Planet Sociale Vendore reflektojnë kapacitete të kufizuara njerëzore dhe institucionale, veçanërisht në bashkitë e vogla dhe rurale. Mungesa e profileve të specializuara, mbivendosija e roleve dhe funksionimi i pjesshëm i NJVRN-ve ndikojnë në cilësinë e menaxhimit të rasteve sociale, duke evidentuar nevojën për qasje më të harmonizuara dhe koordinim në nivel rajonal. Në këtë kuadër, këto kufizime përbëjnë një element të rëndësishëm referimi për analizën rajonale të nevojave dhe sfidave të përbashkëta në fushën e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore.

6. Implikime për Planin Social Rajonal të Qarkut Elbasan

Sinteza krahasuese tregon se një pjesë e nevojave sociale në Qarkun Elbasan kërkojnë ndërhyrje që tejkalojnë mundësitë e planifikimit në nivel bashkie. Plani Social Rajonal synon të luajë rol komplementar përmes zhvillimit të shërbimeve të specializuara të përbashkëta, mekanizmave të përbashkët të të dhënave dhe forcimit të koordinimit ndërbashkiak.

Sinteza krahasuese tregon se një pjesë e nevojave sociale të identifikuara në Qarkun Elbasan kërkojnë ndërhyrje që tejkalojnë kapacitetet dhe mundësitë e planifikimit në nivel individual bashkie. Diferencat në evidencën e disponueshme, mënyra e organizimit të shërbimeve dhe shkalla e mbulimit territorial bëjnë që disa nevoja të mos adresohen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha planet vendore. Në këtë kontekst, Plani Social Rajonal synon të luajë një rol komplementar ndaj planeve lokale, duke u fokusuar në zhvillimin e shërbimeve të specializuara që mund të përdoren nga më shumë se një bashki, në krijimin e mekanizmave të përbashkët për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave, si dhe në forcimin e koordinimit ndërbashkiak. Kjo qasje rajonale krijon mundësi për përdorim më efikas të burimeve njerëzore dhe financiare, shmangie të fragmentimit të ndërhyrjeve dhe rritje të qëndrueshmërisë së shërbimeve shoqërore në nivel qarku.

6.1 Prioritetet dhe objektivat

Prioritetet e Planit Social Rajonal fokusohen në çështjet që nuk adresohen në mënyrë efektive vetëm në nivel bashkie, përfshirë përmirësimin e përdorimit të të dhënave, standardizimin e proceseve të menaxhimit të rasteve dhe zhvillimin e shërbimeve të specializuara, në konsultim me bashkitë si përfituese dhe kontribuese potenciale.

6.2 Financimi

Financimi i Planit Social Rajonal konceptohet si mekanizëm bashkërendues për optimizimin e burimeve, krijimin e sinergjive ndërbashkiake dhe rritjen e qëndrueshmërisë së shërbimeve, veçanërisht për ndërhyrjet e specializuara.

Tabela 4.1: Tabelë krahasuese e analizës së Planeve Sociale Vendore (Qarku Elbasan) /Burimi: *Bashkitë e Qarkut Elbasan*

Bashkia	Periudha e Planit	Statusi i Planit	Thellësia e Diagnozës	Kategori të Adresuara	Kategori të Munguara	Shërbime Shoqërore të ofruara (publike dhe jo publike)	Kapacitete Institucionale	Statusi i Kostimit	Implikime Rajonale
Elbasan	2024–2027	I miratuar	Shumë e thelluar, bazuar në evidencë	Familje në nevojë, fëmijë, PAK, të moshuar, viktimë të dhunës/trafikimit, të rinjtë, gra dhe vajza në nevojë	Personat LGBTIQ+ Përdorues të alkoolit/drogës Personat me probleme të shëndetit mendor (përtej AK)	5 qendra rezidenciale për fëmijë. 2 shërbime në strehëza. 15 shërbime komunitare. 6 qendra zhvillimi 14 qendra ditore 9 shërbime në familje 10 shërbime të specializuara 4 shërbime këshillimi on line 8 Shërbime në situatë emergjence 3 shërbime të kujdesit alternativ	Relativisht të konsoliduara. NJVNR e ngritur dhe funksionale	Kostim i plotë shumëvjeçar-varësi financiare nga donatorë	Pikë referimi për qasjen rajonale; nevojë për shërbime të specializuara në shkallë qarku

Cërrik	2024–2027	I miratuar	E mirë, fokus demografik dhe komunitete vulnerabël	Fëmijë, NE, komuniteti rom/egjiptia, PAK, të moshuar, LGBTIQ+, përdorues të drogës dhe alkooli	Personat me probleme të shëndetit mendor (përtej AK)	1 qendër ditore për fëmijë 1 qendër rezidenciale për fëmijë 1 qendër ditore për të rinj	Të kufizuara në burime njerëzore. Rolin e NJVNR e kryejnë administratorët shoqërorë	Kostim i plotë shumëvjeçar-varësi financiare nga donatorë	Nevojë për shërbime të përbashkëta për PAK dhe të moshuar
Peqin	2024–2027	I miratuar	Shumë e thelluar, me analiza të detajuara	Familje në nevojë, Fëmijë, PAK, të moshuar, viktimat e dhunës/trafikimit, LGBTIQ+, përdorues të drogës dhe alkooli	Personat me probleme të shëndetit mendor (përtej AK)	1 qendër ditore sociale për fëmijë me AK në qytetin e Peqinit (aktivitete socializimi)	Të pamjaftueshme Rolin e NJVNR e kryejnë administratorët shoqërorë	Kostim i plotë shumëvjeçar-varësi financiare nga donatorë	Argument i fortë për shërbime rajonale dhe mekanizma koordinues

Prrenjas	2023–2026	I miratuar	E mirë, fokus rural dhe varfëri	Familje në nevojë, Fëmijë, PAK, të moshuar viktimat e dhunës/trafikimit, emigrantë të rikthyer	LGBTIQ+ përdorues të drogës dhe alkooli Personat me probleme të shëndetit mendor (përtej AK)	1 shërbim rehabilitimi dhe qendër zhvillimi për fëmijë me AK në qytet (logopedi, fizioterapi) 1 shërbim lëvizës për fëmijë me AK (logopedi, fizioterapi) 1 qendër ditore në qytet për të moshuar në nevojë 1 shërbim në shtëpi për të moshuar në nevojë	Të kufizuara, Rolin e NJVNR e kryejnë administratorët shoqërorë	Kostim i plotë	Nevojë për mbështetje rajonale dhe shërbime mobile
Librazhd	2025–2028	I miratuar	Mesatare, më tepër përshkruese	Familje në nevojë, Fëmijë, PAK, të moshuar, viktimat e dhunës/trafikimit, komunitetin rom dhe egjiptian	LGBTIQ+ përdorues të drogës dhe alkooli Personat me probleme të shëndetit mendor (përtej AK)	1 qendër zhvillimi për fëmijë me AK në qytet 1 shërbim lëvizës për AK në të gjithë bashkinë 1 qendër multifunktionale për fëmijë dhe të rinj me AK (nëpërmjet sigurimit të	Kapacitete të ulëta, ngarkesë e lartë. NJVRN është caktuar vetëm 1 person për qytetin ndërkohë për njësitë administrative rolin e NJVNR e kryejnë	Pa kostim të strukturuar	Nevojë për standardizim dhe shërbime rajonale

						transportit qendra mbulon të gjithë bashkinë) 1 qendër ditore për të moshuar në qytet	administratorët shoqërorë		
Gramsh	2025–2027	I miratuar	E kufizuar, fokus varfëri	NE, fëmijë, PAK, Të moshuar, viktima të dhunës dhe trafikimit, personat përdorues të alkoolit dhe drogës, familjet në divorc, familjet me nevojë për strehim	LGBTIQ+ Personat me probleme të shëndetit mendor (përtej AK)	1 shërbim i specializuar për fëmijë me AK (psikolog, fizioterapi) në qytetin e Gramshit	Kapacitete minimale. Rolin e NJVNR e kryejnë administratorët shoqërorë	Kostim ekzistues (Excel i ndarë)	Argument për shërbime rajonale të përbashkëta

Belsh	2024–2027	I miratuar	E kufizuar	NE, fëmijë, PAK, Të moshuar, viktima të dhunës dhe trafikimit, personat perdorues të alkoolit dhe droges, familjet në divorc, familjet me nevojë për strehim, Emigrantë të rikthyer	LGBTIQ+ Personat me probleme të shëndetit mendor (përtej AK), Emigrantë të rikthyer	1 qendër multifunkionale për të gjitha kategoritë në nevojë, kryesisht të moshuar dhe të rritur me AK, qyteti Belsh	Kapacitete të kufizuara. Rolin e NJVNR e kryejnë administratorët shoqërorë	Kostim i pjesshëm	Nevojë e lartë për ndërhyrje rajonale
--------------	-----------	------------	------------	---	---	---	--	-------------------	---------------------------------------

Aneksi 5: Analiza SWOT – Sistemi i Shërbimeve Sociale në Qarkun Elbasan

Analiza SWOT në vijim përmbledh në mënyrë sintetike gjendjen e sistemit dhe orienton prioritetet strategjike të planit.

Tabela 5.1. Analiza SWOT

<p>Përparësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Baza ekzistuese e shërbimeve sociale, me një numër funksional shërbimesh në nivel qarku dhe bashkish • Prania e shërbimeve të specializuara rajonale, që mbulojnë kategori me nevoja komplekse • Përvojë e konsoliduar bashkëpunimi ndërmjet bashkive, OJF-ve dhe donatorëve • Kuadër ligjor dhe institucional i qartë, që mbështet planifikimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale • Roli koordinues i Këshillit të Qarkut, i përcaktuar dhe në proces konsolidimi. 	<p>Dobësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pabarazi territoriale në shpërndarjen e shërbimeve, me boshllëqe në disa bashki dhe zona rurale • Mbulim i kufizuar i kategorive me nevoja komplekse, veçanërisht për të rriturit • Nivel i lartë përdorimi i financimeve të jashtme dhe nevojë për forcimin e qëndrueshmërisë financiare • Sisteme të fragmentuara të të dhënave, që kufizojnë planifikimin dhe monitorimin e bazuar në evidencë • Kapacitete të kufizuara për ndjekjen dhe monitorimin e planit në nivel qarku.
<p>Mundësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fondi Social si instrument për zgjerimin dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve sociale në nivel qarku • Reforma territoriale, që mundëson forcimin e rolit të qarkut dhe zhvillimin e shërbimeve ndërbashkiake • Ekzistenca e Planeve Sociale Vendore, si bazë për koordinim dhe ndërhyrje të integruara në nivel rajonal • Mekanizmat ndërbashkiak, për optimizimin e burimeve dhe reduktimin e pabarazive territoriale • Regjistri Kombëtar i Shërbimeve Shoqërore, për përmirësimin e të dhënave dhe planifikimit të orientuar nga evidenca • Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërsektorial, për rritjen e efikasitetit dhe integritetit të ndërhyrjeve. 	<p>Rreziqet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Reduktimi ose ndërprerja e financimeve nga donatorët, që mund të ndikojë në vijimësinë e shërbimeve • Thellimi i pabarazive territoriale, në mungesë të ndërhyrjeve të koordinuara rajonale • Diferenca në kapacitetet e bashkive, që mund të ndikojnë në zbatimin e njëtrajtshëm të planit në nivel qarku • Fragmentimi i ndërhyrjeve, për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm ndërinstytucional • Boshllëqe në cilësinë e planeve vendore, që mund të kufizojnë efektivitetin e planit rajonal • Vazhdimësia e modelit të ndërhyrjes së orientuar ndaj reagimit, në mungesë të zhvillimit të qasjeve parandaluese.

Aneksi 6: Roli i Këshillit të Qarkut në zhvillimin e shërbimeve sociale dhe partneritetet ndërinstitucionale

Këshilli i Qarkut Elbasan ushtron një rol thelbësor në planifikimin, koordinimin dhe mbështetjen e zhvillimit të shërbimeve sociale në territor, veçanërisht për adresimin e nevojave dhe boshllëqeve që tejkalojnë kapacitetet individuale të bashkive. Ky rol materializohet përmes orientimit strategjik të shërbimeve me karakter rajonal, përdorimit të instrumenteve financiare si Fondi Social dhe lehtësimit të mekanizmave të bashkëpunimit ndërbashkiak.

Në praktikë, zhvillimi i shërbimeve sociale në nivel qarku mbështetet në një sistem partneritetesh ndërinstitucionale që përfshin bashkitë, institucionet publike sektoriale, organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët. Këto partneritete kanë qenë vendimtare në ngritjen dhe funksionimin e një pjese të konsiderueshme të shërbimeve, veçanërisht atyre të specializuara, duke kontribuar në zgjerimin e mbulimit dhe diversifikimin e ofertës në territor.

Megjithatë, analiza eidenton se ky model zhvillimi mbetet i fragmentuar dhe në një masë të konsiderueshme i varur nga financimet e jashtme dhe projektet afatshkurtra. Kjo varësi kufizon qëndrueshmërinë e shërbimeve, krijon paqëndrueshmëri në ofrim dhe e zhvendos fokusin nga planifikimi afatgjatë drejt ndërhyrjeve të fragmentuara.

Në këtë kontekst, forcimi i rolit të Këshillit të Qarkut kërkon kalimin nga një qasje kryesisht lehtësuese në një rol më të strukturuar drejtues dhe koordinues, përmes institucionalizimit të partneriteteve dhe formalizimit të mekanizmave të bashkëpunimit ndërbashkiak. Kjo përfshin zhvillimin e marrëveshjeve shumëvjeçare ndërmjet bashkive, përcaktimin e qartë të përgjegjësisë institucionale, si dhe ndërtimin e mekanizmave të përbashkët për planifikimin, financimin dhe monitorimin e shërbimeve me karakter rajonal.

Paralelisht, kërkohet konsolidimi i mekanizmave të qëndrueshëm të financimit, duke rritur rolin e qarkut në orientimin e burimeve publike dhe në harmonizimin e tyre me fondet e donatorëve, me qëllim reduktimin e varësisë nga projektet dhe garantimin e vijimësisë së shërbimeve prioritare.

Në përmbledhje, roli i Këshillit të Qarkut konsolidohet si një funksion kyç në ndërtimin e një sistemi social rajonal të integruar, ku koordinimi efektiv, partneritetet e formalizuara dhe mekanizmat e qëndrueshëm të financimit përbëjnë kushtet bazë për rritjen e cilësisë, mbulimit dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve sociale në territor.

Aneksi 7: Analiza e detajuar demografike, Qarku Elbasan

1. Konteksti demografik

Sipas të dhënave të regjistrit civil të përditësuar në korrik 2025, popullsia rezidente e regjistruar në Qarkun Elbasan arrin në 448,362 shtetas, nga të cilët 226,022 janë meshkuj dhe 222,340 femra (Burimi: Këshilli i Qarkut Elbasan, korrik 2025). Struktura gjinore paraqitet relativisht e balancuar dhe në linjë me trendin kombëtar. Megjithatë, analiza demografike duhet të marrë në konsideratë edhe diferencën ndërmjet të dhënave të regjistrit civil dhe rezultateve të Censit 2023, e cila lidhet kryesisht me proceset e migrimit dhe me ndryshimet demografike që kanë ndikuar në strukturën reale të popullsisë banuese në territor.

Tabela 7.1: Popullsia rezidente në Qarkun Elbasan sipas burimeve statistikore

	Total	Meshkuj	Femra
Numri i shtetasve rezident në Qark sipas Regjistrit Civil (të ndarë sipas gjinive)	448.362	226.022	222.340
Numri i shtetasve resident në Qark sipas Cens 2023 (të ndarë sipas gjinive)	232.580	115.473	117.107

Në këtë kuadër, interpretimi i treguesve demografikë duhet të vendoset edhe në një perspektivë më të gjerë kohore, në mënyrë që të kuptohen më qartë implikimet për zhvillimin social dhe planifikimin e shërbimeve në territor. Evolucioni demografik i dekadës së fundit tregon se Qarku Elbasan është pjesë e trendit kombëtar të rënies së popullsisë dhe plakjes demografike, i ndikuar nga migrimi i brendshëm drejt qendrave urbane dhe migrimi i jashtëm. Kjo prireje ka dy implikime të rëndësishme për zhvillimin social të territorit: nga njëra anë redukton gradualisht bazën e popullsisë aktive dhe potencialin e zhvillimit ekonomik lokal, ndërsa nga ana tjetër rrit presionin mbi sistemet e kujdesit social dhe socio-shëndetësor, veçanërisht në bashkitë me strukturë më të plakur demografike.

2. Struktura e moshës dhe treguesit e varësisë

Struktura e moshës në Qarkun Elbasan tregon një profil demografik të balancuar në dukje, por me shenja të qarta plakjeje. Fëmijët 0–14 vjeç përbëjnë 15.3% të popullsisë (35,563 persona), grupmosha 15–64 vjeç përbën 65.0% (151,278 persona), ndërsa popullsia 65+ arrin në 19.7% (45,739 persona). Përqendrimi i popullsisë së moshuar është praktikisht më e lartë se ajo e fëmijëve, çka ka rëndësi të drejtpërdrejtë për planifikimin e shërbimeve sociale dhe socio-shëndetësore.

Tabela 7.2: Struktura e moshës në Qarkun Elbasan (Cens 2023)

Grupmosha	Numri	Pesha
0–14 vjeç	35,563	15.3%
15–64 vjeç	151,278	65.0%
65+ vjeç	45,739	19.7%

Në terma të varësisë demografike, qarku regjistron raport varësie të re prej 23.5%, raport varësie të vjetër prej 30.2% dhe raport varësie totale prej 53.7%. Në nivel kombëtar, INSTAT raporton raport varësie të re 24.0% dhe raport varësie të vjetër 30.4%, pra raport varësie totale 54.4%. Kjo do të thotë se Elbasani ndodhet shumë pranë profilit kombëtar, por me një peshë të lartë të moshës së tretë dhe me nevojë për ndërhyrje më të qarta në shërbimet për të moshuarit, kujdesin në familje dhe mbështetjen komunitare.

Tabela 7.3: Struktura e moshës dhe treguesit e varësisë demografike – Qarku Elbasan krahasuar me Shqipërinë

Treguesi	Qarku Elbasan	Shqipëria	Koment	Implikimi për planifikimin social
0–14 vjeç	35,563 (15.3%)	—	Pesha e fëmijëve është më e ulët se ajo e popullsisë 65+.	Nevojë për politika mbështetëse për familjet dhe fëmijët.
15–64 vjeç	151,278 (65.0%)	—	Grupmosha aktive mbetet baza kryesore e mbështetjes demografike.	Potencial për zhvillim ekonomik dhe mbështetje të sistemit social.
65+ vjeç	45,739 (19.7%)	—	Plakja demografike është një element kyç për planifikimin social.	Rritje e kërkesës për shërbime për të moshuarit.
Raporti i varësisë së re	23.5%	24.0%	Pak nën nivelin kombëtar.	Presion relativisht i moderuar nga popullsia e re.
Raporti i varësisë së vjetër	30.2%	30.4%	Shumë pranë mesatares kombëtare.	Nevojë për zgjerimin e shërbimeve komunitare.
Raporti i varësisë totale	53.7%	54.4%	Ngarkesa demografike mbi popullsinë në moshë pune është e lartë.	Nevojë për politika të balancuara sociale dhe ekonomike.

Një tregues shtesë i procesit të plakjes demografike është edhe indeksi i plakjes së popullsisë. Në Qarkun Elbasan ky indeks arrin rreth 129, çka do të thotë se për çdo 100 fëmijë në moshën 0–14 vjeç ka rreth 129 persona të moshës 65 vjeç e lart.

Këta tregues tregojnë se, edhe pse struktura demografike e qarkut mbetet e ngjashme me profilin kombëtar, procesi gradual i plakjes së popullsisë kërkon forcimin e shërbimeve komunitare dhe të kujdesit afatgjatë për të moshuarit, si dhe zhvillimin e modeleve territoriale të shërbimeve sociale në bashkitë e qarkut.

3. Shpërndarja territoriale e popullsisë

Shpërndarja territoriale e popullsisë në Qarkun Elbasan tregon një përqendrim të lartë të popullsisë në Bashkinë Elbasan, e cila përfaqëson rreth 49.5% të popullsisë rezidente të qarkut. Bashkitë e tjera kanë peshë dukshëm më të ulët, mes 7.1% dhe 10.8%. Kjo do të thotë se kërkesa potenciale për shërbime sociale, administrative dhe komunitare është e përqendruar kryesisht në Elbasan, por nevojat për akses territorial dhe për modele të lëvizshme mbeten kritike në bashkitë më të vogla dhe më të shpërndara gjeografikisht.

Nga ana tjetër, analiza sipas grupmoshave tregon diferenca të rëndësishme territoriale. Belshi paraqet peshën më të lartë të popullsisë 65+, pasuar nga Cërriku dhe Peqini, ndërsa Prrenjasi dhe Librazhdi kanë strukturë relativisht më të re. Këto ndryshime kanë implikime direkte për modelin territorial të shërbimeve sociale.

Tabela 7.4: Struktura demografike sipas bashkive – Cens 2023

Bashkia	Popullsia	Pesha në qark	0–14 vjeç	65+ vjeç	Indeksi i plakjes	Profil demografik
a	b	c	d	e	$f=(e/d) \times 100$	
Belsh	17,123	7.4%	13.4%	25.0%	186	Strukturë e plakur
Cërrik	25,163	10.8%	14.1%	22.1%	157	Strukturë e plakur
Elbasan	115,101	49.5%	15.5%	19.1%	123	Strukturë relativisht e plakur
Gramsh	16,533	7.1%	15.1%	19.1%	126	Strukturë relativisht e plakur
Librazhd	23,312	10.0%	16.3%	17.9%	110	Strukturë më e balancuar
Peqin	16,580	7.1%	14.6%	20.5%	140	Strukturë relativisht e plakur
Prrenjas	18,768	8.1%	17.2%	16.8%	98	Strukturë më e re

Profilizimi demografik i bashkive bazohet në indeksin e plakjes së popullsisë (Ageing Index), i cili mat raportin ndërmjet popullsisë 65+ dhe popullsisë 0–14 vjeç.

Një tregues i qartë i strukturës territoriale të popullsisë është edhe përqendrimi demografik në Bashkinë Elbasan, e cila përfaqëson rreth gjysmën e popullsisë së qarkut. Ky nivel përqendrimi tregon se planifikimi i shërbimeve sociale duhet të balancojë ndërmjet kërkesës së lartë për shërbime në qendrën urbane dhe nevojës për modele territoriale të aksesit në bashkitë më të vogla dhe më të shpërndara gjeografikisht.

Këto diferenca territoriale tregojnë se zhvillimi i shërbimeve sociale në nivel rajonal duhet të bazohet në modele të diferencuara territoriale, duke kombinuar përqendrimin e shërbimeve në qendrën urbane të Elbasanit me mekanizma që garantojnë akses të barabartë në bashkitë më të vogla dhe më të shpërndara gjeografikisht të qarkut.

4. Përfundim analitik për diagnozën sociale

Leximi i treguesve demografikë tregon se Qarku Elbasan paraqet tri karakteristika me rëndësi strategjike për Planin Social Rajonal: një peshë të konsiderueshme demografike në nivel kombëtar, një përqendrim shumë të lartë të popullsisë në Bashkinë Elbasan dhe një proces të qartë të plakjes demografike. Këto zhvillime tregojnë se dinamika e popullsisë në qark ndikohet njëkohësisht nga proceset e përqendrimit urban dhe nga ndryshimet në strukturën e moshës së popullsisë.

Në këtë kuadër, analiza demografike përbën një element orientues për prioritetet e Planit Social Rajonal, pasi ajo evidenton nevojën për zhvillimin paralel të dy linjave kryesore të ndërhyrjes. Së pari, forcimin e mbështetjes për familjet dhe fëmijët, me qëllim ruajtjen e bazës demografike të territorit dhe përmirësimin e mirëqenies së familjeve. Së dyti, zgjerimin gradual të shërbimeve komunitare dhe të kujdesit për të moshuarit, në përputhje me procesin e plakjes demografike dhe me nevojën për të garantuar mbështetje sociale për këtë grupmoshë.

Në të njëjtën kohë, diferenca territoriale ndërmjet bashkive tregojnë se planifikimi i shërbimeve sociale në nivel rajonal duhet të mbështetet në modele të diferencuara territoriale të ofrimit të shërbimeve, duke kombinuar përqendrimin e shërbimeve në qendrën urbane të Elbasanit me mekanizma që garantojnë akses të barabartë për popullsinë e bashkive më të vogla dhe më të shpërndara gjeografikisht të qarkut.

Tabela A 3.5: Gjetjet kryesore demografike dhe implikimet për planifikimin social rajonal

Gjetja kryesore demografike	Evidenca nga analiza	Implikimi për planifikimin social rajonal
Pesha e konsiderueshme demografike e qarkut	Qarku Elbasan ka rreth 232,580 banorë sipas Censit 2023	Kërkon koordinim rajonal për zhvillimin e shërbimeve të specializuara të kujdesit shoqëror për kategoritë në nevojë, në përputhje me rolin e Këshillit të Qarkut sipas Ligjit nr. 121/2016.
Përqendrimi i popullsisë në Bashkinë Elbasan	Rreth 49.5% e popullsisë së qarkut jeton në Bashkinë Elbasan	Planifikimi rajonal duhet të marrë në konsideratë përqendrimin urban dhe të zhvillojë shërbime të specializuara me mbulim rajonal që mund të shërbejnë për të gjitha bashkitë e qarkut.
Procesi i plakjes së popullsisë	Pesha e popullsisë 65+ është në rritje dhe në disa bashki është më e lartë se ajo e fëmijëve	Kërkon zhvillimin e shërbimeve të specializuara për të moshuarit dhe shërbimeve komunitare në nivel rajonal.
Diferencat territoriale ndërmjet bashkive	Bashkitë e qarkut kanë profile të ndryshme demografike dhe struktura të ndryshme të moshës	Kërkon një qasje rajonale për zhvillimin e shërbimeve të specializuara që mbulojnë nevojat e kategorive vulnerabël në të gjithë territorin e qarkut.

Burimi: Përpunim i autorit bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 (INSTAT).

Aneksi 8: Analiza e detajuar e situatës së familjeve në nevojë, Qarku Elbasan

Plani Social Rajonal adreson familjet në nevojë si një nga kategoritë kryesore të politikave të mbrojtjes sociale. Këto familje, për shkak të të ardhurave të pamjaftueshme dhe kushteve ekonomike të pafavorshme, nuk arrijnë të sigurojnë nevojat bazë të jetesës. Në këtë kuadër, Ligji nr. 57/2019 parashikon mbështetje financiare përmes skemës së Ndhmës Ekonomike si instrumenti kryesor i mbështetjes ekonomike për këtë kategori. Megjithatë, jo të gjitha familjet në nevojë përfitojnë nga kjo skemë, për shkak të kufizimeve në informacion, kritere dhe mbulim.

Analiza e të dhënave për përfituesit e skemës së Ndhmës Ekonomike tregon se në vitin 2025, në nivel qarku rezultojnë 10,612 familje përfituese. Duke marrë në konsideratë se

sipas Censurit 2023 në qark janë rreth 78,000 familje, vlerësohet se rreth 14% e tyre përfshihen në këtë skemë. Ky tregues evidenton një nivel të konsiderueshëm të vulnerabilitetit socio-ekonomik dhe peshën që zë kjo kategori në strukturën sociale të qarkut.

Tabela 8.1: Familjet përfituese të Ndhmës Ekonomike sipas bashkive

Bashkia	Familje përfituese të Ndhmës Ekonomike	Pesha në qark (%)
Belsh	465	4.4
Cërrik	695	6.5
Elbasan	3,485	32.8
Gramsh	1,527	14.4
Librazhd	1,879	17.7
Peqin	893	8.4
Prrenjas	1,668	15.7

Shpërndarja territoriale e familjeve përfituese paraqet diferenca të qarta ndërmjet bashkive. Bashkia Elbasan përfaqëson rreth një të tretën e përfituesve në nivel rajonal, ndërsa Librazhdi dhe Prrenjasi mbajnë gjithashtu një peshë të konsiderueshme. Në të kundërt, Peqini, Cërriku dhe Belshi paraqesin nivele më të ulëta relative, duke reflektuar dallime në strukturën demografike dhe socio-ekonomike të territorit.

Familjet në nevojë përballen me faktorë të ndërthurur si papunësia afatgjatë, të ardhurat e ulëta dhe akses i kufizuar në shërbime sociale, veçanërisht në zonat rurale. Të dhënat tregojnë se rreth 38% e të papunëve kërkues pune janë anëtarë të familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike, duke konfirmuar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet varfërisë dhe papunësisë. Në të njëjtën kohë, vetëm 22.6% e tyre ndjekin programe formimi profesional, çka evidencon një hendek të konsiderueshëm ndërmjet nevojës për aktivizim ekonomik dhe mbulimit aktual të ndërhyrjeve në tregun e punës.

Tabelat 8.2 (1+2); Papunësia dhe Formimi Profesional (Qarku Elbasan)

Tabela 1 – Pjesëmarrja në tregun e punës dhe formim profesional

Tregues	Vlerë	%	Interpretim
Të papunë kërkues pune	7,341	100%	Popullata aktive në kërkim pune
Anëtarë të familjeve NE	2,796	38.10%	Pjesë e konsiderueshme e të papunëve vijnë nga familje në nevojë
Persona në formim profesional	1,658	22.60%	Pjesëmarrje relativisht e kufizuar në trajnim

Tabela 2 – Hendeku NE – Papunësi – Formim profesional

Dimensioni	Vlerë	Analizë
Pesha e NE në papunësi	38.10%	Lidhje e fortë midis varfërisë dhe papunësisë
Pjesëmarrja në formim profesional	22.60%	Jo e mjaftueshme për të adresuar papunësinë
Hendeku i aktivizimit	I lartë	Shumica e të papunëve mbeten jashtë trajnimit
Integrimi ekonomik	I kufizuar	Trajnimet nuk arrijnë mbulim të gjerë

Në këtë kontekst, dimensionimi i punësimit dhe formimit profesional paraqitet si element kyç për daljen nga varfëria. Të dhënat konfirmojnë lidhjen e fortë ndërmjet varfërisë, papunësisë dhe aksesit të kufizuar në formim profesional.

Një pjesë e konsiderueshme e familjeve në nevojë jetojnë në zona rurale dhe të largëta, ku aksesueshmëria ndaj shërbimeve sociale mbetet e kufizuar. Distanca nga qendrat urbane, infrastruktura e dobët dhe kapacitetet institucionale të kufizuara krijojnë pabarazi territoriale në mbulimin dhe ofrimin e shërbimeve.

Shërbimet për familjen mbeten të kufizuara dhe të pabarabarta territorialisht, me varësi të konsiderueshme nga projektet dhe financimet e jashtme (paraqitet tek Harta e shërbimeve sociale). Në nivel qarku, këto shërbime përfshijnë ndërhyrje në familje, mbështetje psikosociale dhe këshillim familjar, paketa ushqimore, klasa prindërimi dhe shërbime lëvizëse, me një numër relativisht të kufizuar përfituesish dhe mungesë të dhënash për disa ndërhyrje. Në të njëjtën kohë, mungon informacioni mbi faktin nëse familjet përfituese

janë apo jo pjesë e skemës së Ndhmës Ekonomike, çka kufizon vlerësimin e targetimit të ndërhyrjeve ndaj familjeve më vulnerabël.

Në nivel sistematik, evidentohet dominimi i mbështetjes financiare në raport me zhvillimin e shërbimeve sociale komunitare, si dhe mungesa e ndërhyrjeve të integruara që kombinojnë mbështetjen ekonomike me shërbime sociale, mbështetje psikosociale dhe orientim drejt punësimit. Aktualisht, ndërhyrjet për familjen janë të kufizuara dhe të shpërndara në mënyrë të pabarabartë ndërmjet bashkive, me një varësi të konsiderueshme nga financimet e jashtme dhe kufizime në qëndrueshmërinë dhe mbulimin territorial të shërbimeve.

Zhvillimi i një sistemi më të qëndrueshëm dhe më të balancuar territorial të shërbimeve sociale për familjen përbën një prioritet të rëndësishëm për planifikimin rajonal. Forcimi i shërbimeve publike, institucionalizimi i ndërhyrjeve të suksesshme dhe zhvillimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërbashkiak mund të kontribuojnë në zgjerimin e mbulimit dhe përmirësimin e aksesit të familjeve në nevojë ndaj shërbimeve.

Në të njëjtën kohë, roli i qarkut në koordinimin ndërbashkiak është thelbësor për identifikimin e boshllëqeve territoriale dhe për zhvillimin e ndërhyrjeve të përbashkëta me ndikim rajonal.

Në përmbledhje, familjet në nevojë përbëjnë një nga grupet më të ekspozuara ndaj vulnerabilitetit socio-ekonomik në Qarkun Elbasan. Adresimi i nevojave të tyre kërkon një qasje më të integruar dhe të koordinuar në nivel rajonal, e orientuar drejt zgjerimit të shërbimeve komunitare, reduktimit të pabarazive territoriale dhe zhvillimit të shërbimeve të specializuara me mbulim ndërbashkiak.

Tabela 8.3: Përmbledhje e situatës për familjet në nevojë në nivel qarku

Elementi	Evidenca	Problemi	Implikimi
Ndihma Ekonomike	10,612 familje (~14%)	Nivel i lartë vulnerabiliteti	Nevojë për ndërhyrje të integruara
Papunësia	38% e përfituesve të NE-së janë të papunë	Varësi nga mbështetja financiare	Forcim i aktivizimit ekonomik
Formimi Profesional	Vetëm 22.6% ndjekin formim	Mbulim i ulët i programeve	Zgjerim i formimit profesional
Shërbimet sociale	Numër i kufizuar shërbimesh dhe përfituesish	Mbulim i pjesshëm dhe i pabarabartë	Zgjerim dhe balancim territorial
Të dhënat	Mungon lidhja me përfituesit e NE-së	Targetim i paqartë	Forcim i sistemeve të të dhënave

Aneksi 9: Analiza e detajuar e situatës për personat me aftësi të kufizuara (PAK), Qarku Elbasan

1. Përshkrimi i grupit dhe rëndësia sociale

Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një nga grupet prioritare të politikave të mbrojtjes sociale dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Aftësia e kufizuar lidhet me kufizime funksionale të përhershme ose afatgjata që ndikojnë në pjesëmarrjen e individëve në jetën sociale, arsimore dhe ekonomike, duke krijuar nevojë për mbështetje të vazhdueshme nga familja, komuniteti dhe institucionet publike. Në këtë kuptim, personat me aftësi të kufizuara përfaqësojnë një kategori që kërkon ndërhyrje të integruara të politikave sociale, të orientuara drejt përmirësimit të aksesit në shërbime, përfshirjes sociale dhe mbështetjes së familjeve kujdestare.

Në Qarkun Elbasan, personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë dhe paraqesin një dimension të rëndësishëm të situatës sociale në territor. Të dhënat administrative tregojnë se në nivel qarku rezultojnë 14,022 persona me aftësi të kufizuara, të cilët përfaqësojnë rreth 3.13% të popullsisë së qarkut. Struktura e këtij grupi sipas kategorive të paaftësisë dhe shpërndarja territoriale e rasteve paraqiten në tabelën sintetike të mëposhtme.

Tabela 9.1: Treguesit kryesorë për personat me aftësi të kufizuara në Qarkun Elbasan

Indikatori	Vlera
Numri total i personave me aftësi të kufizuara	14,022 persona
Pesha në popullsinë e qarkut	3.13%
PAK të tjerë	75%
Persona të verbër	21%
Para dhe tetraplegjikë	4%
Bashkia me përqendrimin më të madh të PAK	Elbasan (~50%)
Shpërndarja në bashkitë e tjera	rreth 7 - 9% secila

Shënim: Termi “PAK të tjerë” i referohet personave me aftësi të kufizuara të vlerësuar sipas modelit bio-psiko-social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Struktura e personave me aftësi të kufizuara në qark tregon dominimin e kategorisë së personave të vlerësuar sipas modelit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, e cila përfaqëson pjesën më të madhe të rasteve të identifikuar. Kjo tregon se pjesa më e madhe e personave me aftësi të kufizuara në qark i përket kategorive të vlerësuar në bazë të kufizimeve funksionale dhe të nevojës për mbështetje sociale dhe rehabilituese.

Në të njëjtën kohë, një pjesë më e vogël e personave me aftësi të kufizuara përbëhet nga kategori specifike, si personat e verbër dhe personat para dhe tetraplegjikë, të cilët zakonisht kërkojnë forma më intensive të mbështetjes, shërbime rehabilituese të specializuara dhe ndërhyrje të vazhdueshme sociale.

Nga pikëpamja territoriale, evidentohet një përqendrim i konsiderueshëm i personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Elbasan, ku jeton rreth gjysma e totalit të rasteve në qark. Në të njëjtën kohë, shpërndarja e pjesës tjetër të personave me aftësi të kufizuara në bashkitë e tjera të qarkut, me rreth 7-9% të rasteve secila, tregon se nevojat për mbështetje sociale janë të pranishme në të gjithë territorin e qarkut.

Në këtë kontekst, personat me aftësi të kufizuara përfaqësojnë një kategori me rëndësi të veçantë për planifikimin social rajonal, pasi nevojat e tyre lidhen jo vetëm me mbështetjen financiare përmes skemave të mbrojtjes sociale, por edhe me aksesin në shërbime rehabilituese, edukative, sociale dhe komunitare që mundësojnë përfshirjen e tyre aktive në jetën e komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe të familjeve kujdestare.

2. Të dhënat ekzistuese dhe shpërndarja territoriale

Sipas të dhënave të administruara në nivel qarku, në Qarkun Elbasan rezultojnë 14,022 persona me aftësi të kufizuara, të cilët përbëjnë rreth 3.13% të popullsisë së qarkut. Këto të dhëna tregojnë se personat me aftësi të kufizuara përfaqësojnë një dimension të rëndësishëm të situatës sociale në qark dhe kërkojnë një planifikim të strukturuar të shërbimeve sociale dhe rehabilituese.


Struktura e personave me aftësi të kufizuara sipas kategorive të paaftësisë tregon se:

- rreth 75% i përkasin kategorive të tjera të paaftësisë,
- 21% janë persona të verbër,
- ndërsa 4% janë para dhe tetraplegjikë.

Analiza territoriale tregon një përqendrim të konsiderueshëm të personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Elbasan, ku jeton rreth 50% e totalit të PAK në qark. Bashkitë e tjera të qarkut paraqesin një shpërndarje relativisht të ngjashme, me rreth 7 - 9% të rasteve secila.

Figura paraqet përqendrimin më të lartë të personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Elbasan, ndërsa bashkitë e tjera të qarkut paraqesin një shpërndarje relativisht të ngjashme të rasteve.

Figura 9.1: Shpërndarja e personave me aftësi të kufizuara sipas bashkive në Qarkun Elbasan



Shpërndarja territoriale e personave me aftësi të kufizuara në Qarkun Elbasan tregon një përqendrim të konsiderueshëm të rasteve në Bashkinë Elbasan, ndërsa bashkitë e tjera të qarkut paraqesin një shpërndarje më të balancuar të rasteve. Ky konfigurim territorial nënvizon nevojën për zhvillimin e një modeli të koordinuar rajonal të shërbimeve sociale, ku shërbimet e specializuara mund të organizohen në nivel rajonal, ndërsa shërbimet komunitare bazë të zhvillohen në nivel vendor.


Shërbime sociale të ofruara për PAK

Analiza e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara në Qarkun Elbasan tregon praninë e disa qendrave ditore dhe shërbimeve zhvillimore të ofruara nga bashkitë, Këshilli i Qarkut dhe organizatat e shoqërisë civile. Shërbimet kryesore përfshijnë qendra zhvillimi, shërbime ditore, terapi rehabilituese dhe mbështetje psikosociale për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Megjithatë, shumica e këtyre shërbimeve janë të përqendruara në qendrat urbane dhe veçanërisht në Bashkinë Elbasan, ndërsa bashkitë e tjera të qarkut kanë një numër më të kufizuar shërbimesh. Po ashtu evidentohet një fokus më i madh i shërbimeve tek fëmijët me aftësi të kufizuara, ndërsa shërbimet për të rinjtë dhe të rriturit mbeten të kufizuara.

Tabela 9.2: Shërbimet ekzistuese për personat me aftësi të kufizuara në Qarkun Elbasan

Nr	Enti zbatues	Qendra/ Shërbimi	Niveli i mbulimit	Kategoria përfituese	Lloji i shërbimit	Vendndodhja	Grupmosha	Numri i përfituesve
1	Bashkia Prrenjas	Qendra Komunitare për Fëmijët me AK	Bashkiak	Fëmijë AK	Shërbim ditor	Prrenjas	3-18	56
2	Bashkia Elbasan	Qendra Publike Balashe	Bashkiak	PAK	Shërbim ditor i specializuar	Elbasan		28
3	Bashkia Peqin	Qendra për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara	Bashkiak Njësi Administrative	PAK	Shërbime edukative dhe psikosociale	Peqin	6-18	14
4	Këshilli i Qarkut Elbasan	Qendra e Autizmit Elbasan	Rajonal	Fëmijë me autizëm	Qendër zhvillimi / shërbim ditor	Elbasan		70
5	Qarku Elbasan	Qendra “Future for You”	Rajonal	Fëmijë me sindromën Down	Qendër ditore	Elbasan		37
6	Bashkia Librazhd	Qendra Komunitare për Persona me Aftësi të Kufizuara	Bashkiak	PAK	Qendër zhvillimi / shërbim ditor	Librazhd		80
7	Bashkia Gramsh	Qendra Ditore “Lulet e Dielli”	Bashkiak	Fëmijë me AK	Shërbim ditor zhvillimi	Gramsh	2-16	8
8	OJF Bijat e Dashurisë	Qendra “Shiko me Zemrën”	Ndërbashkiak	PAK/ spektri i autizmit	Psikoterapi	Mollas (Cërrik)	0-18	10
9	OJF Bijat e Dashurisë	Qendra Vincencian Fizioterapie	Ndërbashkiak	Fëmijë/ PAK	Fizioterapi	Mollas (Cërrik)		20
10	World Vision Albania	Qendra Multifunkionale Kia GLP	Bashkia Librazhd	Fëmijë dhe të rinj me AK	Shërbime të specializuara / pajisje ndihmëse	Librazhd	2-16	75
11	World Vision Albania	Projekti i Shëndetit	Rajonal	Fëmijë me AK	Mbështetje me pajisje ndihmëse	Elbasan / Librazhd	0-18	30

Grafiku 9.1: Analiza e mbulimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara



Grafiku tregon diferencën e konsiderueshme midis numrit total të personave me aftësi të kufizuara në qark dhe numrit të përfituesve të shërbimeve ekzistuese, duke evidentuar një hendek të madh në mbulimin e nevojave për shërbime.

Megjithëse në qark funksionojnë disa qendra dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara, kapaciteti i tyre mbetet i kufizuar krahasuar me numrin total të personave me aftësi të kufizuara në territor.

Për të paraqitur më qartë diferencën ndërmjet nevojave dhe kapacitetit aktual të shërbimeve, tabela e mëposhtme paraqet treguesit kryesorë të mbulimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në qark.

Tabela 9.3: Shërbimet, kapaciteti dhe hendeku i mbulimit

Treguesi	Vlera	Interpretimi
Numri total i personave me aftësi të kufizuara në qark	14.022	Popullsia totale e PAK në Qarkun Elbasan
Numri i përfituesve të shërbimeve ekzistuese	428	Personat që aktualisht marrin shërbime nga qendrat dhe projektet ekzistuese
Hendeku i mbulimit të shërbimeve	13.594	Numri i personave me PAK që nuk mbulohehen nga shërbimet ekzistuese

Në këtë kuadër, niveli rajonal luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit të shërbimeve të specializuara ndërbashkiake për personat me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar aksesin në shërbime rehabilituese dhe mbështetëse, si dhe duke forcuar koordinimin ndërmjet institucioneve dhe njërive vendore në nivel qarku.

3. Sfidat dhe problematikat kryesore

Gjetjet nga takimet konsultative dhe fokus-grupet me institucionet vendore dhe ofruesit e shërbimeve sociale në qark evidentojnë disa sfida të rëndësishme në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara.

3.1 Sfidat në aksesin dhe vazhdimësinë e shërbimeve

Një nga problematikat kryesore lidhet me mungesën e vijimësisë së shërbimeve pas moshës 21 vjeç. Shërbimet ekzistuese janë të orientuara kryesisht drejt fëmijëve me aftësi të kufizuara, ndërsa mbështetja për të rinjtë dhe të rriturit mbetet e kufizuar. Kjo krijon boshllëqe në ofrimin e shërbimeve rehabilituese dhe sociale për këtë kategori dhe vështirësi në tranzicionin nga shërbimet për fëmijë drejt mbështetjes për jetën e pavarur.

Në të njëjtën kohë evidentohet një numër në rritje i kërkesave për mbështetje nga personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht në rastet kur mungon ose është humbur mbështetja nga ndihmësi personal. Në këto kushte rritet nevoja për zhvillimin e shërbimeve të asistencës në familje dhe në komunitet për personat që nuk kanë mbështetje familjare.

3.2 Sfidat në kapacitetet e shërbimeve të specializuara

Një tjetër sfidë lidhet me kapacitetet e kufizuara të shërbimeve të specializuara, veçanërisht për ndërhyrjet terapeutike dhe rehabilituese. Në këtë drejtim evidentohet edhe mbingarkesa e Qendrës së Autizmit për shkak të kërkesës në rritje për shërbime nga familjet dhe personat me aftësi të kufizuara.

Mungesa ose kufizimi i disa shërbimeve të specializuara e bën të vështirë ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për këtë kategori dhe krijon presion më të madh mbi shërbimet ekzistuese.

3.3 Sfidat territoriale në aksesin në shërbime

Shpërndarja territoriale e shërbimeve mbetet gjithashtu e pabarabartë, pasi shumica e shërbimeve janë të përqendruara në qendrat urbane, ndërsa familjet që jetojnë në zonat rurale përballen me vështirësi më të mëdha në aksesin në shërbime rehabilituese dhe mbështetëse.

Kjo situatë nënvizon nevojën për zhvillimin e shërbimeve ndërbashkiake dhe për forcimin e koordinimit rajonal në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses më të barabartë në shërbime, pavarësisht vendbanimit.

3.4 Sfidat në të dhënat dhe planifikimin e shërbimeve

Një problematikë e rëndësishme lidhet me mungesën e informacionit të detajuar dhe të përditësuar për situatën e personave me aftësi të kufizuara në nivel bashkie dhe në nivel rajonal. Aktualisht mungon një bazë e integruar të dhënash që të mundësojë analizimin e profileve të nevojave të kësaj kategorie dhe parashikimin e kërkesës për shërbime në periudhën afatmesme.

Në të njëjtën kohë evidentohet mungesa e informacionit të plotë për fëmijët me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin e detyrueshëm, pasi sektori social në bashki nuk disponon të dhëna të detajuara mbi numrin dhe profilin e tyre në sistemin arsimor. Mungesa e një shkëmbimi të strukturuar të informacionit ndërmjet sektorit social dhe institucioneve arsimore e vështirëson identifikimin e nevojave të fëmijëve dhe planifikimin e shërbimeve mbështetëse.

Po ashtu, mungon një analizë e detajuar mbi profilin e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë dallimin ndërmjet personave me aftësi të kufizuara fizike dhe atyre me probleme të shëndetit mendor. Kjo e bën të vështirë parashikimin e kërkesës për shërbime të asistencës në familje në vitet e ardhshme, veçanërisht për personat që nuk kanë mbështetje familjare për të kryer rolin e ndihmësit personal.

Këto sfida tregojnë se sistemi aktual i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara në qark kërkon forcim të kapaciteteve institucionale, zhvillim të shërbimeve të specializuara dhe përmirësim të mekanizmave të mbledhjes dhe analizës së të dhënave për të mbështetur planifikimin social në nivel rajonal.

3.5 Sfidat në koordinimin institucional dhe bashkëpunimin ndërsektorial

Një sfidë tjetër lidhet me mungesën e bashkëpunimit dhe koordinimit të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve publike dhe ofruesve të shërbimeve shoqërore publike dhe jo publike për personat me aftësi të kufizuara. Aktualisht, bashkëpunimi ndërmjet sektorit social në bashki, institucioneve të tjera publike dhe organizatave që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara mbetet i kufizuar dhe shpesh zhvillohet në mënyrë të fragmentuar.

Mungesa e mekanizmave të strukturuar të koordinimit në nivel lokal dhe rajonal e vështirëson shkëmbimin e informacionit, referimin e rasteve dhe planifikimin e ndërhyrjeve të përbashkëta në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara. Si rezultat, shërbimet ekzistuese shpesh funksionojnë të izoluara nga njëra-tjetra dhe nuk krijojnë një sistem të integruar mbështetjeje për këtë kategori.

Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe zhvillimi i mekanizmave funksionalë të koordinimit ndërmjet institucioneve dhe ofruesve të shërbimeve përbën një element të

rëndësishëm për përmirësimin e aksesit dhe të cilësisë së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në nivel qarku.

3.6 Sfidat në informacionin dhe mbështetjen për familjet

Një tjetër sfidë lidhet me mungesën e informacionit të plotë dhe të aksesueshëm për shërbimet shoqërore që ofrohen për personat me aftësi të kufizuara. Familjet dhe prindërit e personave me aftësi të kufizuara shpesh nuk disponojnë informacion të mjaftueshëm mbi shërbimet ekzistuese, procedurat për përfitimin e tyre dhe institucionet që ofrojnë mbështetje.

Kjo situatë kufizon përdorimin efektiv të shërbimeve ekzistuese dhe krijon vështirësi për familjet në identifikimin e formave të mbështetjes që mund të përfitojnë. Në të njëjtën kohë evidentohet mungesa e programeve të strukturuar për mbështetjen e prindërve dhe familjarëve të personave me aftësi të kufizuara, të cilët shpesh mbajnë barrën kryesore të kujdesit dhe përballen me sfida të shumta sociale, ekonomike dhe psikologjike.

Forcimi i mekanizmave të informimit dhe zhvillimi i programeve të mbështetjes për familjet përbën një element të rëndësishëm për përmirësimin e aksesit në shërbime dhe për rritjen e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre.

4. Implikimet për planifikimin e shërbimeve sociale

Analiza e situatës së personave me aftësi të kufizuara në Qarkun Elbasan tregon nevojën për zhvillimin e një sistemi më të koordinuar dhe të integruar të shërbimeve sociale për këtë kategori. Përqendrimi i një pjese të konsiderueshme të personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Elbasan, së bashku me shpërndarjen territoriale të rasteve në bashkitë e tjera të qarkut, nënvizon rëndësinë e organizimit të shërbimeve në një model rajonal të koordinuar, ku shërbimet e specializuara mund të zhvillohen në nivel ndërbashkiak ose rajonal, ndërsa shërbimet komunitare bazë të forcohen në nivel vendor.

Në këtë kuadër, Bashkia Elbasan paraqet potencialin për të funksionuar si një qendër rajonale për zhvillimin e shërbimeve të specializuara për personat me aftësi të kufizuara, për shkak të përqendrimit më të madh të rasteve dhe të pranisë së disa shërbimeve ekzistuese. Paralelisht, bashkitë e tjera të qarkut duhet të zhvillojnë dhe të forcojnë shërbimet komunitare bazë, duke garantuar akses më të afërt për familjet dhe duke krijuar mekanizma funksionalë referimi drejt shërbimeve të specializuara rajonale.

Nga analiza e sfidave dhe e kapacitetit aktual të shërbimeve rezulton se planifikimi social rajonal duhet të fokusohet në disa drejtime kryesore ndërhyrjeje: zgjerimin e shërbimeve terapeutike dhe rehabilituese, zhvillimin e shërbimeve për të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara pas përfundimit të arsimit, përmirësimin e aksesit territorial në shërbime, si

dhe forcimin e mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional dhe të sistemeve të mbledhjes së të dhënave.

Në të njëjtën kohë, një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të shërbimeve të asistencës në familje dhe të programeve mbështetëse për prindërit dhe familjarët e personave me aftësi të kufizuara, të cilët shpesh mbajnë barrën kryesore të kujdesit. Forcimi i mekanizmave të informimit për shërbimet ekzistuese dhe zhvillimi i programeve të mbështetjes për familjet përbën një element të rëndësishëm për rritjen e aksesit në shërbime dhe për përmirësimin e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara në nivel qarku.

Përmbledhja e sfidave kryesore dhe e drejtimeve të ndërhyrjes për Planin Social Rajonal paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 9.4: Ndërhyrjet rajonale për zhvillimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara

Sfida kryesore	Ndërhyrja në nivel rajonal	Aktorët rajonalë	Rezultati i pritshëm
Kapacitetet e kufizuara të shërbimeve terapeutike dhe rehabilituese	Zhvillimi dhe zgjerimi i shërbimeve të specializuara ndërbashkiake për personat me aftësi të kufizuara (terapi zhvillimore, rehabilitim, mbështetje psikosociale)	Këshilli i Qarkut, bashkitë e qarkut, institucionet qendrore, organizatat e shoqërisë civile	Rritja e kapacitetit të shërbimeve të specializuara dhe përmirësimi i aksesit në ndërhyrje terapeutike dhe rehabilituese
Shpërndarja e pabarabartë territoriale e shërbimeve	Krijimi i një rrjeti rajonal të shërbimeve për PAK dhe forcimi i mekanizmave të referimit ndërmjet bashkive	Këshilli i Qarkut, bashkitë, ofruesit publikë dhe jo publikë të shërbimeve	Përmirësim i aksesit territorial dhe reduktim i pabarazive në mbulimin e shërbimeve
Mungesa e vijimësisë së shërbimeve pas moshës 21 vjeç	Zhvillimi i shërbimeve rajonale për të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara dhe programeve të tranzicionit drejt jetës së pavarur	Këshilli i Qarkut, bashkitë, institucionet e arsimit dhe punësimin, organizatat e shoqërisë civile	Zgjerimi i shërbimeve për të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara dhe përmirësimi i përfshirjes sociale

Mungesa e të dhënave të detajuara për situatën e PAK	Krijimi i një sistemi rajonal për mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi personat me aftësi të kufizuara dhe nevojat e tyre	Këshilli i Qarkut, bashkitë, institucionet publike përkatëse	Përmirësim i planifikimit të shërbimeve dhe vendimmarrjes në bazë të evidencës
Mungesa e bashkëpunimit ndërinstytucional	Zhvillimi i mekanizmave të koordinimit ndërmjet bashkive, institucioneve publike dhe ofruesve të shërbimeve për PAK	Këshilli i Qarkut, bashkitë, institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile	Forcimi i koordinimit institucional dhe funksionim më i integruar i sistemit të shërbimeve
Mungesa e informacionit për shërbimet dhe mbështetjen për familjet	Krijimi i një mekanizmi rajonal informimi dhe orientimi për familjet e personave me aftësi të kufizuara	Këshilli i Qarkut, bashkitë, organizatat e shoqërisë civile	Rritje e aksesit në informacion dhe përdorim më efektiv i shërbimeve ekzistuese

Në tërësi, analiza e situatës së personave me aftësi të kufizuara në Qarkun Elbasan evidenton nevojën për zhvillimin e një sistemi më të integruar dhe të koordinuar rajonal të shërbimeve sociale, i cili të mundësojë zgjerimin e shërbimeve të specializuara, përmirësimin e aksesit territorial dhe forcimin e mbështetjes për familjet e personave me aftësi të kufizuara.

Aneksi 10: Analiza e detajuar e situatës për fëmijët në nevojë për mbrojtje, Qarku Elbasan

1. Përshkrimi i grupit dhe rëndësia sociale

Fëmijët në nevojë për mbrojtje përbëjnë një nga kategoritë më të ndjeshme të sistemit të mbrojtjes sociale, për shkak të ekspozimit ndaj faktorëve të rrezikut që lidhen me varfërinë, dhunën, neglizhencën, përjashtimin social dhe mungesën e mbështetjes familjare. Mbrojtja e fëmijës kërkon ndërhyrje të integruara që përfshijnë identifikimin, menaxhimin e rastit, ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen e familjes.

Në Qarkun Elbasan, fëmijët përbëjnë rreth 15% të popullsisë totale sipas Censit 2023, çka e bën këtë grup një komponent të rëndësishëm të planifikimit social në nivel rajonal.

2. Të dhënat ekzistuese dhe shpërndarja territoriale

Analiza e të dhënave evidencon një hendek të konsiderueshëm ndërmjet numrit të fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe atyre që përfitojnë shërbime, ku vetëm rreth 38.9% mbulohen në nivel qarku

Analiza krahasimore në nivel bashkiak

Shpërndarja e fëmijëve në nevojë dhe mbulimi me shërbime paraqet diferenca të theksuara ndërmjet bashkive, duke reflektuar kapacitete të ndryshme institucionale dhe nivele të ndryshme zhvillimi të shërbimeve sociale.

Në bashkitë me kapacitete më të zhvilluara, si **Elbasani**, niveli i mbulimit arrin në rreth 81.5%, duke treguar një sistem më funksional dhe akses më të mirë në shërbime. Në të kundërt, bashki si **Librazhdi (7.3%)**, **Belshi (21.7%)** dhe **Prrenjasi (26.3%)** paraqesin nivele shumë të ulëta të mbulimit, duke evidencuar boshllëqe serioze në ofrimin e shërbimeve dhe në kapacitetet e sistemit vendor.

Në disa raste, si në **Gramsh dhe Peqin**, mbulimi rezulton formalisht i plotë (100%), por kjo lidhet më shumë me numrin e kufizuar të rasteve të identifikuara sesa me një sistem të zhvilluar shërbimesh, duke ngritur nevojën për verifikim të cilësisë dhe diversitetit të ndërhyrjeve.

Në këtë kontekst, analiza në nivel bashkiak tregon se sistemi i mbrojtjes së fëmijës në Qarkun Elbasan karakterizohet nga **pabarazi të theksuara territoriale**, ku disa bashki përballen me presion të lartë të rasteve dhe kapacitete të kufizuara, ndërsa të tjera kanë mbulim relativisht më të mirë.

Tabelat 10.1: Fëmijët në nevojë për mbrojtje (Qarku Elbasan)

Bashkia	Popullsia	Fëmijë 0–14	Fëmijë në nevojë	Përfitues	% mbulimi	Interpretim
Belsh	17.123	2.299	23	5	21.7%	Mbulim shumë i ulët
Cërrik	25.163	3.546	153	60	39.2%	Mbulim i pjesshëm
Elbasan	115.101	17.787	81	66	81.5%	Mbulim i lartë
Gramsh	16.533	2.492	34	34	100.0%	Mbulim i plotë
Librazhd	23.312	3.789	165	12	7.3%	Hendek kritik
Peqin	16.580	2.417	47	47	100.0%	Mbulim i plotë
Prrenjas	18.768	3.233	228	60	26.3%	Mbulim i ulët
Totali	232.580	35.563	731	284	38.9%	Hendek i konsiderueshëm

Të dhënat konfirmojnë një shpërndarje të pabarabartë të fëmijëve në nevojë dhe një mospërputhje të theksuar ndërmjet rasteve të identifikuar dhe atyre që përfitojnë shërbime, veçanërisht në disa bashki.

Analiza e kategorive të fëmijëve në nevojë

Struktura e fëmijëve në nevojë në nivel qarku tregon një dominim të kategorisë së **fëmijëve me aftësi të kufizuara (487 raste)**, të cilët njëkohësisht paraqesin edhe nivelin më të ulët të mbulimit me shërbime (21%). Kjo evidenton një kapacitet i kufizuar për të adresuar nevojat, të theksuar në mbështetjen për një nga kategoritë më vulnerabël.

Në të njëjtën kohë, kategori të tjera si **viktimat e dhunës (44.4%)** dhe **fëmijët në konflikt me ligjin (57.9%)** paraqesin mbulim të pjesshëm, ndërsa kategori si **jetimët (80%)**, **kujdesi alternativ (93.3%)** dhe **rastet e dhunës seksuale (100%)** tregojnë një përgjigje më të mirë të sistemit, kryesisht në rastet më të rënda dhe emergjente.

Kjo strukturë tregon një model të qartë të funksionimit të sistemit, ku ndërhyrjet janë **kryesisht të orientuara ndaj reagimit dhe drejt rasteve kritike**, ndërsa mbështetja për kategori më të gjera dhe për ndërhyrje afatgjata mbetet e kufizuar.

Tabela 10.2: Fëmijët sipas kategorive

Kategoria	Të identifikuar	Përfitues	% mbulimi	Interpretim
PAK	487	102	21.0%	Hendek i lartë
Viktima dhune	72	32	44.4%	Mbulim i pjesshëm
Konflikt me ligjin	19	11	57.9%	Mesatar
Jetimë	45	36	80%	Mbulim i mirë
Kujdes alternative	15	14	93.3%	Shumë i mirë
Braktisje shkolle	7	5	71.4%	I mirë
Mosfrekuentim	31	26	83.9%	I mirë
Fëmijë në rrugë	8	5	62.5%	Mesatar
Dhunë seksuale	8	8	100%	I plotë
Totali	731	284	38.9%	Hendek strukturor

Të dhënat konfirmojnë një mbulim të pamjaftueshëm të nevojave në mbështetjen për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe një orientim të sistemit, të bazuara në reagim, duke evidentuar nevojën për zhvillimin e shërbimeve parandaluese dhe afatgjata.

Analiza e shërbimeve sociale për fëmijët (nivel bashkiak dhe rajonal)

Analiza e shërbimeve sociale për fëmijët tregon një sistem të fragmentuar dhe të pabarabartë në nivel qarku. Në total, në Qarkun Elbasan operojnë 13 shërbime për fëmijët, nga të cilat vetëm 2 janë publike dhe 11 ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile, duke treguar një varësi të konsiderueshme nga aktorët jo publikë.

Shërbimet janë të përqendruara kryesisht në Bashkinë Elbasan (4 shërbime) dhe pjesërisht në Cërrik (3 shërbime); bashki si Belsh dhe Gramsh nuk disponojnë asnjë shërbim të dedikuar për fëmijët, ndërsa në Librazhd dhe Prrenjas shërbimet janë të kufizuara dhe të përqendruara në kategori të veçanta.

Kjo shpërndarje tregon një sistem me **përqëndrim urban të shërbimeve**, ku zonat me më pak burime institucionale dhe financiare mbeten të pambuluara. Numri i përfituesve të shërbimeve (579) mbetet i ulët në raport me numrin e fëmijëve në nevojë (731), duke konfirmuar hendekun ndërmjet ofertës dhe kërkesës.

Tabela 10.3: Shpërndarja territoriale e shërbimeve sociale për fëmijët dhe numri i përfituesve (Qarku Elbasan)

Lloji i Shërbimeve shoqërore që operojnë në Qarkun Elbasan	Shërbime sociale për fëmijët në nivel Bashkia, Belsh	Shërbime sociale për fëmijët në nivel Bashkia, Cërrik	Shërbime sociale për fëmijët në nivel Bashkia Elbasan	Shërbime sociale për fëmijët në nivel Bashkia, Gramsh	Shërbime sociale për fëmijët në nivel Bashkia Librazhd	Shërbime sociale për fëmijët në nivel Bashkia Peqin	Shërbime sociale për fëmijët në nivel Bashkia Prrenjas	Shërbime sociale për fëmijët në nivel Qarku	Totali
Numër shërbimesh	0	3	4	0	0	1	0	5	13
Shërbime publike		1				1			2
Shërbime jo publike		2	4					5	11
Numër përfituesish	0	115	290	0	0	40	0	134	579

Prania e bashkive pa asnjë shërbim të dedikuar për fëmijët, si Belsh dhe Gramsh, së bashku me mbulimin e kufizuar dhe të fokusuar në kategori të veçanta në bashki si Librazhd dhe Prrenjas, evidenton pabarazi të theksuara territoriale në ofrimin e shërbimeve.

Në tërësi, të dhënat konfirmojnë një hendek të theksuar në mbulimin e nevojave për shërbime për fëmijët, veçanërisht në bashkitë pa asnjë shërbim të dedikuar, duke evidentuar nevojën për zhvillimin e shërbimeve në mënyrë më të balancuar territorialisht dhe forcimin e rolit të sektorit publik në ofrimin e tyre.

Shpërndarja territoriale dhe aksesueshmëria e shërbimeve

Nga pikëpamja territoriale, nevojat për mbrojtjen e fëmijëve janë të shpërndara në të gjithë qarkun, por aksesueshmëria ndaj shërbimeve mbetet e pabarabartë. Në zonat rurale, kufizimet gjeografike, mungesa e shërbimeve të dedikuara dhe kapacitetet e kufizuara institucionale reduktojnë ndjeshëm aksesin në shërbime, ndërsa në qendrat urbane vihet re një përqëndrim më i madh si i rasteve, ashtu edhe i ofertës së shërbimeve. Kjo krijon pabarazi territoriale në mbulimin e nevojave dhe rrezikon lënien jashtë shërbimeve të fëmijëve në zonat më të izoluar.

Analiza e sfidave në zonat rurale dhe për fëmijët në familje me Ndihmë Ekonomike

Në zonat rurale, sfidat për mbrojtjen e fëmijëve janë më të theksuara për shkak të mungesës së shërbimeve në nivel lokal, distancës nga qendrat urbane, kapaciteteve të kufizuara të njësive vendore dhe aksesit të vështirë në shërbime të specializuara. Këta faktorë ndikojnë drejtpërdrejt në identifikimin dhe trajtimin e rasteve, duke rritur rrezikun për mosadresimin e situatave të fëmijëve në nevojë. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre fëmijëve jetojnë në familje që përfitojnë nga Ndihma Ekonomike, duke konfirmuar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet varfërisë dhe rrezikut për përjashtim social. Megjithatë, mbështetja financiare nuk shoqërohet në mënyrë sistematike me shërbime sociale, duke lënë një pjesë të fëmijëve pa mbështetje të plotë dhe duke kontribuar në vazhdimësinë e ciklit të vulnerabilitetit.

3. Sfidat dhe problematikat kryesore

Analiza evidencon kufizime strukturore dhe funksionale që ndikojnë drejtpërdrejt në efektivitetin e sistemit të mbrojtjes së fëmijës në nivel qarku.

Në thelb, sistemi operon me **kapacitete të pamjaftueshme për të përballuar nivelin e nevojave**, çka reflektohet në mbulim të pjesshëm të shërbimeve dhe në përqëndrim të tyre në disa bashki, ndërkohë që territore të tëra mbeten pa shërbime të dedikuara. Kjo krijon një akses të pabarabartë dhe kufizon ndërhyrjen e hershme në zonat me nevojë më të lartë.

Modeli i ndërhyrjes mbetet kryesisht **i orientuar drejt menaxhimit të rasteve në situata të avancuara rreziku**, ndërsa ndërhyrjet parandaluese dhe mbështetja e hershme nuk janë të zhvilluara në mënyrë sistematike, duke reduktuar efektivitetin afatgjatë të sistemit.

Në nivel institucional, bashkëpunimi ndërmjet aktorëve përbën një bazë të mirë, e cila kërkon të konsolidohet më tej përmes forcimit të koordinimit funksional dhe përmirësimit të mekanizmave të identifikimit dhe referimit, në funksion të një përgjigjeje më të shpejtë dhe të integruar për fëmijën dhe familjen.

Gjithashtu, sistemi mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në **ofruet jo publikë**, duke reflektuar një rol ende të kufizuar të sektorit publik në garantimin e mbulimit të qëndrueshëm dhe të standardizuar në të gjithë territorin.

Në zonat rurale, këto problematika intensifikohen për shkak të **mungesës së shërbimeve në nivel lokal, aksesit të kufizuar dhe kapaciteteve të dobëta vendore**, duke rritur rrezikun për mosidentifikim dhe mosadresim të rasteve.

Së fundi, mungesa e integritit të ndërhyrjeve për fëmijët me mbështetjen për familjen, veçanërisht në kontekstin e varfërisë, kufizon efektivitetin e përgjigjes së sistemit dhe kontribuon në riprodhimin e vazhdueshëm të situatave të vulnerabilitetit.

4. Implikimet për planifikimin e shërbimeve sociale

Gjetjet e diagnozës kërkojnë një rikonfigurim të mënyrës së planifikimit të shërbimeve sociale, duke diferencuar qartë rolet ndërmjet nivelit vendor dhe atij rajonal.

Në nivel bashkie:

- Bashkitë fokusohen në zgjerimin e mbulimit të shërbimeve, veçanërisht në zonat e pambuluara dhe rurale, si dhe në forcimin e rolit të tyre në ofrimin e shërbimeve publike.
- Paralelisht, zhvillohen ndërhyrje parandaluese përmes shërbimeve komunitare dhe fushatave ndërgjegjësuese, si dhe përmirësohen mekanizmat e identifikimit dhe referimit të rasteve.
- Një drejtim prioritar përbën zhvillimi i kujdestarisë alternative, si instrument kyç për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror.

Në nivel qarku:

- Qarku siguron koordinimin ndërbashkiak dhe kontribuon në reduktimin e pabarazive territoriale, duke orientuar zhvillimin e shërbimeve në nivel rajonal.
- Qarku udhëheq planifikimin e shërbimeve të specializuara, ofron mbështetje teknike për bashkitë dhe promovon standardizimin e praktikave, si dhe zhvillon sisteme të përbashkëta të monitorimit dhe të dhënave.
- Qarku organizon dhe koordinon fushata ndërgjegjësuese në nivel rajonal për informimin e prindërve mbi shërbimet sociale të disponueshme dhe mbi shërbimin e kujdestarisë alternative, duke rritur ndërgjegjësimin dhe aksesin në këto shërbime.

Kjo analizë e vërtetë se, këto implikime synojnë zhvillimin e një sistemi më të balancuar territorial, të orientuar drejt parandalimit dhe të mbështetur në një rol më aktiv të sektorit publik dhe në koordinim efektiv ndërinstitucional.

Në përfundim, tregon një sistem të mbrojtjes së fëmijëve në Qarkun Elbasan të karakterizuar nga pabarazi territoriale, mbulim i kufizuar i shërbimeve dhe një orientim kryesisht reaktiv i ndërhyrjeve. Pavarësisht pranisë së disa shërbimeve dhe funksionimit më të mirë në disa bashki, sistemi nuk arrin të adresojë në mënyrë të plotë dhe të integruar nevojat e fëmijëve në nivel qarku. Kjo situatë kërkon një rikonfigurim të qasjes drejt forcimit të rolit të sektorit publik, zgjerimit të mbulimit territorial, zhvillimit të ndërhyrjeve parandaluese dhe ndërtimit të një sistemi të koordinuar që garanton mbështetje të vazhdueshme për fëmijën dhe familjen.

Aneksi 11: Analiza e detajuar e situatës së viktimave të dhunës dhe trafikimit Qarku Elbasan.

1. Përshkrimi i grupit dhe rëndësia sociale

Viktimat e dhunës dhe trafikimit përbëjnë një kategori me çënueshmëri të shumëfishtë, ku ndërthuren faktorë socialë, ekonomikë dhe strukturorë që rrisin ndjeshëm rrezikun e përjashtimit social dhe ekspozimit ndaj cikleve të përsëritura të abuzimit. Në këtë grup përfshihen kryesisht gra dhe vajza viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, fëmijë të ekspozuar ndaj dhunës, si dhe kategori më pak të dukshme si burrat, të moshuarit dhe persona me aftësi të kufizuara në situata abuzimi, përfshirë edhe viktimat e trafikimit.

Rëndësia e këtij grupi lidhet drejtpërdrejt me natyrën e ndërthurur të nevojave që ai paraqet. Dhuna dhe trafikimi prodhojnë pasoja afatgjata në sigurinë individuale, shëndetin fizik dhe mendor, funksionimin familjar dhe integrimin social dhe ekonomik. Në mungesë të ndërhyrjes në kohë dhe të integruar, këto pasoja thellohen dhe shndërrohen në kosto sociale të zgjeruara, përfshirë përshkallëzimin e dhunës, varfërinë, humbjen e strehimit dhe rikthimin në ciklin e abuzimit.

Në këtë kuptim, trajtimi i viktimave të dhunës dhe trafikimit nuk përbën vetëm një përgjegjësi sektoriale, por një test të drejtpërdrejtë të funksionimit të sistemit të mbrojtjes sociale në tërësi, pasi kërkon koordinim efektiv ndërmjet shërbimeve sociale, sistemit të drejtësisë, shëndetësisë dhe mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve.

2. Të dhënat ekzistuese dhe shpërndarja territoriale e viktimave të dhunës

Të dhënat administrative për vitin 2025 e vërtetojnë një nivel të konsiderueshëm të rasteve të identifikuara të dhunës në Qarkun Elbasan, me 283 raste të lidhura me urdhra mbrojtjeje. Struktura e viktimave tregon një dominim të grave (226 raste), të ndjekura nga fëmijët (42 raste), burrat (26 raste) dhe të moshuarit (20 raste), duke reflektuar një profil të qartë gjinor

të fenomenit, por njëkohësisht edhe një shtrirje më të gjerë të tij në grupe të tjera të popullsisë.

Ndërkohë, të dhënat administrative për viktimat e trafikimit nuk paraqiten në mënyrë të detajuar në këtë seksion, duke reflektuar natyrën më të specializuar të identifikimit dhe trajtimit të këtyre rasteve në raport me dhunën në familje, e cila është më e përhapur dhe më e strukturuar në sistemin vendor. Për të kuptuar dinamikën e fenomenit dhe përdorimin e shërbimeve të strehimit, paraqitet ecuria e rasteve për periudhën 2023–2025.

Tabela 11.1: Ecuria e rasteve të dhunës dhe aksesit në shërbimet e strehimit në strehëz sipas kategorive, Qarku Elbasan, 2023–2025

Të dhëna	Korrik 2023		Korrik 2024		Korrik 2025	
	Numër viktimash	Sa prej tyre kërkuan strehim në strehëz	Numër viktimash	Sa prej tyre kërkuan strehim në strehëz	Numër viktimash	Sa prej tyre kërkuan strehim në strehëz
Urdhër Mbrojtje	184		223		283	
Viktima të dhunës sipas gjinisë dhe moshës						
<i>Gra</i>	132	33	164	40	226	31
<i>Fëmijë</i>	55	34	67	45	42	18
<i>Të moshuar</i>	12	0	22	0	20	0
<i>Burra</i>	12	0	16	0	26	0
<i>Të tjerë</i>						
Karakteristika të viktimave të dhunës mbi 18 vjeç						
<i>Të papunë</i>	53	0	82	0	95	0
<i>Përfitues të NE-së</i>	84	0	77	0	129	0
<i>Të Pastrehë</i>	23	0	25	0	32	0
<i>Të tjerë</i>						

Të dhënat tregojnë një rritje të rasteve të identifikuara, ndërkohë që kërkesa për strehim mbetet e kufizuar dhe e përqendruar në kategori specifike.

Nga pikëpamja e aksesit në shërbime mbrojtëse, evidentohet një mospërputhje e dukshme ndërmjet numrit të rasteve të identifikuara dhe përdorimit të shërbimeve të strehimit, ku vetëm 31 gra dhe 18 fëmijë kanë kërkuar strehim, ndërsa për kategoritë e tjera nuk evidentohet kërkesë. Ky raport i ulët nuk reflekton mungesë nevojë, por sugjeron kufizime në akses, të lidhura me barriera sociale, mungesë informacioni, stigma dhe mungesë shërbimesh të përshtatura për profile të ndryshme viktimash.

Profili socio-ekonomik i viktimave mbi 18 vjeç tregon një mbivendosje të fortë ndërmjet dhunës dhe varfërisë, ku një pjesë e konsiderueshme janë të papunë (95 raste), përfitues të ndihmës ekonomike (129 raste) dhe persona të pastrehë (32 raste). Ky konfigurim e pozicionon dhunën si një fenomen të lidhur ngushtë me pasigurinë ekonomike dhe sociale.

Leximi në trend i të dhënave 2023–2025 tregon rritje të rasteve të identifikuara, veçanërisht për gratë, duke sugjeruar një kombinim të rritjes reale të fenomenit dhe përmirësimit të mekanizmave të identifikimit. Paralelisht, rritja e rasteve të burrave dhe të moshuarve, edhe pse në nivele më të ulëta, sinjalizon një zgjerim të profilit të viktimave përtej kategorive tradicionale. Nga ana tjetër, ulja e kërkesës për strehim në disa kategori, veçanërisht te fëmijët, kërkon interpretim të kujdesshëm, pasi mund të lidhet me nënraportim ose kufizime në akses.

Analiza territoriale e rasteve të dhunës sipas bashkive dhe përfitimit nga pagesa për shkak të urdhrit të mbrojtjes

Analiza e shpërndarjes së rasteve të dhunës në nivel bashkie për vitin 2025 evidenton një përqëndrim të theksuar të fenomenit në Bashkinë Elbasan, e cila përfaqëson rreth 61.5% të totalit të rasteve në nivel qarku (174 nga 283 raste). Ky dominim lidhet me peshën demografike të bashkisë, por njëkohësisht sinjalizon edhe një përqëndrim më të madh të mekanizmave të identifikimit dhe raportimit në këtë territor.

Në bashkitë e tjera, numri i rasteve paraqitet dukshëm më i ulët, Librazhdi (29 raste) dhe Cërriku (25 raste) që ndjekin në distancë, ndërsa bashkitë si Gramsh (21 raste), Peqin (14 raste), Prrenjës (11 raste) dhe Belshi (9 raste) paraqesin nivele më të ulëta të rasteve të identifikuara. Kjo shpërndarje nuk duhet interpretuar automatikisht si intensitet më i ulët i fenomenit, por edhe si reflektim i kapaciteteve të ndryshme për identifikim dhe raportim në nivel vendor. Shpërndarja e rasteve sipas bashkive paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 11.2: Shpërndarja e rasteve të dhunës dhe e kërkesës për strehim në strehëz sipas bashkive, Qarku Elbasan, Korrik 2025

Bashkitë	Numri viktimave të dhunës me Urdhër Mbrojtje	Viktima që kërkuan strehim në strehëz
Belsh	9	9
Cërrik	25	0
Elbasan	174	31
Gramsh	21	0
Librazhd	29	2
Peqin	14	0
Prrenjës	11	1
Total	283	43

Nga pikëpamja e aksesit në shërbimet në strehëz, analiza tregon një model edhe më të pabarabartë. Nga 43 raste që kanë kërkuar strehim në nivel qarku, shumica janë të përqendruara në Bashkinë Elbasan (31 raste), ndërsa bashkitë e tjera paraqesin nivele minimale ose zero kërkesë për këtë shërbim. Veçanërisht, bashki si Cërrik, Gramsh dhe Peqin nuk raportojnë asnjë rast të kërkesës për strehëz, pavarësisht pranisë së rasteve të dhunës.

Një rast i veçantë është Bashkia Belsh, ku të gjitha rastet e identifikuara (9 raste) kanë kërkuar shërbim në strehëz, duke sugjeruar ose një akses të drejtpërdrejtë në shërbime për këto raste, ose një profil specifik të rasteve të identifikuara. Në të kundërt, në bashki të tjera evidentohet një hendek i qartë ndërmjet numrit të rasteve dhe përdorimit të shërbimeve të strehëzës, duke reflektuar barriera në akses, mungesë shërbimesh lokale ose dobësi në mekanizmat e referimit.

Në tërësi, analiza territoriale tregon një sistem me shpërndarje të pabarabartë si në identifikimin e rasteve, ashtu edhe në aksesin në shërbime, ku Bashkia Elbasan funksionon si qendër kryesore e ofrimit të shërbimeve, ndërsa bashkitë e tjera mbeten kryesisht përdoruese të kufizuara të këtij sistemi.

Analiza e shërbimeve shoqërore për viktimat e dhunës dhe trafikimit

Analiza e shërbimeve shoqërore për viktimat e dhunës dhe trafikimit në Qarkun Elbasan evidencon ekzistencën e një baze të konsoliduar shërbimesh të specializuara, të ofruara nga një numër i kufizuar organizatash, por njëkohësisht nxjerr në pah kufizime strukturore në mbulimin, shpërndarjen territoriale dhe gjithëpërfshirjen e sistemit.

Në total, në vitin 2025 janë mbështetur 168 përfitues, nga të cilët 163 janë femra dhe vetëm 5 meshkuj. Struktura e përfituesve tregon një dominim të qartë të rasteve të dhunës në familje, ndërkohë që viktimat e trafikimit përfaqësojnë një pjesë më të kufizuar, të përqendruar kryesisht në një ofrues të specializuar. Kjo shpërndarje reflekton jo vetëm prevalencën më të lartë të dhunës, por edhe natyrën më të specializuar dhe më pak të identifikueshme të rasteve të trafikimit.

Ndryshe nga viktimat e dhunës, të cilat përfitojnë nga një gamë më e gjerë shërbimesh dhe ofruesish, viktimat e trafikimit trajtohen kryesisht përmes ndërhyrjeve të specializuara, të përqendruara dhe me kohëzgjatje më të gjatë, duke kërkuar mbështetje të integruar për rehabilitim dhe riintegrim të qëndrueshëm. Ky konfigurim reflekton natyrën më komplekse të rasteve të trafikimit dhe nevojën për trajtim të specializuar. Në këtë kuadër, ekzistenca e shërbimeve të dedikuara për viktimat e trafikimit në nivel kombëtar, në territorin e Qarkut Elbasan, përbën një element të rëndësishëm të sistemit, pasi siguron kapacitete të specializuara dhe ndërhyrje të përshtatura për këtë kategori me nevoja më komplekse.

Analiza e ofrimit të shërbimeve shoqërore për viktimat e dhunës dhe trafikimit, sipas ofruesve, tregon një përqendrim të madh të shërbimeve te një numër i kufizuar aktorësh. World Vision Albania mbulon pjesën më të madhe të përfituesve (118 raste), e ndjekur nga Forumi i Gruas Elbasan (31 raste) dhe Tjetër Vizion (19 raste). Ky konfigurim tregon një varësi të lartë të sistemit nga disa ofrues kryesorë, çka rrit eficiencën në koordinim, por njëkohësisht krijon rrezik për qëndrueshmërinë e shërbimeve në rast të reduktimit të kapaciteteve ose financimeve.

Struktura e ofrimit të shërbimeve sipas ofruesve paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 11.3: Ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës dhe trafikimit sipas ofruesve, profilit të përfituesve dhe burimit të financimit, Qarku Elbasan, Korrik 2025

Ofrues shërbimi	Kategori në nevojë	Grupmosha	Numër përfitues	Femra	Meshkuj	Burimi financimit	Niveli i shërbimit
Tjetër Vizion	Viktima të trafikimit	5-18 vjeç	19	14	5	Mix	Kombëtar
Forum i Gruas Elbasan	Viktima të dhunës	18 vjeç+	31	31		Mix	Rajonal
World Vision Albania (Zyra Këshillimore Rise Her Elbasan)	Viktima të dhunës	18-65 vjeç	118	118		Donator	Rajonal
Totali			168	163	5		

Nga pikëpamja e profilit të shërbimeve, evidentohet një mbulim relativisht i mirë i shërbimeve bazë, ku të tre ofruesit sigurojnë shërbime parashoqërore, psikologjike dhe asistencë ligjore falas. Megjithatë, analiza e tipologjisë së shërbimeve tregon boshllëqe të rëndësishme në dimensionin e shërbimeve të specializuara. Vetëm dy organizata ofrojnë shërbime rezidenciale/strehëza, ndërsa shërbimet ditore dhe ato mjekësore janë të kufizuara dhe jo të pranishme në mënyrë të unifikuar në të gjithë sistemin. Ky konfigurim tregon një ofertë të fragmentuar të shërbimeve, ku mungon një paketë e plotë multidisiplinare për të gjitha kategoritë e viktimave.

Tipologjia e shërbimeve të ofruara nga organizatat paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 11.4: Tipologjia e shërbimeve të ofruara për viktimat e dhunës dhe trafikimit sipas ofruesve, Qarku Elbasan, Korrik 2025

Ofrues shërbimi	Shërbime parashoqërore	Shërbim psikologjik	Qendër rezidenciale/ Strehëz	Shërbim ligjor falas	Shërbim ditor	Shërbime mjekësore
Tjetër Vizion	1	1	1	1		
Forumi i Gruas Elbasan	1	1	1	1	1	
World Vision Albania	1	1		1		1
Total	3	3	2	3	1	1

Në aspektin e profilit të përfituesve, shërbimet mbulojnë kryesisht dy grupe: fëmijët (5–18 vjeç) dhe gratë në moshë aktive (18–65 vjeç), ndërsa viktimat mbi 65 vjeç dhe kategori të tjera mbeten jashtë fokusit të drejtpërdrejtë të shërbimeve. Po kështu, mungesa e përfituesve meshkuj në shumicën e shërbimeve tregon një model oferte që nuk reflekton plotësisht diversitetin e nevojave reale.

Nga pikëpamja e financimit, sistemi karakterizohet nga një kombinim i burimeve “mix” dhe financimeve nga donatorët, me një rol të theksuar të financimeve të jashtme në mbështetjen e shërbimeve. Kjo strukturë financimi siguron fleksibilitet dhe kapacitet ndërhyrjeje, por njëkohësisht krijon pasiguri për qëndrueshmërinë afatmesme dhe afatgjatë të shërbimeve, veçanërisht për ato më intensive si strehimi rezidencial.

Në aspektin territorial, përqendrimi i shërbimeve në Bashkinë Elbasan përforcon pabarazitë në akses për viktimat nga bashkitë e tjera dhe zonat rurale. Ky model qendror i ofrimit të shërbimeve krijon një sistem me mbulim të pjesshëm, ku aksesit varet nga afërsia gjeografike dhe funksionimi i mekanizmave të referimit, duke kufizuar efektivitetin e ndërhyrjes në nivel qarku.

Në tërësi, analiza tregon një sistem funksional dhe të specializuar në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës dhe trafikimit, por të karakterizuar nga përqendrim institucional dhe territorial, mbulim i pjesshëm i profileve të viktimave dhe varësi nga financime jo të qëndrueshme. Këto elemente e vendosin theksin në nevojën për konsolidimin dhe zgjerimin e sistemit drejt një modeli më gjithëpërfshirës, të integruar dhe të qëndrueshëm në nivel qarku.

Ky konfigurim nënvizon nevojën për një ristrukturim të sistemit drejt një modeli më balancuar territorialisht dhe funksionalisht, i cili redukton varësinë nga aktorë të veçantë dhe garanton mbulim të qëndrueshëm për të gjitha kategoritë e viktimave.

3. Sfidat dhe problematikat kryesore

Analiza eidenton një hendek strukturor ndërmjet identifikimit të rasteve dhe aksesit real në shërbime të specializuara. Ndërsa sistemi arrin të eidentojë një numër të konsiderueshëm rastesh, ai nuk garanton në mënyrë të qëndrueshme një trajektore të plotë mbështetjeje nga identifikimi te riintegrimi.

Një sfidë e dytë lidhet me pabarazinë territoriale të aksesit në shërbime, për shkak të përqendrimit të tyre në qytetin e Elbasanit. Kjo situatë krijon një sistem me mbulim të pjesshëm, ku viktimat në zonat rurale dhe bashkitë më të largëta hasin vështirësi në arritjen dhe përfitimin e shërbimeve.

Një tjetër problematikë strukturore lidhet me profilin e kufizuar të shërbimeve, të cilat janë të orientuara kryesisht drejt grave dhe fëmijëve. Mungesa e shërbimeve të përshtatura për burra, të moshuar dhe raste komplekse krijon boshllëqe në mbulimin e nevojave reale dhe sugjeron një model shërbimi jo plotësisht gjithëpërfshirës.

Ndërkohë, ndërthurja e dhunës me varfërinë dhe pasigurinë sociale kufizon efektivitetin e ndërhyrjeve që fokusohen vetëm në mbrojtje emergjente. Në mungesë të integritimit me shërbime të tjera si strehimi social, punësimi dhe mbështetja ekonomike, rreziku i rikthimit në situata dhune mbetet i lartë.

Mekanizmat e koordinimit ndërinstytucional, ndonëse funksionalë, nuk janë të konsoliduar në mënyrë të qëndrueshme, ndërsa identifikimi i rasteve shpesh ndodh me vonesë, duke reflektuar një sistem me karakter reaktiv. Në të njëjtën kohë, qëndrueshmëria e shërbimeve mbetet e brishtë për shkak të varësisë nga financimet me projekte, duke krijuar pasiguri për vazhdimësinë e tyre.

Në tërësi, këto sfida tregojnë një sistem që funksionon në mënyrë fragmentare dhe reaktive, duke mos garantuar ende një mbulim të plotë, të barabartë dhe të qëndrueshëm për të gjitha kategoritë e viktimave në nivel qarku

4. Implikimet për planifikimin e shërbimeve sociale

Gjetjet e analizës kërkojnë një riorientim të planifikimit drejt ndërtimit të një sistemi të integruar, funksional dhe të balancuar territorialisht në nivel qarku.

Në radhë të parë, zhvillimi i shërbimeve rezidenciale dhe afatmesme duhet të trajtohet si ndërhyrje prioritare, me fokus krijimin e një zinxhiri të plotë mbështetjeje që lidh identifikimin, strehimin dhe riintegrimin e viktimave në mënyrë të qëndrueshme.

Së dyti, reduktimi i pabarazive territoriale kërkon organizimin e shërbimeve në një model ndërbashkiak funksional, ku aksesit në shërbime nuk varet nga vendndodhja gjeografike,

por garantohet përmes mekanizmave të koordinuar dhe shërbimeve të lëvizshme në të gjithë territorin e qarkut.

Së treti, struktura e shërbimeve duhet të zgjerohet përtej profilit aktual, duke përfshirë modele të përshtatura për kategori të nënmbuluara si burrat, të moshuarit dhe rastet komplekse, në mënyrë që sistemi të reflektojë realisht diversitetin e nevojave.

Së katërti, ndërhyrjet duhet të kalojnë nga një fokus i kufizuar në mbrojtje emergjente drejt një qasjeje të integruar, duke lidhur shërbimet sociale me strehimin, punësimin dhe skemat e mbështetjes ekonomike, me qëllim reduktimin e rikthimit në situata dhune.

Së pesti, mekanizmat e koordinimit dhe referimit ndërinstitucional duhet të konsolidohen si funksione të qëndrueshme të sistemit, me përgjegjësi të qarta dhe bashkëpunim të strukturuar ndërmjet aktorëve vendorë dhe rajonalë.

Së gjashti, bashkëpunimi me shërbimet e specializuara për viktimat e trafikimit në nivel kombëtar duhet të forcohet si një komponent i integruar i sistemit, duke siguruar vijimësinë e trajtimit dhe ndjekjen e rasteve nga niveli vendor.

Së fundi, qëndrueshmëria e shërbimeve duhet të trajtohet si prioritet strategjik, përmes reduktimit të varësisë nga financimet afatshkurtra dhe krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm të mbështetjes financiare dhe institucionale.

Në tërësi, analiza evidenton një sistem të mbrojtjes për viktimat e dhunës dhe trafikimit që është funksional, por i fragmentuar dhe me mbulim të pabarabartë, ku hendeku ndërmjet identifikimit dhe ofrimit të shërbimeve mbetet sfida kryesore strukturore. Në këtë kontekst, Plani Social Rajonal duhet të kalojë nga një qasje reaktive dhe e bazuar në raste individuale drejt ndërtimit të një sistemi të integruar, të koordinuar dhe të qëndrueshëm, i cili garanton akses të barabartë, mbulim gjithëpërfshirës dhe mbështetje të plotë për çdo viktimë në të gjithë territorin e qarkut.

Aneksi 12: Analiza e e detajuar e situatës së të moshuarve në nevojë Qarku Elbasan

1. Përshkrimi i grupit dhe rëndësia sociale


Të moshuarit përbëjnë një nga kategoritë kryesore të përfituesve të politikave të mbrojtjes sociale dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Rritja graduale e jetëgjatësisë dhe ndryshimet demografike në Shqipëri kanë sjellë një rritje të vazhdueshme të peshës së popullsisë së moshës së tretë.

Të moshuarit përballen shpesh me sfida sociale dhe ekonomike, si izolimi social, problemet shëndetësore kronike, varësia nga familja ose mungesa e mbështetjes familjare. Për këtë arsye, zhvillimi i shërbimeve të kujdesit për moshën e tretë përbën një element të rëndësishëm për garantimin e mirëqenies dhe përfshirjes sociale të kësaj kategorie.

2. Të dhënat ekzistuese dhe shpërndarja territoriale

Në Qarkun Elbasan rezultojnë rreth 448,362 banorë, nga të cilët 226,022 meshkuj dhe 222,340 femra. Sipas Censit 2023, të moshuarit përbëjnë rreth 19.7% të popullsisë së qarkut.

Analiza e shpërndarjes territoriale tregon diferenca të dukshme ndërmjet bashkive.



Të dhënat e Censit 2023 tregojnë një nivel të konsiderueshëm të plakjes së popullsisë në qark. Bashkia Belsh paraqet peshën më të lartë të të moshuarve (25.04%), e ndjekur nga Cërriku (22.06%) dhe Peqini (20.54%). Në bashkitë e tjera, si Elbasani (19.13%), Gramshi (19.05%), Librazhdi (17.89%) dhe Prrenjasi (16.82%), pesha e të moshuarve është më e ulët, por gjithsesi reflekton një prirje të qartë të plakjes së popullsisë.

Analiza e mbulimit të shërbimeve për të moshuarit sipas bashkive në Qarkun Elbasan.

Tabela paraqet një panoramë të shpërndarjes së të moshuarve në nevojë dhe të kapaciteteve ekzistuese të shërbimeve për moshën e tretë në bashkitë e Qarkut Elbasan, duke kombinuar të dhënat e identifikuar nga bashkitë me informacionin demografik nga Censi 2023. Në nivel qarku janë identifikuar 394 të moshuar në nevojë për mbështetje sociale, nga të cilët 116 janë gra, ndërsa kapaciteti i shërbimeve ekzistuese përfshin 8 qendra ose shërbime për moshën e tretë, të cilat aktualisht mbulojnë rreth 336 përfitues.

Krahasimi i të dhënave demografike me kapacitetin e shërbimeve tregon një hendek të konsiderueshëm ndërmjet numrit të përgjithshëm të të moshuarve në territor (45,739) dhe numrit të përfituesve të shërbimeve sociale (336), duke sinjalizuar nevojën për zgjerimin dhe rishpërndarjen territoriale të shërbimeve për moshën e tretë.

Tabela paraqet analizën e mbulimit aktual të shërbimeve dhe për të orientuar prioritetet e Planit Social Rajonal për zhvillimin e shërbimeve për moshën e tretë.

Tabela 12.1

Bashkitë	Të moshuar mbi 64 vjeç (Cens 2023)	Të moshuar të identifikuar në nevojë	Nga këto femra	Numri i shërbimeve / qendrave për të moshuar	Të moshuar përfitues të shërbimeve
Elbasan	22,019	161	45	4 qendra (Balashe - ditor & rezidencial; A2B “Buka e Jetës” Qendra “Fit për Jetën”	rreth 142 (ditor) + 19 (rezidencial)
Prrenjas	3,157	60	26	1 qendër ditore (Shtëpia e të Moshuarve)	rreth 50
Cërrik	5,551	20	5	1 qendër (Balona - Caritas)	rreth 20
Peqin	3,405	48	25	0 - nuk ofrohet shërbim i dedikuar	0
Gramsh	3,150	0	0	0 - nuk rezulton shërbim i dedikuar	Nuk ka të dhëna
Librazhd	4,170	45	15	1 qendër ditore për të moshuarit	rreth 45
Belsh	4,287	60	-	1 qendër (Nderim Brezash)	rreth 60
Totali	45,739	394	116	8 qendra / shërbime	336 përfitues

Vërejtje analitike: Krahasimi i të dhënave demografike me informacionin mbi përfituesit e shërbimeve tregon se ndërkohë që në Qarkun Elbasan jetojnë 45,739 persona mbi 64 vjeç, vetëm një pjesë e kufizuar përfitojnë nga shërbimet sociale të dedikuara për moshën e tretë. Të dhënat e raportuara nga bashkitë lidhen kryesisht me përfituesit aktualë të shërbimeve, ndërsa mungojnë të dhëna të plota për të moshuarit në nevojë që nuk arrijnë të përfitojnë mbështetje sociale.

Analiza territoriale tregon një shpërndarje të pabarabartë të shërbimeve ndërmjet bashkive. Bashkia Elbasan përqendron pjesën më të madhe të shërbimeve për të moshuarit në qark, me katër qendra dhe shërbime, përfshirë shërbime ditore dhe një shërbim rezidencial. Në këtë bashki janë identifikuar gjithashtu 161 të moshuar në nevojë, duke reflektuar njëkohësisht përqëndrimin më të madh të rasteve dhe kapacitetin më të zhvilluar të

shërbimeve në nivel qarku. Kjo situatë e pozicionon Bashkinë Elbasan si qendër kryesore të ofrimit të shërbimeve për moshën e tretë në territor.

Në disa bashki të tjera ofrohen vetëm shërbime të kufizuara ditore, të cilat kanë një kapacitet relativisht të vogël për të përballuar nevojat ekzistuese. Në Bashkinë Prrenjas funksionon një qendër ditore për të moshuarit që mbulon rreth 50 përfitues, ndërsa në Cërrik, Librazhd dhe Belsh ofrohet nga një qendër ose shërbim për këtë kategori. Në këto bashki, numri i përfituesve është në përgjithësi i afërt me numrin e të moshuarve të identifikuar në nevojë, çka tregon një nivel relativisht më të balancuar të mbulimit të shërbimeve, megjithëse kapacitetet mbeten të kufizuara dhe të përqendruara kryesisht në shërbime socializuese ose ditore.

Në të kundërt, Bashkia Peqin paraqet një nga boshllëqet më të dukshme në mbulimin e shërbimeve, pasi megjithëse janë identifikuar 48 të moshuar në nevojë, nuk rezulton asnjë shërbim i dedikuar për këtë kategori në territorin e bashkisë. Kjo situatë krijon një hendek të qartë ndërmjet nevojave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale. Po ashtu, në Bashkinë Gramsh nuk rezultojnë shërbime specifike për të moshuarit, ndërsa të dhënat mbi numrin e përfituesve të shërbimeve janë të kufizuara.

Një tjetër element që del nga analiza është fakti se shumica e shërbimeve ekzistuese janë qendra ditore ose shërbime socializuese, ndërsa kapacitetet rezidenciale për të moshuarit janë shumë të kufizuara dhe të përqendruara kryesisht në Bashkinë Elbasan. Në të njëjtën kohë, shërbimet e kujdesit në familje dhe mbështetja për të moshuarit që jetojnë vetëm mbeten të pamjaftueshme në shumicën e bashkive.

Në tërësi, analiza e mbulimit të shërbimeve tregon se sistemi aktual i mbështetjes për të moshuarit në Qarkun Elbasan karakterizohet nga pabarazi territoriale në shpërndarjen e shërbimeve, përqendrim të kapaciteteve në disa bashki dhe mungesë të alternativave të kujdesit në territore të tjera. Këto gjetje nënvizojnë nevojën për zhvillimin e një rrjeti më të balancuar territorial të shërbimeve për moshën e tretë, përfshirë zgjerimin e qendrave ditore, zhvillimin e shërbimeve të kujdesit në familje dhe krijimin e alternativave rezidenciale për të moshuarit pa mbështetje familjare, si pjesë e prioritetëve të Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan.

3. Sfidat dhe problematikat kryesore

Në Qarkun Elbasan jetojnë mbi 45 mijë persona mbi 64 vjeç, dhe procesi i plakjes së popullsisë pritet të rrisë ndjeshëm kërkesën për shërbime sociale dhe shëndetësore në vitet e ardhshme. Një nga sfidat kryesore lidhet me rritjen graduale të numrit të të moshuarve në qark në përputhje me procesin e plakjes së popullsisë. Kjo prirje pritet të rrisë kërkesën për shërbime sociale dhe shëndetësore në vitet e ardhshme.

Një tjetër problematikë lidhet me mungesën e shërbimeve socializuese dhe qendrave ditore për të moshuarit, veçanërisht në bashkitë e vogla dhe në zonat rurale. Mungesa e këtyre shërbimeve rrit rrezikun e izolimit social dhe të vetmisë. Shërbimet për të moshuarit mbeten të përqendruara kryesisht në disa bashki, ndërsa në bashki të tjera, si Peqin dhe Gramsh, mungojnë plotësisht shërbimet e dedikuara për këtë kategori.

Gjithashtu evidentohet pamjaftueshmëria e shërbimeve të kujdesit në familje, sidomos për të moshuarit që jetojnë vetëm ose që vuajnë nga probleme kronike shëndetësore. Mbështetja për këtë kategori mbetet kryesisht e bazuar në kujdesin familjar ose informal.

Një sfidë tjetër lidhet me mungesën e shërbimeve rezidenciale dhe alternativave të kujdesit afatmesëm për të moshuarit pa mbështetje familjare, veçanërisht jashtë Bashkisë Elbasan.

Gjithashtu mungon një sistem i integruar i të dhënave për të moshuarit në nevojë, gjë që vështirëson identifikimin e hershëm të rasteve dhe planifikimin e shërbimeve sociale.

4. Implikimet për planifikimin e shërbimeve sociale

Analiza e situatës së të moshuarve në Qarkun Elbasan tregon nevojën për zhvillimin e një sistemi më të koordinuar të shërbimeve sociale për moshën e tretë në nivel rajonal. Duke pasur parasysh se në Qarkun Elbasan jetojnë mbi **45,739 persona mbi 64 vjeç** dhe vetëm një pjesë e kufizuar përfitojnë nga shërbimet sociale ekzistuese, zhvillimi i shërbimeve për moshën e tretë paraqet një nga prioritetet kryesore të planifikimit social në nivel rajonal.

Planifikimi social rajonal duhet të fokusohet në zgjerimin e shërbimeve të kujdesit në familje për të moshuarit që jetojnë vetëm ose që kanë probleme shëndetësore kronike, zhvillimin e qendrave ditore dhe shërbimeve socializuese për të moshuarit, veçanërisht në bashkitë e vogla dhe në zonat rurale, dhe forcimin e rrjetit të shërbimeve komunitare për moshën e tretë. Në këtë kuadër, planifikimi rajonal duhet të nxisë zhvillimin e shërbimeve ndërbashkiake dhe koordinimin ndërmjet bashkive, në mënyrë që të garantohet një akses më i balancuar territorial në shërbime për moshën e tretë.

Gjithashtu kërkohet zhvillimi i alternativave rezidenciale për të moshuarit pa mbështetje familjare dhe përmirësimi i mekanizmave të identifikimit dhe referimit të rasteve në bashkëpunim ndërmjet shërbimeve sociale dhe shëndetësore.

Në tërësi, procesi i plakjes së popullsisë dhe rritja e numrit të të moshuarve në nevojë e vendosin zhvillimin e shërbimeve për moshën e tretë ndër prioritetet kryesore të Planit Social Rajonal të Qarkut Elbasan.

Analiza krahasuese e të dhënave tregon se mbulimi i shërbimeve për të moshuarit në Qarkun Elbasan mbetet i pabarabartë ndërmjet bashkive dhe i përqendruar kryesisht në territorin e Bashkisë Elbasan. Ndërkohë që disa bashki si Cërriku, Librazhdi dhe Belshi paraqesin një raport relativisht të balancuar ndërmjet numrit të të moshuarve në nevojë dhe

kapaciteteve ekzistuese të shërbimeve, në bashki të tjera si Peqini evidentohet një hendek i qartë ndërmjet nevojës për mbështetje sociale dhe mungesës së shërbimeve të dedikuara për këtë kategori. Kjo situatë nënvizon nevojën për zhvillimin e një rrjeti më të balancuar territorial të shërbimeve për moshën e tretë, me fokus në zgjerimin e shërbimeve komunitare, zhvillimin e kujdesit në familje dhe krijimin e kapaciteteve të reja ditore ose rezidenciale në bashkitë ku aktualisht mungojnë shërbimet.

Bazuar në analizën e situatës, sfidat kryesore dhe implikimet për planifikimin social rajonal, tabela në vijim paraqet ndërhyrjet kryesore të rekomanduara për zhvillimin e shërbimeve për të moshuarit në nevojë në Qarkun Elbasan.

Tabela 12.2: Ndërhyrjet rajonale për zhvillimin e shërbimeve për të moshuarit në nevojë

Sfida kryesore	Ndërhyrja në nivel rajonal	Aktorët rajonalë	Rezultati i pritshëm	Lidhja me prioritetet e Planit Social Rajonal
Rritja e numrit të të moshuarve dhe plakja e popullsisë	Integrimi i dimensionit të plakjes së popullsisë në planifikimin social rajonal dhe zhvillimi i një rrjeti të koordinuar shërbimesh për moshën e tretë	Këshilli i Qarkut, bashkitë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Planifikim më i qëndrueshëm i shërbimeve dhe përshtatje e politikave sociale me ndryshimet demografike	Zhvillimi i shërbimeve për moshën e tretë
Shpërndarja e pabarabartë territoriale e shërbimeve	Krijimi i një rrjeti rajonal të shërbimeve për të moshuarit dhe forcimi i mekanizmave të referimit ndërmjet bashkive	Këshilli i Qarkut, bashkitë, ofruesit publikë dhe OJF-të	Përmirësim i aksesit territorial dhe reduktim i pabarazive në mbulimin e shërbimeve	Rritja e aksesit territorial në shërbime sociale
Mungesa e qendrave ditore dhe shërbimeve socializuese në disa bashki	Zgjerimi i qendrave ditore dhe programeve socializuese për të moshuarit në bashkitë me mungesë shërbimesh	Bashkitë, Këshilli i Qarkut, organizatat e shoqërisë civile	Ulje e izolimit social dhe rritje e mirëqenies së të moshuarve	Zhvillimi i shërbimeve komunitare

Pamjaftueshmëria e shërbimeve të kujdesit në familje	Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit në familje dhe i mbështetjes komunitare për të moshuarit që jetojnë vetëm	Bashkitë, shërbimet sociale vendore, OJF-të	Përmirësim i mbështetjes për të moshuarit vulnerabël dhe rritje e pavarësisë së tyre	Kujdesi në komunitet dhe në familje
Mungesa e alternativave rezidenciale për të moshuarit pa mbështetje familjare	Zhvillimi i kapaciteteve rezidenciale dhe i formave alternative të kujdesit afatmesëm për të moshuarit	Këshilli i Qarkut, bashkitë, institucionet qendrore, OJF-të	Zgjerim i alternativave të kujdesit dhe mbështetje për të moshuarit pa rrjet familjar	Shërbime të specializuara për kategori vulnerabël
Mungesa e të dhënave të plota për të moshuarit në nevojë	Krijimi i një sistemi rajonal për mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi të moshuarit dhe nevojat e tyre	Këshilli i Qarkut, bashkitë, institucionet publike përkatëse	Përmirësim i planifikimit të shërbimeve dhe vendimmarrjes në bazë të evidencës	Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe të të dhënave sociale

Aneksi 13: Analiza e detajuar e situatës së shërbimeve shoqërore Qarku Elbasan

1. Përshkrimi i shërbimeve shoqërore

Sipas Ligjit nr.121/2016, shërbimet shoqërore përbëjnë një sistem ndërhyrjesh profesionale për mbështetjen dhe përfshirjen sociale të individëve dhe familjeve në nevojë, përfshirë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe kategori të tjera në rrezik përjashtimi social.

Sistemi strukturohet në shërbime rezidenciale, ditore dhe në komunitet, në familje dhe të specializuara, të cilat planifikohen dhe ofrohen nga bashkitë, ndërsa qarku luan rol koordinues për zhvillimin dhe balancimin e tyre në territor, veçanërisht për shërbimet me karakter ndërbashkiak dhe të specializuar.

Në Qarkun Elbasan, oferta ekzistuese përfshin kryesisht këto tipologji shërbimesh, me fokus te fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, duke përbërë bazën funksionale të sistemit në nivel qarku. Megjithatë, në raport me kuadrin ligjor, sistemi paraqitet ende i pjesshëm dhe kërkon zgjerim, diversifikim dhe shpërndarje më të balancuar në territor.

Në vijim, analiza e të dhënave ekzistuese dhe e shpërndarjes territoriale të shërbimeve mundëson vlerësimin e mbulimit, balancës dhe hendekëve në nivel qarku.

2. Të dhënat ekzistuese dhe shpërndarja territoriale

Të dhënat mbi shërbimet shoqërore në Qarkun Elbasan evidentojnë një sistem me 49 shërbime funksionale, të dominuara nga shërbimet ditore dhe në komunitet (23 shërbime), të ndjekura nga shërbimet e specializuara (11), ndërsa shërbimet rezidenciale (5), në familje (5) dhe lëvizëse (3) përfaqësojnë një pjesë më të kufizuar të ofertës. Në nivel qarku operojnë dy shërbime strehëz të dedikuara, përkatësisht për viktimat e dhunës dhe për viktimat e trafikimit; megjithatë, shtrirja e kufizuar dhe mungesa e shërbimeve online tregojnë se format më fleksibël dhe lehtësisht të aksesueshme të ofrimit mbeten ende të pazhvilluara.

Tabela 13.1: Tipologjia dhe shpërndarja e shërbimeve shoqërore në nivel qarku

Kategori të shërbimeve shoqërore	Numër shërbimesh
Shërbime rezidenciale	5
Shërbime ditore + në komunitet	23
Shërbim lëvizës	3
Shërbime në familje	5
Shërbime të specializuara	11
Shërbime online	0
Strehëz/emergjence	2
Total	49

Nga tërësia e shërbimeve, në nivel qarku operojnë tre shërbime të specializuara me rëndësi rajonale: Qendra Rajonale për Fëmijët me Autizëm dhe shërbimi për viktimat e trafikimit, të cilat financohen pjesërisht nga qarku përmes Fondit Social, si dhe shërbimi strehëz për viktimat e dhunës, i cili mbështetet nga Bashkia Elbasan për komponentin e strehimit, bashkëfinancohet nga bashkitë e tjera të qarkut dhe plotësohet nga donatorët. Ky konfigurim jo vetëm reflekton një rol aktiv të qarkut në mbështetjen e shërbimeve të specializuara, por e pozicionon atë si një aktor kyç në balancimin e pabarazive territoriale dhe në garantimin e aksesit ndërbashkiak në shërbime me karakter rajonal.

Struktura e mbulimit të shërbimeve shoqërore në Qarkun Elbasan tregon një orientim të qartë drejt disa kategorive prioritare, ku dominon mbështetja për fëmijët (12 shërbime), personat me aftësi të kufizuara të mitur (13 shërbime) dhe të moshuarit në nevojë (8 shërbime). Ky profil sugjeron një fokus të konsoliduar në këto grupe, ndërkohë që për

kategori të tjera si përdoruesit e alkoolit, përdoruesit e drogave dhe personat LGBTIQ nuk evidentohet asnjë shërbim i dedikuar, duke nxjerrë në pah boshllëqe të dukshme në adresimin e plotë të vulnerabilitetit social dhe në diversifikimin e ofertës së shërbimeve.

Tabela 13.2: Mbulimi i kategorive në nevojë nga shërbimet shoqërore sipas tipologjisë së shërbimit.

Kategoria e shërbimeve shoqërore	Kategori ne nevoje											Totali
	Fëmijë	Të rinj	PAK të mitur	PAK të rritur	Viktima të dhunës dhe trafikimit	Te moshuar ne nevoje	Komuniteti rom/egjiptian	Persona perdorues te alkoolit	Perdorues te droges	Persona LGBTIQ	Familje nw nevojë	
Sherbime ditore	8	1	3	1		7	1				2	23
Sherbime rezidenciale	4	1			2	1						8
Sherbime te specializuara			8		3							11
Sherbime ne familje							1				3	4
Shërbime levizese			2	1								3
Sherbim online												
Total	12	2	13	2	5	8	2	0	0	0	5	49

Analiza e përfituesve evidenton një mbulim prej rreth 2,130 individësh, me peshën kryesore në shërbimet ditore (1,147 përfitues), të ndjekura nga shërbimet e specializuara (408), shërbimet në familje (295) dhe ato rezidenciale (205). Shërbimet lëvizëse mbulojnë vetëm 75 përfitues, duke reflektuar një përdorim ende të kufizuar të këtij modeli. Sipas kategorive, përfitimi mbetet i përqëndruar kryesisht te fëmijët (569), personat me aftësi të kufizuara të mitur (561) dhe të moshuarit (381), ndërsa kategori të tjera si viktimat e dhunës (186), komunitetet rome dhe egjiptiane (110) dhe familjet në nevojë (225) paraqiten me nivele më të ulëta në raport me nevojat potenciale, duke sinjalizuar një mospërputhje ndërmjet kërkesës dhe ofertës së shërbimeve.

Tabela 13.3: Numri i përfituesve të shërbimeve shoqërore sipas kategorive në nevojë dhe tipologjisë së shërbimit

Kategoria e shërbimeve shoqërore	Numri i përfituesve sipas kategorive në nevojë										Totali	
	Fëmijë	Të rinj	PAK të mitur	PAK të rritur	Viktima të dhunës dhe trafikimit	Te moshuar në nevojë	Komuniteti rom/egjiptian	Persona përdorues të alkolit	Përdorues të drogës	Persona LGBTIQ		Familje në nevojë
Sherbime ditore	445	85	214			363	40					1147
Sherbime rezidenciale	124	13			50	18						205
Sherbime të specializuara			272		136							408
Sherbime në familje							70				225	295
Shërbime lëvizëse			75									75
Sherbim online												
Total	569	98	561		186	381	110	0	0	0	225	2130

Shpërndarja territoriale e shërbimeve paraqet diferenca të theksuara ndërmjet bashkive. Bashkia Elbasan përqendron pjesën më të madhe të kapaciteteve dhe të përfituesve, duke ofruar një gamë më të plotë ndërhyrjesh dhe duke mbuluar një numër më të lartë kategorish në nevojë. Në bashki si Cërrik, Librazhd dhe Prrrenjas identifikohet një prani më e kufizuar e shërbimeve, ndërsa në Belsh dhe Gramsh oferta mbetet fragmentare, me mungesë të disa tipologjive bazë. Në Bashkinë Peqin, oferta është minimale dhe e kufizuar në një shërbim të vetëm të dedikuar për fëmijët me aftësi të kufizuara, çka tregon një mbulim shumë të ngushtë dhe një mungesë të theksuar diversifikimi të ndërhyrjeve.

Tabela 13.4: Shpërndarja territoriale e shërbimeve shoqërore

Bashkitë	Ditore	Specializuara	Rezidenciale	Në familje	Lëvizëse	Vlerësim
Elbasan	✓	✓	✓	✓	✓	I lartë
Cërrik	✓	(✓)	(✓)	(✓)	✗	Mesatar
Librazhd	✓	✓	✗	✗	✓	Mesatar
Prrrenjas	✓	✓	✗	✗	✓	Mesatar
Belsh	✓	✗	✗	✗	✗	Fragmentar
Gramsh	✗	✓	✗	✗	✗	Fragmentar
Peqin	(✓)	✗	✗	✗	✗	Minimal
Këshilli i Qarkut Elbasan	✗	(✓)	(✓)	✗	✗	I kufizuar

Shënim: ✓ = shërbimi ekziston; (✓) = i kufizuar; ✗ = mungon.

Tabela evidenton përqendrimin e shërbimeve në Bashkinë Elbasan dhe mungesën e theksuar të diversifikimit në bashkitë e tjera, veçanërisht në Peqin, Belsh dhe Gramsh.

Struktura territoriale e ofrimit të shërbimeve karakterizohet nga një përqendrim i theksuar në qendrat urbane, kryesisht në qytetet qendër të bashkive, ndërkohë që njësitë administrative mbeten në pjesën më të madhe të pambuluara. Përjashtimet janë të kufizuara dhe përfshijnë një shërbim të ofruar në njësinë administrative Mollas dhe dy shërbime lëvizëse, të cilat, megjithatë, nuk arrijnë të kompensojnë mungesën e një pranie të qëndrueshme të shërbimeve në territor.

Në këtë kontekst, përqendrimi i shërbimeve të specializuara në Bashkinë Elbasan krijon një varësi funksionale të bashkive të tjera nga ofrues jashtë territorit të tyre, duke kufizuar aksesin real për përfituesit dhe duke rritur kostot sociale dhe praktike të përfitimit, veçanërisht për kategori që kërkojnë ndërhyrje të vazhdueshme. Kjo varësi thekson nevojën për mekanizma rajonale koordinues dhe për një shpërndarje më të balancuar të kapaciteteve në territor.

Analiza e burimeve të financimit evidenton dallime të qarta ndërmjet bashkive në mënyrën e zhvillimit të shërbimeve. Në bashki si Peqin, Belsh, Gramsh dhe Prrenjas, ngritja e shërbimeve është mbështetur kryesisht nga Fondi Social, duke reflektuar një rol të drejtpërdrejtë të financimit publik në krijimin e ofertës bazë. Në të kundërt, në bashkitë Elbasan, Cërrik dhe Librazhd, një pjesë e konsiderueshme e shërbimeve është mundësuar përmes mbështetjes së donatorëve dhe organizatave jofitimprurëse, duke krijuar një profil më të varur nga financimi i jashtëm dhe më pak të institucionalizuar.

Tabela 13.5: Burimet e financimit sipas bashkive

Bashkia	Burimi kryesor i financimit
Peqin	Fondi Social + Bashkia
Belsh	Fondi Social + Bashkia
Gramsh	Fondi Social + Bashkia
Prrenjas	Fondi Social + Bashkia
Elbasan	Donatorë + Fondi Social + Bashkia
Cërrik	Donatorë + Fondi Social + Bashkia
Librazhd	Donatorë + Fondi Social + Bashkia

Shënim: Tabela nxjerr në pah një profil të diferencuar të burimeve të financimit të shërbimeve ndërmjet bashkive.

Struktura e financimit reflekton drejtpërdrejt profilin territorial dhe mënyrën e zhvillimit të shërbimeve në qark, ku rreth 68% e tyre mbështeten nga organizata jofitimprurëse dhe donatorë, ndërsa vetëm 25% financohen nga burime publike dhe 7% përmes financimit të kombinuar. Kjo varësi e lartë nga financimi i jashtëm tregon një nivel të kufizuar institucionalizimi të sistemit dhe rrit rrezikun për qëndrueshmërinë e shërbimeve në afatmesëm dhe afatgjatë.

Tabela 13.6: Burimet e Financimit të Shërbimeve Shoqërore

Burimi financimit të shërbimeve shoqërore	Niveli i financimit të shërbimeve në %
Publik/Bashkia	25%
OJF/Donator	68%
Mix	7%

Në tërësi, sistemi paraqet një bazë të konsoliduar shërbimesh, por mbetet i karakterizuar nga pabarazi territoriale, mbulim selektiv i kategorive dhe një model financiar i brishtë. Në këtë kuadër, roli i qarkut si nivel ndërmjetës bëhet thelbësor për të orientuar zhvillimin e shërbimeve drejt një modeli më të integruar, për të balancuar shpërndarjen territoriale dhe për të garantuar qëndrueshmërinë përmes forcimit të financimit publik dhe mekanizmave të koordinimit ndër-institucional.

3. Sfidat dhe problematikat kryesore

Analiza e evidenton një sistem shërbimesh shoqërore me bazë funksionale, por të karakterizuar nga sfida strukturore që lidhen drejtpërdrejt me kapacitetin e qarkut për të ushtruar rolin e tij koordinues, mbështetës dhe zhvillues të shërbimeve të specializuara.

Së pari, evidentohet një shpërndarje e pabarabartë territoriale e shërbimeve, me përqëndrim në Bashkinë Elbasan dhe mbulim të kufizuar ose minimal në bashki si Peqin, Belsh dhe Gramsh, si dhe në njësitë administrative, çka kufizon aksesin real dhe rrit varësinë nga shërbimet jashtë territorit.

Së dyti, sistemi paraqet një diversifikim të kufizuar të ofertës, i përqëndruar kryesisht te fëmijët, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, ndërkohë që kategori të tjera mbeten të pambuluara ose të mbuluara pjesërisht. Në mënyrë të veçantë, mungojnë plotësisht shërbimet për të rriturit me aftësi të kufizuara, duke krijuar ndërprerje të vazhdimësisë së mbështetjes.

Një tjetër sfidë lidhet me mospërputhjen ndërmjet nevojave dhe mbulimit aktual, si dhe me zhvillimin e kufizuar të formave fleksibël të ofrimit, veçanërisht shërbimeve lëvizëse dhe mungesën e shërbimeve online, çka thellon pabarazitë në akses.

Në planin financiar, evidentohet një varësi e lartë nga financimi i jashtëm, ndërkohë që kontributi i financimit publik mbetet i kufizuar, duke krijuar pasiguri për qëndrueshmërinë e shërbimeve.

Së fundi, identifikohet një dobësi në koordinimin në nivel qarku, që kufizon balancimin e shpërndarjes territoriale dhe zhvillimin e shërbimeve me karakter rajonal.

4. Implikimet për planifikimin e shërbimeve sociale

Gjetjet e analizës evidentojnë nevojën për një qasje më të strukturuar dhe të balancuar në planifikimin e shërbimeve sociale në nivel qarku, e orientuar drejt rritjes së mbulimit, përmirësimit të aksesit dhe garantimit të qëndrueshmërisë së sistemit në kohë.

Në funksion të rolit koordinues, planifikimi duhet të adresojë pabarazitë territoriale, duke orientuar zhvillimin e shërbimeve drejt bashkive dhe njësisve administrative me mbulim të kufizuar dhe duke reduktuar varësinë nga shërbimet e përqendruara në Bashkinë Elbasan, përmes mekanizmave që garantojnë akses ndërbashkiak.

Në funksion të rolit mbështetës, evidentohet nevoja për zgjerimin dhe diversifikimin e ofertës së shërbimeve, si dhe për vijimësinë dhe konsolidimin e shërbimeve ekzistuese, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe viktimat e trafikimit, si dhe mbështetjen për shërbimet për viktimat e dhunës.

Në funksion të rolit si ofrues i shërbimeve të specializuara, kërkohet zhvillimi i shërbimeve me karakter rajonal, duke përfshirë shërbime rezidenciale për të rriturit me aftësi të kufizuara dhe për të moshuarit, në përgjigje të boshllëqeve të identifikuara në ofertë.

Në planin e mënyrës së ofrimit, evidentohet nevoja për forcimin e modeleve fleksibël të shërbimit, përfshirë zgjerimin e shërbimeve lëvizëse dhe zhvillimin e formave të reja të aksesit, në mënyrë që të reduktohen barrierat territoriale.

Së fundi, planifikimi duhet të synojë forcimin e financimit publik dhe të koordinimit ndërinstytucional, në funksion të garantimit të qëndrueshmërisë së shërbimeve në afatmesëm dhe afatgjatë.

Në tërësi, implikimet e analizës orientojnë drejt një modeli planifikimi ku qarku konsolidohet si nivel koordinues, mbështetës dhe ofrues i shërbimeve të specializuara me karakter rajonal.

Aneks 14: Lista e aktorëve lokalë në hartimin e Planit Social Rajonal

Lista në vijim paraqet aktorët kryesorë lokalë dhe rajonalë të përfshirë në procesin e hartimit të planit, të evidentuar nga listat e prezencës së takimeve dhe aktiviteteve konsultative.

Nr.	Aktori / Institucioni
1	Këshilli i Qarkut Elbasan
2	Bashkia Elbasan
3	Bashkia Cërrik
4	Bashkia Belsh
5	Bashkia Gramsh
6	Bashkia Librazhd
7	Bashkia Prrenjas
8	Bashkia Peqin
9	Shërbimi Social Shtetëror – Drejtoria Rajonale Elbasan
10	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)
11	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan
12	Zyra Vendore Arsimore Elbasan
13	Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan
14	Qendra Rajonale e Formimit Profesional Publik Elbasan
15	Shkolla 9-vjeçare “Qamil Guranjaku” Elbasan
16	Kopshti Nr.6 Elbasan
17	Çerdhe Nr.4 Elbasan
18	Qendra Rajonale e Autizmit Elbasan
19	Qendra Ditore e Aftësisë së Kufizuar “Lulet e Diellit” Gramsh
20	Qendra e Ditore për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuar- Librazhd
21	World Vizion Albania
22	Tjetër Vizion - OJF
23	Forumi i Gruas Elbasan - OJF
24	Qendra Shqiptare e Integritit të Njerëzve me Nevoja të Veçanta - OJF
25	Shoqata e të Verbërve - Qarku Elbasan

26	Shoqata e Para dhe Tetraplegjikëve Elbasan
27	INAC Elbasani - OJF
28	Caritasi Shqiptar- OJF
29	“Motrat Bijat e Dashurisë” Mollas OJF
30	Fondacioni “Bashkësia Ungjillit” EMAN
31	Shoqata FHA “Për një Shqipëri të shëndetshme”
32	Në dobi të Komunitetit (SHDFKSHP) - OJF
33	Ndihma e Weilhemit për Shqipërinë
34	Fondacioni “Aid to the Balkans” Elbasan (A2B)
35	Individë në nevojë dhe familjarë të PAK
36	Shkolla Speciale “Zëra Jete”
37	Future for You - OJF
38	Ndihma e Weilhelm për Shqipërinë
39	MEDPAK
40	Qendra Multifunkionale - Librazhd
41	Adra Albania